

Janar 2019
Numri: 130
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

Ku shkojmë kështu?!



revistaetika





progresibotime

H

COM

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 2 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*



Të gjithë në jetë kanë synime të cilat dëshirojnë t'i arrijnë. Në të vërtetë, gjërat që e bëjnë jetën të kuptimtë dhe që i japin vlerë asaj, janë qëllimet dhe synimet. Një jetë pa objektiva nuk ka as shije, as kuptim. Të jetuarit në mënyrë të shëndetshme, mes mirëqenies dhe paqes, është prej qëllimeve të përbashkëta të të gjithëve ne.

Të gjithë dëshirojnë të bëjnë një jetë të rehatshme dhe të qetë, por qëllimet, synimet dhe përpjekjet, që lidhen vetëm me jetën e kësaj bote të përkohshme, nuk mund të sigurojnë paqe dhe lumturi në kuptimin përfundimtar. Një njeri që mendon ka largpamësi dhe qëllime në lidhje me jetën e përtejme, që është edhe e përhershme.

Ata, të cilët kanë drejtuar fytyrën dhe veten nga e përhershmeja, nuk mund të mjaftohen me asgjë që digjet dhe shuhet, që lind dhe perëndon, që çel dhe vyshket, që ekziston dhe humbet... Fakti që Ibrahim (a.s.), pa yjet, hënën dhe diellin për t'i bërë babilonasit të heshtnin dhe tha: "A thua këta janë Zoti im?", ndërsa kur perënduan tha: "Unë nuk i dua ata që perëndojnë!", tregon se shpirti i njeriut bindet vetëm me të vërtetë permanente.

Dëshira më themelore e njeriut është përhershmëria. Normalisht që pavdekshmëria është shpresa e përbashkët e të gjithëve. Të gjitha përpjekjet bëhen për të ekzistuar. Natyrshmëria e njeriut nuk gënjen dhe nuk i kërkon gjërat që nuk janë në përputhje me të. Dëshira e shpirtit për pavdekshmëri është argumenti më i qartë i ekzistencës së saj. Për temën është shprehur shumë bukur edhe poeti i famshëm, Junus Emre: "Nëse vdesim, vdesin vetëm trupat. Ndërsa shpirtrat nuk vdesin.". Meqë përtej kësaj jete të përkohshme ka një jetë dhe botë të përhershme, atëherë qëllimi kryesor i njeriut duhet të jetë arritja e lumturisë në atë jetë dhe në atë botë. Siç ka thënë edhe filozofi Maorri: "Njeriu i mençur nuk mund të mashtrohet prej krijesave që në fund do të zhduken.". Gjithçka që është e detyruar të të lërë, herët apo vonë, ose që je i detyruar ta lësh, nuk mund të jetë burim i lumturisë së përhershme. Mbi të gjitha, pikëllimi për humbjen e këtyre gjërave provizore është më i madh se gëzimi për posedimin e tyre.

Andaj, përderisa nuk është e nevojshme apo e domosdoshme, nuk duhet të rendim pas gjërave që do të jenë shkak për t'u pikëlluar kur të mos ekzistojnë më. Në të kundërt, do të ishte shpërdorim i kohës dhe i munit. Njeriu nuk fiton për të humbur, por prapë se prapë i humb shumë gjëra, edhe pse nuk dëshiron. Ndërkohë të mos harrojmë se ka edhe gjëra që nuk humbasin. Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: **"Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira se Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpërndarjes"** (për shpëtim). (Kehf, 46)

Janar 2019

VITI: XIII

NUMRI: 130

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



14



7

Pas kujt apo cilës
gjë po rendim?
Ali Riza Temel



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34



22

20

Një përrallë
pastaj shumë përrallë
Edison Çeraj



5 Veprat janë pjesë e nënshtrimit tonë
ndaj Zotit (xh. sh.)

Nuredin Jëlldëz

10 Busulla e zemrës

për orientimin në vepra

Dr. Adem Ergyl

12 Mungesa e ndjeshmërisë

ndaj hallallit dhe haramit

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

16 Tamahu dhe sakrifica

Ahmet Zijlan

21 Katër stinët e njeriut


Ferudun Ozdemir

22 Umare ibn Hazmi

Mustafa Erish

24 Kodi i "mburojës së shenjtë"

Idris Arpat



45

Ajete që thërrasin për në xhenet 26

Xhafer Durmush

Qytetërimi me bosht xhaminë 28

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

A e pastrojmë shpirtin? 31

Mehmet Dinç

Një Ajete-Një Hadith 32

El-Adl 40

Ilir Hoxha

Jini pak më shumë emocionues! 45

Ajshe Kurudere

Stacioni i qetësisë 50

Halime Demireshik

Virtyte që e lartësojnë njeriun 54

Dr. Betyl Nefise Inall

Jeta e lidhur me fuçinë e vajit të ullirit 57

Urtësi

42

Fragmente nga jeta e miqve të Allahut

Alixhan Tatlle



Detyrimet ndaj prindërve
Ferit Piku

46





Veprat janë pjesë e nënshtrimit tonë

ndaj Zotit ﷻ

— Nuredin Jëlldëz —

Forca që na bën të zgjohemi në momentin më të ëmbël të gjumit dhe na inkurajon për të marrë abdest, është besimi ndaj Allahut Teala dhe të vërtetës - llogarisë që do japim në Ditën e Gjykimit. Ky besim na e ndërpret gjumin dhe na shtyn që t'i hedhim fytyrës ujë, me qëllim që ta largojmë atë. Në të njëjtën mënyrë, ky besim është me ne edhe kur i japim lëmoshë ndonjë të panjohuri, ndërsa dhurojmë nga ajo që kemi fituar me mundin tonë. Edhe kur zgjedhim të provojmë urinë dhe etjen në muajin e Ramazanit, edhe pse nuk ka ndonjë kontroll evident, qëndrojmë brenda kornizës së këtij besimi. Edhe kur nxjerrim rrobat dhe veshim ihramin, përsëri jemi një me këtë besim.

E vërteta e përhershme për ne është kjo: Nëse urdhëron Zoti (xh.xh.), e bëjmë. Nëse e ndalon Zoti (xh.sh.), largohemi nga ajo që ka ndaluar. Ne nuk e konsiderojmë si të rëndë asgjë që ka urdhëruar Ai dhe as e konsiderojmë si të pashmangshme çka ai na ka ndaluar. Ne jemi robërit e Atij. Robi është nën

urdhërat e Zotit të tij. Robi nuk mund të ketë ndonjë alternativë tjetër përveçse të qënit nën urdhrin e Zotit. E gjithë jeta dhe çdo element i rrjedhës së saj ndahen në dy grupe: në çka duhet të bëjmë dhe çka nuk duhet të bëjmë, për hir të Allahut Teala.

Fakti që namazi dhe agjërimi vijnë në krye të veprave që bëhen për hir të Allahut (xh.sh.), nuk do të thotë se janë të vetmet vepra që bëhen për hir të Tij. Njeriu është rob i Allahut. Jeta është mirësi që na e ka dhënë vetë Allahu Teala. Mirësitë dhe sprovat vijnë po nga Allahu. Robi i Allahut, me të njëjtin devocion që falë namazet apo agjëron, duhet të kryejë edhe veprimet e tjera, ndonëse ato nuk perceptohen si adhurime direkte, siç ndodh me namazin dhe agjërimin. Pra çdo veprim duhet të pasqyrojë bindjen e të qënit një rob i Allahut të Lartësuar. Meqë Allahu Teala do ta marrë në llogari robin e Tij për çdo minutë të jetës që i ka dhuruar dhe meqë kjo llogari nuk do të jetë e kufizuar vetëm tek namazet dhe agjërimet, besimtari i vërtetë duhet të përpiqet

që të jetë i përgatitur për këtë në çdo minutë të jetës së vet. Ne besojmë prerazi se në llogari do të përfshihet e gjithë jeta jonë. Allahu Teala është Ai që e ka krijuar të gjithë jetën, si rrjedhojë edhe llogaria do të jetë në lidhje me tërësinë e saj.

Një besimtar që e sheh si gjithëpërfshirës nënshtrimin ndaj Zotit (xh.xh), namazin duhet ta konsiderojë si domosdoshmëri në kuptimin e të qenët besimtar dhe ta zbatojë siç është urdhëruar. Edhe pasi të falë namazin dhe të kalojë tek punët e tregtisë, duhet të jetë i vetëdijshëm se Zoti që e vëzhgon në namaz dëshiron që ta shikojë si besimtar edhe në tregti. Për këtë arsye duhet t'i respektojë rregullat e haramit dhe hallallit edhe aty. Sado që nuk gjendet me abdest dhe i drejtuar nga kibla, nëse përkujdeset në tregti njëloj siç bën në namaz, ai do arrijë ta mbrojë karakterin prej besimtari dhe do të zbatojë rregullat e një tregtie të pastër nga kamata duke ruajtur kë-shtu standardin e besimtarit, që nuk njeh hile dhe nuk përzihet me haramin. Besimtari e jep zekatin kur vjen koha për ta dhënë dhe kthehet në mbrëmje në shtëpi pasi ka fituar kënaqësinë e Allahut Teala. Ai kthehet pasi e ka arritur sevapin nga Allahu për paratë që ka fituar. Në këtë mënyrë, xhamia bashkohet me dyqanin. Namazi dhe tregtia zënë vend në të njëjtën listë. Botëkuptimi Islam që e rrethon të gjithë jetën e besimtarit kalon nga teoria në praktikë.

Kur besimtari bëhet prind, krijohet idea se po përjeton një rrënjë prej etapave më të domosdoshme të jetës së kësaj bote, por në të vërtetë, çka ai po përjeton është një periudhë në të cilën Zoti (xh.xh.) po teston nënshtrimin ndaj Tij, njëloj siç e teston përmes namazit dhe agjërimit. Prindërimi mund të jetë burim sevapi ose shkak për të hyrë në zjarr. Besimtari nuk mund të qëndrojë vetëm në nivelin e të parit të fëmijës si një amanet të Allahut. Me të vërtetë që ai fëmijë është një amanet, por edhe procesi i rritjes së tij duhet të perceptohet nga mendja e besimtarit si një provë. Besimtari duhet të synojë të mos gabojë përgjatë këtij procesi, siç përpiket të mos gabojë përgjatë faljes së namazit. Nëse gabon, duhet t'i kërkojë falje Allahut Teala, njëloj siç bën sexhden e harresës kur gabon përgjatë namazit. Në sajë të këtij perceptimi, vetëdija e të konsideruarit të detyrës së prindërimit si të barasvlefshme me faljen e namazit, bën që

edhe nëse ky besimtar vdes, të jetë prej atyre që nuk u mbyllet libri i veprave. Kjo e mban të gjallë atë edhe në varrin e tij.

Edhe kur besimtari të bëhet bashkëshort, i qëndron me burrëri këtij niveli të nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.).

Edhe kur të bëjë punën e avokatit si përfaqësues i njëres palë në ndonjë padi, atë e orienton mbikëqyrja e Allahut Teala para firmës së klientit të tij.

Ai është besimtar edhe kur ecën në rrugë, edhe kur ndan parkun me të tjerët, edhe kur përdor shkallët e pallatit, edhe kur pi çaj për qejf në ballkonin e shtëpisë. Ky perceptim buron nga vetëdija e të jetuarit sipas sheriatit të Allahut Teala, i cili dëshiron të na shohë si besimtarë në çdo vend dhe në çdo kohë. Një besimtar i tillë është një besimtar që fiton. Besimtari është ai që fiton në xhami, në dyqan, kur

hipën në autobus, kur luan me fëmijën, kur bisedon me bashkëshorten dhe kur viziton të afërmit. Ky besimtar, nga njëra anë fiton kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), ndërsa nga ana tjetër fiton këtë botë. Ai gjithmonë fiton. Pra, fiton në adhurim, në vepra, në çdo vend dhe në çdo rrethanë.

NJË LIBËR BAZË NË LIDHJE ME VEPRAT

Kitabu'l-Kesb

Ky është një libër i Imam Muhamedit, i cili ishte njëri prej tre imamëve të parë të medhhebit Hanefi. Kjo është një vepër e rëndësishme në përcaktimin e kufijve të hallallit dhe haramit në lidhje me fitimin. Kur e pyetën Imam Muhamedin se përse nuk kishte shkruar një libër në lidhje me devotshmërinë, domethënë, një libër në lidhje me kufijtë e ndjeshëm të Islamit, ai ishte përgjigjur se kishte shkruar librin me titull *Kitabu'l-Kesb*. Siç edhe kuptohet, rrugët e fitimit për njeriun dhe marrëdhëniet sociale, sipas këtij imami të madh, përbëjnë bazën e devotshmërisë.

Këtë libër Imam Serahsi, i cili ishte njëri prej muxhtehidëve të medhhebit Hanefi, e ka shpjeguar duke u bërë kështu shkak për arritjen e tij deri në ditët e sotme. Ky libër i bukur duhet të gjejë vend në memorien tonë si një vepër e rëndësishme në lidhje me të dhënat themelore për hallallin, haramin, pasurinë dhe mënyrat e fitimit.

Pas kujt apo cilës gjë po rendim?

— Ali Riza Temel —

Të gjithë në jetë kanë synime të cilat dëshirojnë t'i arrijnë. Në të vërtetë, gjërat që e bëjnë jetën të kuptimtë dhe që i japin vlerë asaj, janë qëllimet dhe synimet. Një jetë pa objektiva nuk ka as shije, as kuptim. Të jetuarit në mënyrë të shëndetshme, mes mirëqenies dhe paqes, është prej qëllimeve të përbashkëta të të gjithëve ne.

Të gjithë dëshirojnë të bëjnë një jetë të rehatshme dhe të qetë, por qëllimet, synimet dhe përpjekjet, që lidhen vetëm me jetën e kësaj bote të përkohshme, nuk mund të sigurojnë paqe dhe lumturi në kuptimin përfundimtar. Një njeri që mendon ka largpamësi dhe qëllime në lidhje me jetën e përtejme, që është edhe e përhershme.

Ata, të cilët kanë drejtuar fytyrën dhe veten nga e përhershmeja, nuk mund të mjaftohen me asgjë që digjet dhe shuhet, që lind dhe perëndon, që çel dhe vyshket, që ekziston dhe humbet... Fakti që Ibrahim (a.s.), pa yjet, hënën dhe diellin për t'i bërë babilonasit të heshtnin dhe tha: "A thua këta janë Zoti im?", ndërsa kur perënduan tha: "Unë nuk i dua ata që perëndojnë!", tregon se shpirti i njeriut bindet vetëm me të vërtetën permanente.

Dëshira më themelore e njeriut është përhershmëria. Normalisht që pavdekshmëria është shpresa e përbashkët e të gjithëve. Të gjitha përpjekjet bëhen për të ekzistuar. Natyrshmëria e njeriut nuk gënjen dhe nuk i kërkon gjërat që nuk janë në përputhje me të. Dëshira e shpirtit për pavdekshmëri është argumenti më i qartë i ek-

zistencës së saj. Për temën është shprehur shumë bukur edhe poeti i famshëm, Junus Emre: "Nëse vdesim, vdesin vetëm trupat. Ndërsa shpirtat nuk vdesin." Meqë përtej kësaj jete të përkohshme ka një jetë dhe botë të përhershme, atëherë qëllimi kryesor i njeriut duhet të jetë arritja e lumturisë në atë jetë dhe në atë botë. Siç ka thënë edhe filozofi Maorri: "Njeriu i mençur nuk mund të mashtrohet prej krijesave që në fund do të zhduken." Gjithçka që është e detyruar të të lërë, herët apo vonë, ose që je i detyruar ta lësh, nuk mund të jetë burim i lumturisë së përhershme. Mbi të gjitha, pikëllimi për humbjen e këtyre gjërave provizore është më i madh se gëzimi për posedimin e tyre.

Andaj, përderisa nuk është e nevojshme apo e domosdoshme, nuk duhet të rendim pas gjërave që do të jenë shkak për t'u pikëlluar kur të mos ekzistojnë më. Në të kundërt, do të ishte shpërdorim i kohës dhe i mundit. Njeriu nuk fiton për të humbur, por prapë se prapë i humb shumë gjëra, edhe pse nuk dëshiron. Ndërkohë të mos harrojmë se ka edhe gjëra që nuk humbasin. Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: **"Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës** (për shpëtim)." (Kehf, 46)

Asgjë, për posedimin e së cilës zihemi apo bëjmë krime, nuk do të derdhë asnjë pikë loti për ne, pasi të shpërngulemi në botën e përtejme. Gjërat, për të cilat ne jemi përpëlitur për t'i bërë tonat, përveç që nuk do të pikëllohen pasi të kalojmë në botën tjetër, por as që kanë aftësinë për ta kuptuar këtë kalim. Gjërat që nuk na njohin, por që na bëjnë dobi vetëm në këtë botë, nuk janë tjetër veçse mjete e mundësi. Andaj, shndërrimi i tyre në qëllim në vetvete është diçka boshe. Për këtë arsye, nuk duhet të bëhemi robër të objekteve. Rëndësia e këtyre mundësive vlerësohet përmes masës së lumturisë që marrim nga posedimi i tyre, në këtë bote dhe në botën e përtejme. Keqpërdorimi i tyre mund të shndërrohet në një fatkeqësi të madhe.

Çdo gjë duhet të merret në konsideratë në varësi të vlerës që posedon. Edhe dashuria ndaj gjërave të përkohshme është provizore. Allahu Teala zotëron cilësitë e të qënit Hajj (i Gjallë), Kajjum (Ai që sheh dhe kontrollon çdo gjë) dhe La Jemut (i Pavdekshëm). Kthimi i syve dhe zemrës drejt Tij duhet të jetë i përhershëm dhe kërkimi i kënaqësisë së Tij është veprimi më i mençur. Rendja pas Atij që është i përhershëm nuk sjell lodhje dhe pendim, si dhe qëndrimi vetëm në rrugën e Tij është burim lumturie. Fitorja e vërtetë është arritja e kënaqësisë së Zotit (xh.sh.). Krijuesi i Plotfuqishëm thotë në ajetet fisnike:

“O ju që keni besuar! A doni t’ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm?! Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe trupin tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju. Ai do t’ju falë gabimet tuaja dhe do t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe në banesa të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Kjo është fitorja më e madhe.” (Saff, 10-12)

“Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut,

falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë. Allahu do t’ua plotësojë atyre shpërblimin dhe do t’ua shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Falënderues.” (Fatir, 29-30)

Çdo përpjekje për të fituar jetën e përhershme është produktive. Pronari mund t’i bëjë padrejtësi punëtorit të tij, ndërsa Allahu i Madhëruar kurrë nuk i bën padrejtësi robit të Vet. Zoti (xh.xh.) është i drejtë, bujar dhe jep pa masë. Në rrugën e Tij askush nuk pëson dëm. Në këtë botë ka shumë prej atyre që e kanë shpenzuar jetën duke rendur pas gjërave të përkohshme dhe të pavlera. Ka shumë edhe prej atyre që kanë derdhur djersë dhe u janë thinjur flokët duke rendur pas këtyre gjërave, por ja që në fund të gjitha përpjekjet u kanë shkuar dëm. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Atë Ditë do të poshtë-rohen fytyra njerëzish, që kanë punuar e janë rras-kapitur (duke bërë të këqija në këtë botë). **Ata do të digjen në zjarr të nxehtë e do të pinë nga burime të valuara.”** (Gashije, 2-5)

Të punosh, të gabosh dhe së fundi të hysh në një zjarr të nxehtë është një tragjedi e tmerrshme. Ngjan sikur njeriu punon dhe gabon për të hyrë në zjarrin e Xhehenemit. Ndërkohë njeriu punon dhe lodhet për të fituar, por nëse qëllimi nuk caktohet saktësisht dhe nëse nijeti nuk është i pastër, fitimet shpesh herë shndërrohen në humbje, përpjekjet shkojnë dëm dhe mundimet rezultojnë të dështuara.

Zoti (xh.sh.), rendjen pas gjërave të pakuptimta e krahason me rendjen për të gjuajtur në tokë hijen e zogut që po fluturon në qiell. Rezultati i një rendjeje të tillë nuk është gjë tjetër veçse një lodhje e padobishme: **“Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë...”** (Nur, 39)

RENDJA PAS

CILËSIVE QË NUK

**VJETROHEN, QË NUK VENITEN
DHE QË NUK ZHVLERËSOHEN,
DHËNIA KUPTIM DHE VLERË
JETËS NË KËTË MËNYRË,
ARRITJA E KËNAQËSISË SË
ZOTIT DHE E LUMTURISË SË
PËRHERSHME NË FUND TË
UDHËTIMIT TË KËSAJ JETE...**

JA, KJO ËSHTË

E GJITHË ÇËSHTJA.

Përpjekjet e atyre që rendin pas veprimeve që janë në kundërshtim me kënaqësinë e Allahut Teala, duke përdorur mundësitë që i ka dhënë vetë Zotit (xh.xh.), do të shkojnë dëm. Allahu i Lartësuar shprehet në Kuran: ***“Vepra e atyre, që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbja e madhe.”*** (Ibrahim, 18)

Të dërguarit e Allahut dhe njerëzit e mëdhenj që ndjekin gjurmët e tyre, gjithmonë kanë rendur pas qëllimeve dhe synimeve të mëdha. Të gjitha mirësitë dhe bukuritë, që ne posedojmë, na kanë ardhur nëpërmjet tyre. Veprat e famshme janë veprat e tyre. Ndërsa ata që kanë pasur për qëllim epshin, famën dhe pasurinë, kanë bërë çdo lloj krimi dhe poshtërsie për ta arritur këtë qëllim të ulët të tyre. Mbrapa si kujtim kanë lënë vetëm shkatërrim, gjak dhe lot.

Ata që e shohin jetën vetëm si ngrënie e pirje, si mundësi për t'u kënaqur e argëtuar, si famë dhe si luks e pasuri, janë krijesa të mjera të privuara nga fisnikëria dhe çdo lloj cilësie njerëzore. Ndërsa rendja pas kauzës dhe idealeve e lartëson dhe i jep kuptim jetës. Fizikani i madh Albert Einstein (Ajnshtajni) thotë në lidhje me këtë çështje: “Të gjithë kanë disa qëllime. Çdo njeri përpiket dhe rend pas këtyre qëllimeve. Ndërsa qëllimet e mia janë: mirësia, bukuria dhe ndershmëria. Mua asnjëherë nuk më kanë kapluar qëllimet e lidhura me komfortin dhe mirëqenien. Ai qëllim apo sistem, që dëshiron të arrijë komfortin dhe mirëqenien, gjithmonë më është dukur si diçka që i shkon për shtat bariut të lopëve. Për mendimin tim jeta do të ishte krejt e pakuptimtë nëse nuk do të kishte rendje pas vendeve më të thella dhe më të paarritshme në kërkimet për artin dhe shkencën. Edhe përgjatë fëmijërisë e kam pas konsideruar si diçka të ulët ecjen mbi vulgaritetet e pasioneve të njeriut. Asnjëherë nuk e kam ndierë dëshirën për pasuri dhe prona, për një jetë luksoze dhe për t'u bërë njeri i famshëm. Që në fillim i jam dedikuar jetës modeste. Andaj jam i bindur se kjo është qasja më e dobishme për trupin dhe për shpirtin.” (R. Ballaban, Shkenca, Morali, Besimi, fq. 92.)

Vlera e njerëzve matet me vlerën e sjelljeve dhe veprimeve që reflektojnë. Çfarë vlere mund

të kenë ata që nuk arrijnë të tejkalojnë përtej vetes së tyre dhe që nuk kanë as kontributin më të vogël në ndërtimin e së ardhmes? Ata që investojnë për brezat e ardhshëm dhe që zhvillojnë veprimtari të dobishme, gjithmonë përkujtohen me nderim e mirësi dhe konsiderohen si busull për në rrugën e vërtetë dhe të drejtë.

Rendja pas cilësive që nuk vjetrohen, që nuk veniten dhe që nuk zhvlerësohen, dhënia kuptim dhe vlerë jetës në këtë mënyrë, arritja e kënaqësisë së Zotit dhe e lumturisë së përhershme në fund të udhëtimit të kësaj jete... Ja, kjo është e gjithë çështja.

Ndërkohë që kjo është e gjithë çështja dhe qëllimi kryesor, shumica e njerëzve e harxhojnë jetën duke rendur pas sendeve të pavlefshme, si fëmijët që e kalojnë kohën duke luajtur me lodra. I ndjeri Sejjid Kutubi e shpreh këtë gjendje në parathënien e tefsirit të tij: “Kam jetuar nën hijen e Kuranit duke parë gjërat e vogla dhe të pavlefshme që u jepnin rëndësi njerëzit e tokës. Kam jetuar duke parë se si njerëzit u jepnin vlerë dhe gëzoheshin me këto gjëra, siç shikon një i madh sjelljet dhe bisedat e fëmijëve që gëzohen me lodrat që kanë në dorë.”

Më së fundi, loja mbaron, bie muzgu i mbrëmjes dhe vjen koha për t'u kthyer në shtëpi. Sa pikëllim i madh është të ngelësh vetëm për vetëm me brengën që të jep fakti i kthimit duarbosh në shtëpi! Allahu në ajetet fisnike thotë:

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme. Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij. Ajo është mirësia e Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë. Allahu ka mirësi të pafund.” (Hadid, 20-21)

Rendja pas gjërave të përkohshme është lodhje, stërmundim dhe pendim.

Busulla e Zemrës për orientimin në vepra



— Dr. Adem Ergyl —

Adhurimi ndaj Allahut Teala është misioni ynë më themelor, i cili duhet të praktikohet në të gjitha fushat e jetës. Për ta kryer këtë mision në mënyrën e duhur, kërkohet të bëjmë një jetë brenda kornizës dhe kufijve që ka vendosur Zoti i Lartësuar. Për ta realizuar këtë qëllim në adhurime, në botën e besimit, në sjelljet etike dhe në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve e gjërave që i quajmë vepra, udhëzimet e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij pa dyshim që janë udhërrëfyesit tanë më themelore.

Gjatë rrjedhës së jetës, përballemi me situata që ndryshojnë në varësi të kohës, vendit dhe kushteve sociale. Nganjëherë mund të përjetojmë dilema në raport me një qëndrim të caktuar që duhet të mbajmë në secilën prej këtyre situatave. Këto dilema burojnë nga fakti se, brenda dispozitave që ka caktuar Allahu Teala dhe Pejgamberi ynë i nderuar në lidhje me kornizën e jetës, disa prej tyre janë krejtësisht të qarta dhe të kuptueshme lehtësisht, e disa jo. Pra shpesh hasim edhe në çështje që mund të na detyrojnë të ndalemi që të çmojmë si duhet situatën dhe për të cilat mund të kemi vështirësi për të dhënë një vendim. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, flet si më poshtë në lidhje me këtë çështje:

“Gjërat që janë hallall janë të qarta. Edhe gjërat që janë haram janë të qarta. Ndërmjet këtyre të dyjave ka edhe çështje të dyshimta, për të cilat shumë njerëz nuk e dinë nëse janë hallall apo haram. Ata që largohen prej çështjeve të dyshimta, e mbrojnë fenë dhe nderin e tyre. Ndërsa ata që nuk ruhen prej çështjeve të dyshimta, gradualisht zhyten në haram.

Kjo është pikërisht si çështja e një bariu që e kullot kopenë e tij rreth e qark një toke që i përket dikujt tjetër. Ai gjithmonë përballet me rrezikun e hyrjes së kopesë në atë tokë.

Bëni kujdes! Çdo mbret ka një vend që është e ndaluar hyrja. Mos harroni se edhe vendi i ndaluar i Allahut janë gjërat që i ka bërë haram.” (Buhari, Iman, 39, Buju’, 2; Muslim, Musakat, 107.)

Pra, çdo mysliman që e merr seriozisht nënshtrimin ndaj Allahut Teala, para së gjithash ka përgjegjësinë që të njihet me gjërat hallall dhe haram, në lidhje me çdo fushë të jetës së tij. Furnizimi me një dije të tillë është obligim për çdo mysliman. Prandaj myslimanët duhet t’i mësojnë kufijtë hyjnor që lidhen me secilën fushë të jetës, duke u informuar nga njohësit e mirë të temës. Secili nga ne mund të ketë çështje të ndryshme për të cilat i nevojiten njohuri të reja. Për shembull, ata të cilët punojnë në fushën e tregtisë kanë obligim mësimin e dispozitave në lidhje me tregtinë, mjekët kanë obligim të mësojnë ligjet hyjnore në lidhje me fushën e mjekësisë. Në të njëjtën mënyrë, edhe ata që janë të martuar kanë përgjegjësinë për të pyetur dhe për të mësuar çështjet që lidhen me jetën familjare. Andaj, besimtarët janë të obliguar të mësojnë parimet hyjnore dhe profetike në lidhje me të gjitha çështjet e jetës.

Siç thuhet edhe në hadithin fisnik, nganjëherë mund të ndeshemi me disa çështje që nuk e kanë të qartë plotësisht dispozitën e tyre. Në situata të tilla, rruga që duhet të ndiqet bëhet disi e paqartë. Prandaj, në këto lloj situatash ndiejmë nevojën për

një busull që të na orientojë drejt të vërtetës. Ja pra, kjo busull është ndërgjegjja apo zemra jonë, për aq kohë sa nuk e ka humbur ndjeshmërinë dhe gjallërinë.

Vabisa ibn Ma'bedi (r.a.), tregon: “Shkova te i Dërguari i Allahut, (a.s.).

Ai më tha: ‘Mos ke ardhur për të pyetur se çfarë është mirësia?’

Unë iu përgjigja: ‘Po, o i Dërguari i Allahut.’

Atëherë, hz. Pejgamberi (a.s.), më tha: ‘Konsultohu me zemrën tënde! Mirësia është ajo ndjenjë, të cilën ta pranon ndërgjegjja dhe ta aprovon zemra. Ndërsa mëkat është ndjesia që ta bren shpirtin, që të bën të dyshosh dhe të hezitosh edhe pse të tjerët të japin fetva për ta bërë.’ (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 227-228; Darimi, Bujû’, 2.)

Në të vërtetë, çdo zemër që nuk e ka humbur krejt dëlirësinë dhe pastërtinë e natyrshmërisë, në një lloj mënyre e kupton të vërtetën. Ky kuptim bëhet edhe më i përpiktë me rritjen e masës së besimit dhe devotshmërisë. Kjo ndjesi mund të humbasë me kalimin e kohës për shkak të mëkateve dhe gjynaheve. Madje ajo humbet krejtësisht, kur bëhet fjalë veçanërisht për mohim, këmbëngulje në mohim dhe hipokrizi. Për shkak të këtyre ndotjeve, zëri i ndërgjegjes nuk mund të dëgjohet ndërmjet zhurmave të dëshirave të nefsit dhe pëshpëritjeve të djallit të mallkuar.

Para se njeriu të konsultohet për ndonjë çështje me zemrën vet, duhet të shkojë te dijetarët e devotshëm që e njohin mirë çështjen dhe që punojnë me dijen e tyre dhe t’i pyesë. Pastaj duhet të veprojë në bazë të përgjigjes që i jep prehje zemrës së tij. Nëse akoma ka dyshim në zemër, më mirë të mos e bëjë fare, sepse këshilla e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në lidhje me këtë çështje është: “*Largohu nga gjithçka që të bën të dyshosh dhe merru me atë që nuk të sjell dyshim!*” (Tirmidhi, Kijamet, 60.)

Një çështje tjetër, për të cilën njeriu duhet të ketë kujdes, është gabimi i marrjes fetva nga nefs duke pretenduar se në pyetje po merret zemra. Shenjë e qartë e kësaj gjendjeje është neglizhimi i dispozitave, edhe kur ato janë qartësisht të përcaktuara, dhe përpjekja për të kërkuar fetva që duken më të përshtatshme ndaj interesave dhe dëshirave. Kjo gjendje është devijim në rrugë të mjegullt ndërkohë që ekziston rruga e qartë. Pas një kërkimi të tillë, vijon hapi i dytë i nefsit, që është përpjekja për ta legjitimuar rezultatin dhe për të justifikuar vendimin a veprimin. E gjithë kjo, në të vërtetë është një mashtrim i njeriut ndaj vetvetes. Kurani Fisnik, këto lloj sjelljesh dhe veprimesh shpesh herë i konsideron si gjendje hipokrizie.

Diferencimi ndërmjet zërave të ndërgjegjes apo zemrës nga pëshpëritjet që vijnë nga nefs, ka lidhje shumë të fortë me sinjeritetin që njeriu ka kundrejt vetes dhe Zotit (xh.sh.). Me të vërtetë, Allahu Teala do t’ia tregojë rrugën atij që kërkon të vërtetën sinjerisht dhe ndoshta do ta orientojë nëpërmjet frymëzimeve. Këshillat e mëposhtme të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), janë një udhërrëfyes orientues, për momentin në të cilin bëjmë vlerësimin në lidhje me zërat që vijnë nga brenda:

“*Padyshim që engjëlli dhe shejtani kanë ndikim orientues mbi zemrën e birit të Ademit. Ndërkohë që ndikimi i shejtanit bëhet nëpërmjet premtimeve që e shtynë njeriut drejt ligësisë dhe që përgënjeshtrojnë të vërtetën, ndikimi i engjëllit bëhet nëpërmjet premtimeve për mirësi dhe që pohojnë të vërtetën. Ai që e ndjen në zemër ndikimin e engjëllit për mirësi, le ta dijë se vjen prej Allahut dhe ta falënderojë Atë. Ndërsa ai që ndjen një ndikim që përpiket ta tërheqë drejt ligësisë, le t’i kërkojë mbrojtje Allahut të Madhëruar nga shejtani dhe e keqja e tij.*” (Tirmidhi, Tefsir, 2.)

Sipas njerëzve të ditur e të urtë, mendimet e para që vijnë në zemër, në shumicën e rasteve, janë frymëzime për mirësi dhe për të vërtetën. Andaj është e rëndësishme që njeriu ta vlerësojë këtë mundësi, sepse këto lloj ndjenjash të bukura do ta humbasin fuqinë dhe ndikimin e tyre pas një kohe të shkurtër, për shkak të sulmeve të nefsit dhe shejtanit.

Fetvatë e dhëna prej dijetarëve në lidhje me kufijtë e ligjshëm, pothuajse në çdo fushë të jetës sonë, janë të rëndësishme dhe kanë rolin e një harte që na tregon rrugën e drejtë. Por rruga më e sigurt është ajo në të cilën njeriu i drejtohet devotshmërisë duke shfaqur një ndjeshmëri gjithnjë e më të madhe, dhe nuk shkon rreth e rrotull kufijve të haramit. Pikërisht kjo rrugë është zgjedhja më e mirë në aspektin e sigurisë së tij dhe nderit e vlerës së vet tek Allahu (xh.sh.). Atijje ibn Urve es-Sa’di (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut goftë mbi të, ka thënë:

“*Një rob nuk mund të arrijë gradën e devotshmërisë, nëse nuk arrin të qëndrojë larg edhe nga gjërat që nuk kanë ndonjë problem për t’u bërë, prej frikës se mos hyn në mëkat.*” (Tirmidhi, Kijamet, 19.)

Së fundmi, mund të themi se, për të arritur tek veprimi i drejtë mund të duhet të gërmojmë ndër burimet e sakta të dijes e tek dijetarët e devotshëm dhe pastaj të ndjejmë prehjen dhe aprovimin e zemrës së ndjeshme dhe të gjallë. Aq sa shtohen ndjenjat e besimit dhe devotshmërisë, po aq i shtohen edhe busullës së zemrës mundësitë për të treguar të vërtetat.



MUNGESA E NDJESHMËRISË NDAJ HALLALLIT dhe HARAMIT

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Për fat të keq, e vërteta e hidhur është se po jetojmë dhe po ndajmë me të tjerët një mjedis në të cilin kufijtë hallall-haram pothuajse janë zhdukur tërësisht apo janë përzier me njëri-tjetrin, aq sa është e vështirë të ndahen. Mungesa e ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit, e cila po inkurajohet nga çmenduria e pasionit për materializmin dhe jetesës pa kufizime, gjendet në radhët e para të sëmundjeve sociale dhe etike që janë bërë serioze dhe janë përhapur në masë ditëve të sotme.

Nëse individët, familjet dhe klasat e shoqërisë do t'i rishikonin me sinjeritet njëzet e katër orët e ditës së tyre, edhe nëse nuk do ta pohojnë dot, do ta kuptojnë mungesën e ndjeshmërisë në këtë çështje. Punimet e standardit të ushqimit hallall që po diskutohen këto vitet e fundit, nga njëra anë janë pohim i qartë i mungesës së ndjeshmërisë për të cilën po flasim, në fushën e ushqimit, dhe nga ana tjetër janë përpjekje për t'i vetëdijesuar njerëzit në lidhje me këtë çështje.

Përqasja dhe sistemi sundues, që i japin drejtim jetës ditore, janë larg bazës islame. Prandaj, veçanërisht nga shkatërrimi i ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit që Islami ua jep njerëzve, ky sistem merr një kënaqësi sadiste. Metodot e punimit, në qarqet e prodhimit, nuk e ndjejnë aspak nevojën e një rregulli si ndjeshmëria ndaj hallallit dhe hara-

mit, në asnjë fazë të prodhimit -as në zgjedhjen e përmbajtjes së produkteve që përdorin, as në paketimin e prodhimeve, as në reklamimin e tyre etj. Për fat të keq, edhe shumica dërrmuese e klientëve myslimanë, preferojnë të sillen si krijesat që kullosin dhe ecin të lira e pa kujdes në livadh. Kjo atmosferë e ngatërruar dhe e egër që me dashje apo pa dashje e pranojnë si modernizim, zhvillim dhe përparim, gradualisht po hedh rrënjë në çdo vend.

Tek individët e një shoqërie/umeti që e përfetojnë këtë mangësi të ndjeshmërisë në tregje dhe pazare, del në plan të parë një liri e plotë e ndjenjave epshore dhe seksuale që e nxit regjimi i ushqyerjes dhe ushqimet vetë. Ndërsa virtyteve si pastërtia e zemrës, mprehtësia e mendjes dhe morali i shoqërisë, po iu bie çdo dite e me shumë ndikimi dhe rëndësia.

Dëmtimi afatgjatë dhe afatshkurtër që shkaktojnë në strukturën fizike të trupit ushqimet e prishura dhe të modifikuara gjenetikisht, si dhe kalbjet apo shqetësimet që formojnë ushqimet haram në strukturën shpirtërore të trupit, e kanë vënë shoqërinë ballë për ballë me sëmundje të pashërueshme.

Mungesa e ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit vihet re deri edhe në vendet islame, të cilat janë pjesët e umetit, si dhe në marrëdhëniet e këtyre vendeve me njëra-tjetrën. Shprehitë dhe komentet

mendjelehta që fillojnë me frazën “në këtë shekull” dhe që i konsiderojnë haramet si të rënda apo si të panevojshme, po ndjehen dhe po shikohen tek individët e shtresave të ndryshme të shoqërisë, madje po trajtohen si shprehje të larta të kulturës moderne që nuk njeh kufi dhe që është përhapur nga mjetet e komunikimit social.

Paralajmërimet e pafajshme që të kujtojnë ndjeshmërinë ndaj hallallit dhe haramit shpesh herë nuk shpëtojnë dot nga ofendimet e rënda. Ata që dëshirojnë të jenë të ndjeshëm dhe të kujdesshëm kundrejt harameve, po fajësohen edhe në ditët e sotme, siç ka ndodhur në të kaluarën kur i akuzonin në formën: “...**Ata janë njerëz që duan të rrinë të pastër.**”¹. Kjo është një e vërtetë mjaft e hidhur.

Shprehja “të gjithë apo shumica veprojnë kështu” po konsiderohet si justifikim ndaj mungesës së ndjeshmërisë. Kjo dëshirë për ta treguar si normale këtë rënie të shoqërisë, është edhe një gabim tjetër që aplikohet shpesh herë, apo edhe një mashtrim i shejtanit.

Ndërkohë, në hadithin fisnik thuhet: “*Gjërat që janë hallall janë të qarta. Edhe gjërat që janë haram janë të qarta. Ndërmjet këtyre të dyjave ka edhe çështje të dyshimta për të cilat shumë njerëz nuk e dinë nëse janë hallall apo haram. Ata që largohen prej çështjeve të dyshimta, e mbrojnë fenë dhe nderin e tyre. Ndërsa ata që nuk ruhen prej çështjeve të dyshimta, gradualisht zhyten në haram. Kjo është pikërisht si çështja e një bariu që e kullot kopenë e tij rreth e qark një toke, e cila i përket dikujt tjetër. Ai gjithmonë përballet me rrezikun e hyrjes së kopesë në atë tokë.*”

Bëni kujdes! Çdo mbret ka një vend që është e ndaluar hyrja. Mos harroni se edhe vendi i ndaluar i Allahut janë gjërat që i ka bërë haram.

*Dijeni mirë, se në trupin e njeriut gjendet një copë mishi e vogël. Nëse kjo copë mishi do të jetë mirë, i gjithë trupi bëhet mirë. Nëse ajo prishet, prishet i gjithë trupi. Ja pra, kjo copë mishi është zemra.”*²

Më sipër u trajtua mungesa e ndjeshmërisë për çështjet që janë hallall dhe haram në një formë të qartë dhe të hapur. Gjithashtu ka edhe çështje për të cilat ka dyshime apo paqartësi në të kuptuarit nëse janë hallall apo haram. Pakujdesia e shoqërisë për sa i përket kësaj teme, për fat te keq, është shumë më e madhe.

Në të vërtetë, qëndrimi larg çështjeve, të cilat nuk ndahen lehtë nëse janë hallall apo haram, përbën bazën e fetarisë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “*Një rob nuk mund të arrijë gradën e de-*

votshmërisë derisa të mos qëndrojë larg edhe nga veprimet që nuk kanë ndonjë problem për t’u bërë, prej frikës se mos hyn në gjynah.”³

Abdullah ibn Omeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ka thënë: “Zemra e një rob i nuk mund ta arrijë devotshmërinë e vërtetë derisa të mos e lërë një punë tek e cila dyshon.”⁴

Afrimi te punët e dyshimta, siç shprehet edhe në hadithin fisnik⁵, është sikur të shkosh rreth e rrotull një vendi të ndaluar. Pra, në çdo moment ekziston mundësia për të rënë në haram. Për këtë arsye, duhet të veprojmë siç shprehet edhe populli ynë: “Më mirë të rrimë zgjuar se sa të shohim ëndrra të tmerrshme!”. Kjo do të thotë që duhet t’i largohemi gjërave të dyshimta dhe duhet ta mbajmë të gjallë ndjeshmërinë ndaj hallallit e haramit, në mënyrë që të shpëtojmë menjëherë nga shumë probleme.

Dyshimi e vendos njeriun ndërmjet mashtrimit e të vërtetës, ndërmjet haramit dhe hallallit. Në përgjithësi, dyshimi e afron më shumë njeriun nga mashtrimi dhe harami. Nisur nga këto që thamë, “largimi nga veprimet që të ndjellin dyshime dhe të mjaftuarit me gjithçka për të cilën nuk dyshon”⁶, pra të larguarit të një rreziku që ende nuk ka lindur, edhe pse nganjëherë në aparençë duket sikur sjell humbje, në të vërtetë është një veprim i zgjuar dhe fitimprurës.

Atëherë, gjëja më e mirë që mund të bëjmë është të qëndruarit larg vendeve të rrezikshme dhe plotësimi i nevojave me hallall. Enesi (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), gjeti një hurmë në rrugë dhe tha: “*Po të mos shqetësohesha nga mundësia se kjo hurmë mund të jetë lëmoshë, do ta haja.*”⁷

Vetëdija dhe ndjeshmëria ndaj hallallit dhe haramit mund të mbahen të gjalla me veprime të kujdesshme kundrejt gjërave të dyshimta. Qëndrimi që duhet të mbahet kundrejt situatave të dyshimta kërkon një seriozitet dhe përkushtim të jashtëzakonshëm, veçanërisht në ditët e sotme dhe në shoqërinë tonë, ku kufijtë e haramit po shkatërrohen me shpejtësi.

Të qëndruarit larg mendimit “a thua vallë”, domethënë, heqja dorë nga veprimet dhe situatat e paqarta, do ta shpëtojë myslimanin nga shqetësimi shkatërrues i dyshimit të rënies në mëkat, do t’ia shtojë atij ndjeshmërinë kundrejt hallallit e haramit dhe umetit do t’i japë një strukturë të shëndetshme e të pastër.

3. Tirmidhi, Kijamet, 19; Ibn Maxhe, Zuhd, 24.

4. Shik. Buhari, Iman, 1.

5. Shik. Buhari, Iman, 39, Buju’, 2; Muslim, Musakat, 107-108.

6. Buhari, Buju’, 3; Tirmidhi, Kijamet, 60; Nesai, Kaza, 11.

7. Buhari, Buju’, 4, Lukata, 6; Muslim, Zekat, 164-166. Veçanërisht shik. Ebu Davud, Zekat, 29.

1. A’raf, 82; Neml, 56.

2. Buhari, Iman 39, Buju’ 2; Muslim, Musakat 107, 108. Veçanërisht shik. Ebu Davud, Buju’ 3; Tirmidhi, Buju’ 1; Nesai, Buju’ 2, Kudat 11; Ibn Maxhe, Fiten 14.



Edhe një ditë

— Nuredin Nazarko —

Ti nuk e di numrin e ditëve që do të jetosh. Ndoshta nuk të ka shkuar ndonjëherë në mendje të bësh një llogari të thjeshtë. Mund të llogaritësh sa ke jetuar. Ditët që të mbeten të jetosh janë e panjohura.

Është një e panjohur vlerën e së cilës as me përafëri nuk mund ta përlllogaritësh. Dëshirën ndoshta e ke. Por kur mbërrin tek saktësia matematikore e kupton që sado stërhollime të futësh në mes, vlerën e së panjohurës nuk mund ta gjesh kurrësi. Kjo pafuqi e zbulimit të së panjohurës dëshmon se sado kohë të të jepet për të jetuar ajo është e pazbulueshme. Ti që mendon se je i aftë për gjëra të mëdha, nuk mundesh të zbulosh diçka të thjeshtë nga jeta jote e komplikuar me 1001 përlllogaritje të së përditshmes.

Mos harro! Edhe një ditë.

*Edhe një mundësi e artë
për t'u kthjellur mbi jetën e virtytshme.*

Mbi jetën e moralshme.

*Mbi jetën që nuk i përjashton gabimet,
por i korrigjon dhe përmirëson.*

*Mbi jetën që ke mundësi
ta vendosësh në hijen e virtyteve.*

Mos harro! Edhe një ditë.

Mund të përlogaritësh të ardhurat. Shpenzimet. Kursimet. Mund të vendosësh destinacionin ku do të shpenzosh orët e tua të pushimit, apo ditët e pushimit. Mund të shtosh apo heqësh nga lista ushqimet që konsumon. Njerëzit që do të takosh apo nuk do të takosh. Njerëzit që i do pranë apo ata të cilët nuk dëshiron t'u shohësh as bojën. Mund t'i bësh këto dhe shumë të tjera përlogaritje. Bash kur kryen kaq shumë veprime mendon se je duke ia dalë për bukuri me jetën tënde. Dhe mund të ndihesh i kënaqur njëfarësoj apo shumëfarësoj. Dhe në fund kujtohesh për të panjohurën. Edhe sa ditë?

Këtu mund të të mpihen gishtat. Lapsi mbi tryezë pret që të hedhësh mbi një letër çfarëdo llogaritë e tua për të panjohurën. Letra kërkon të njohë zgjidhjen e këtij ekuacioni të vjetër sa vetë njeriu. Por gishtat e mpirë nuk duan të binden. Hezitojnë të kapin lapsin. Kanë frikë se në vend të sa panjohurës do shkruajnë vetëm të njohurat, ato që tashmë rutina ditore i ka bërë kaq të njohura sa që nuk ka nevojë as për letër e as për laps për t'i mbajtur diku, që të mos harroen. Dhe ti e sheh veten me përbuzje. Ti që kryen gjëra të mëdha dhe nuk arrin dot të bindësh gishtat për të hedhur diçka në letër.

Më mirë mos e bëj. Mos e mundo veten për të marrë laps e letër. Mos i hyr një punë të cilën askush mbi lëmshtin e dheut nuk ka mundur ta zbulojë. Çdokush ka ardhur e ka ikur me të panjohurën si të tillë. Edhe ata që shfaqen si lexuesit e së ardhmes nuk janë hiç më mirë me zgjidhjene së panjohurës. Japin receta që i di gjithkush dhe i shesin si zbulim të së ardhmes, si fjala vjen "duhet të bësh ushtrime gjimnastikore në ajër të pastër për shëndet më të mirë". Ti e di që të gjitha këto as ata vetë që i zbulojnë si çështje të së ardhmes nuk i besojnë si të tilla. Edhe ata vetë gjasen së qeshuri në prapaskenë për këto zbulime të mëdha që ia shesin masës si zbulime të së ardhmes. Prandaj e panjohura duhet pranuar në këtillesinë e vet. Ti je i pafuqishëm përballë saj.

As shqisat nuk të kryejnë punë. Janë të paralizuara krejt nga e panjohura. Mund të shohin, mund të dëgjojnë dhe të të sjellin pak njohuri se çndodh përreth teje, apo diku më larg, por vetëm kaq. Nuk të ndihmojnë dot për të njohur ditët e tua. Ti njeriu i madh që bën shumë gjëra u tradhëtove edhe nga ushtarët e tu besnikë, shqisat. Nuk pranuan të të ndihnin në një betejë të cilën e kanë të humbur qysh pa nisur. Duke pranuar pafuqinë e tyre ndaj të epërmes tërhiqen në heshtje dhe përlul ndaj kësaj fuqie të panjohur. Siç e sheh edhe ushtarët e tu kanë më tepër mençuri. I binden ligjeve që i njohin më mirë sesa ty, njeriu i madh që bën vetëm gjëra të mëdha. Kështu rrokullisen ditët dhe ti ende qëndron

pa përgjigje përballë pyetjes: - Edhe sa ditë?

I lodhur nervash nga pafuqia jote për zgjidhjen e ekuacionit, ngrihesh rrëmbimthi. Përplas lapsin. Gris letrën. Përmbys tavolinën. Thyen pasqyrën. Shndërron në kaos çfarë të rrethon. Pasi të janë harxhuar fuqitë dhe damarët të janë prerë ulesh mbi kolltuk si fëmijë dhe qan në heshtje për dobësinë tënde më të madhe; edhe sa ditë.

Përse je kaq kurioz të dish edhe sa ditë? Çfarë do të bëje nëse do ta dije? Mos vallë do të ishe më kurajoz? Më i virtytshëm? Më i mirë nga çfarë ke qëndër? Apo do të bëje të kundërtën se tashmë e dije se kur. E megjithatë ky mbetet gjithmonë një supozim. Një supozim i cili nuk të bën punë për të zbërthyer të panjohurën.

Në çaste kthjelltësie e kupton që është e kotë të numërosh edhe sa ditë. Sepse ti e di shumë mirë që kur ngrysesh nuk e di nëse do të gdhiesh. Kur gdhiesh nuk e di nëse do të ngrysesh. Prandaj ajo çfarë të ka mbetur është edhe një ditë. Dhe ti vetë e pohon këtë duke thënë: - U mbyll edhe një ditë, apo u gdhimë edhe sot.

Dhe ti e thua këtë sepse je i bindur që je edhe një ditë. Askush nuk të garanton se mund të jesh më tepër se një ditë veç shpresës që ke me jetuar gjatë. Ashtu si zogu i mbledh thërrimet një e nga një në një ditë të ftohtë dimri, ashtu edhe ti njeriu i madh që bën gjëra të mëdha, i llogarit ditët që një e nga një bëhen të njohura. Dhe ti prapë aty në pritje të së panjohurës.

Siç e sheh e panjohura ka vendosur të qëndrojë me ty qysh nga hershmëria. Këtë nuk e zhbën dot. Atëherë jeto edhe një ditë. Jeto jo thjesht për të marrë dhe dhënë frymë. Jeto që për çdo ditë që lë pas të kesh në zemrën tënde më shumë virtyteve, më tepër mirësi, më tepër dashuri të pastër dhe të pandotur nga, njeriu i madh që bën gjëra të mëdha.

Ti je një nga të gjithë. Ji i lumtur që t'u dha edhe një ditë. Edhe një ditë do të thotë edhe një mundësi më e madhe që të kthjellësh mbi madhësitë tënde dhe të zbresësh nga froni ku mendon se je ulur dhe të jesh ai njeriu i thjeshtë që kënaqet me atë që zotëron, por edhe që lufton që edhe një ditë të jetë më e vlefshme kur ajo të përfundojë tek të njohurat e ekuacionit.

Mos harro! Edhe një ditë. Edhe një mundësi e artë për t'u kthjellur mbi jetën e virtytshme. Mbi jetën e moralshme. Mbi jetën që nuk i përjashton gabimet, por i korrigjon dhe përmirëson. Mbi jetën që ke mundësi ta vendosësh në hijen e virtyteve.

Mos harro! Edhe një ditë.



Tamahu

dhe sakrifica...

— Ahmet Zijlan —

Paraja është edhe mirësi, edhe bela. Pasuria është edhe mirësi, edhe fatkeqësi... Këtë e shkaktojnë shumë shkaqe të ndryshme. Njëri prej këtyre shkaqeve janë njerëzit e shumtë që kanë lakmi. Me këtë po deshët nënkuptoni ata që kanë smirë e zili, apo po deshët nënkuptoni ata që me të vërtetë u nxihen sytë për shkak të nijetit të keq. Prandaj pasuria nganjëherë mund të shndërrohet edhe në fatkeqësi. Për këtë arsye, njerëzit që kanë mundësi ekonomike duhet të kenë shumë kujdes ndaj njerëzve që i rrethojnë. Ata nuk duhet ta shfaqin veten të fuqishëm. Përpjekja për t'u shfaqur më i pasur dhe më i fuqishëm seç je, mund t'i shkaktojë probleme njeriut. Por për fat të keq, njerëzve u mësohet plotësisht e kundërta e kësaj.

Në Kazakistan kam pasur një të njohur turk. Ndërsa po bisedonim një ditë, i thashë: “Paraqitja jote duket më e madhe seç je.” “Për shembull?” – më pyeti. Unë iu përgjigja: “Ti je te dhjeta nga aspekti i pasurisë dhe fuqisë, por pamja jote tregon sikur je te pesëdhjeta.” Ai ma ktheu: “Atëherë do të thotë se paskam mangësi! Unë duhet të shfaqem njëqind, sepse kjo kohë u jep vlerë të pasurve dhe të fuqishmëve.” Por në ajetin fisnik thuhet kështu: “...**Jini të drejtë!**...” (Hud, 112; Shura, 15.) Pra, të jemi të devotshëm dhe të veprojmë sipas urdhrave të Zotit (xh.sh.). Të vërtetën nuk duhet ta shprehim vetëm me gjuhë, por atë duhet ta reflektojmë edhe me gjendjen tonë... A nuk do të ishte devijim nga rruga e drejtë përpjekja për t'u shfaqur i ndryshëm nga seç je? A nuk do të ishte mashtrim i njerëzve kjo gjë? Çfarë thotë Mevlana: “Ose duku siç je, ose ji siç dukesh!”

Për fat të keq, në kohën tonë po përballemi me gjëra mjaft shqetësuese. Biseda që zhvillohen me plot mendjemadhësi, shfaqjet e tepërta të mburrjes,

lavdërimet duke u veshur me rroba firmato dhe shtirjet duke bërë shpenzime kolosale. Këto janë veprime që e kalojnë cakun...

Në të kaluarën nuk ka qenë kështu. Atëherë ka pasur rregulla të mrekullueshme. Për shembull: Nëse një njeri do të merrte disa kilogram mish, ato nuk i merrte prej kasapit kur aty gjendeshin edhe njerëz të tjerë, por priste derisa të largoheshin ata. Nëse blinte fruta, perime e gjëra të tjera të ngjashme me to, i fuste në shportë duke i mbuluar me ndonjë copë, në mënyrë që të mos i shikonin të tjerët. Këtë e bënte që të tjerëve të mos u ngelnin sytë te ato që kishte blerë. Kur njerëzit gatuanin në shtëpitë e tyre, nuk bënin gjellë që përhapnin aromë të këndshme. Ata bënin kujdes në këtë çështje, në mënyrë që të mos i shkonte mendja edhe fqinjit. Por edhe nëse gatuanin ushqime që përhapnin aromë të këndshme, patjetër u çonin edhe fqinjëve.

Tani le të tregojmë dy histori të përjetuara/të vërteta në lidhje me ato që mund t'i ndodhin njeriut nëse shfaqet më i madh seç është. Këto dy histori le të gdhenden mirë në mendjet tona:

Hani Shire në Gaziantep, kishte qenë në burg para viteve 80-90. Pas luftës së çlirimit, në një fshat ishte vararë një person. Për këtë vrasje kishin kapur një burrë që s'kishte lidhje me të dhe e dënuan me burg duke i thënë: “Ti e ke vararë atë.” Edhe pse burri u kishte thënë: “Unë nuk e kam vararë.” – gjykata e kishte dhënë verdiktin e saj dhe faji i kishte ngelur atij. Pasi kishte vuajtur për vite me radhë në atë burg, ngjarja ishte zbardhur dhe ishte gjetur vrasësi i vërtetë. E nxorën nga burgu burrin që kishte me vite aty brenda. Të turpëruar e kishin pyetur:

“Ti ke qëndruar në burg për kaç shumë vite ndër-kohë që ke qenë i pafajshëm. Por asnjëherë nuk të

kemi dëgjuar të bërtasësh me të madhe. Asnjëherë nuk the duke bërtitur: Unë jam i pafajshëm. Përse po më fusni në burg?” Burri e kishte ulur kokën dhe ishte përgjigjur: “Unë jam fajtor.” Ata e pyetën: “Si qenke fajtor? Fajtori i vërtetë doli në pah.” Burri u tha: “Unë nuk jam fajtor për ngjarjen e asaj vrasje, por jam fajtor për një vrasje tjetër!..” “Ashtu?!” – i thanë ata. Burri kishte filluar të tregonte historinë e tij të zezë:

“Kur u lirova nga ushtria dhe po kthehesha në shtëpi, në rrugë u takova me një ushtar tjetër. Edhe ai ishte liruar nga ushtria dhe po kthehej në vendlindjen e tij. Të dy bashkë morëm rrugën për një kohë të gjatë. Përgjatë gjithë rrugës më thoshte: “Atje ku shkova fitova dhe mblodha kaq para. Kur të kthehem në vendlindje, do të marr këtë e atë.” Duke ecur, arritëm te një pus. Morëm ujë nga pusi, pimë, lamë duart e fytyrën dhe morëm abdest. Për shkak të atyre që më tregoi, shejtani më hyri në zemër dhe ma tërhoi nefsën. Me vete thashë: “Ky duhet të ketë shumë para!” Prandaj vendosa ta vrisja dhe t’i merrja paratë.

Filluam të falnim namazin. Atë e nxora imam. Kur ra në sexhde, ia ngula thikën në kurriz. Shejtani mi pati marrë mendtë. Ai vdiq. Menjëherë i kontrollova të gjithë xhepat dhe trupin, por nuk kishte asgjë! Ai nuk kishte as para dhe as florinj! Madje, nuk kishte asnjë qindarkë. Për fat të keq, ai më ishte mburrur përgjatë gjithë rrugës. Ai ia përgatiti fundin vetes me gjuhën e tij. Unë pastaj u pendova shumë, sepse u bëra vrasës për asgjë. Atë e varrosa dhe askujt nuk i thashë gjë për të. Arrita në fshat. Askush nuk më kërkoi dhe nuk më pyeti për atë vrasje, sepse askush nuk e dinte se unë isha takuar me atë. As të afërmit e tij nuk më njihnin mua, as unë nuk i njihja të afërmit e tij. Çështja do të mbyllej dhe do të harrohej, por pa kaluar shumë kohë, në fshat u vra një burrë. Për vrasjen më akuzuan mua. Unë nuk kundërshtova ngaqë e mbaja mend krimin që kisha bërë më parë. Për këtë arsye, iu nënshtrova fatit. Unë e meritoja këtë ndëshkim.”

Mesazhi që mund të nxjerrim nga historia: “Drej-tësia e gjen vendin e saj!”

Pasuria, paratë... Njeriu asnjëherë nuk duhet të lavdërohet me këto. Veçanërisht duhet të dijë t’i fshehë sekretet tregtare dhe financiare. Tamahu ndaj parasë dhe pasurisë është një katastrofë në të cilën mund të bjerë njeriu. Për këtë arsye, nuk duhet të shfaqim tamah ndaj askujt. Përveç të tjerash, duhet të ruhem nga syri i keq, smira dhe nijeti i keq...

Historia tjetër:

Dy burra endacakë po ecnin bashkë. Gjatë rrugës panë një burrë tjetër që ishte shtrirë duke fjetur nën hijen e një peme. Njëri prej këtyre endacakëve e kishte nxitur atë tjetrin duke i thënë: “Shiko, ky i paska këpucët e reja. A t’ia vjedh këpucët?” Enda-

caku tjetër e kishte pyetur: “Si mund t’ia marrësh? Ai i paska vënë ato nën kokë...” Ai ia ktheu: “Shiko se si do t’ia vjedh! Eja me mua!..”

Ata të dy kaluan në anën tjetër të pemës. Morën diçka në dorë dhe filluan të gërmonin dheun. Burri që po flinte u zgjua kur i dëgjoji zërat. Ai u zgjua, por ngaqë nuk i njihnte se kush ishin ata dy endacakët, vazhdoi të bënte sikur po flinte. Të dy shokët endacakë hapën një gropë dhe pastaj e mbyllën. Gjithashtu bënë edhe një bisedë ndërmjet tyre si kurth për burrin që po flinte. Pastaj filluan të flisnin me zë të ulët gjoja sikur tani e panë atë që po flinte:

-Ore, ne paratë i groposëm këtu, por ky njeri qenka shtrirë e po fle pikërisht këtu. Po nëse ky njeri na ka parë apo na ka dëgjuar? Po nëse ngrihet dhe i merr paratë pasi të ikim ne?

-Jo, jo, a nuk e shikon? Ai është zhytur në një gjumë të thellë.

-Nuk i dihet. Le ta provojmë një herë dhe të shohim nëse po fle apo jo...

-Si do ta provojmë?

-Le t’ia tërheqim dalë nga dalë këpucët që i ka te koka. Nëse lëviz, do të thotë se ka qenë zgjuar. Nëse ka qenë zgjuar, duhet t’i marrim paratë. Nëse nuk bën zë, atëherë do të thotë se është në gjumë të thellë. Nëse është në gjumë, nuk ka ndonjë problem.”

Burri që po bënte sikur po flinte, u mashtrua nga ky kurth. Endacakët shkuan dhe ia tërhoqën këpucët që kishte nën kokë. Burri vazhdonte të bënte sikur po flinte, sepse pandehte se do të merrte paratë që kishin groposur ata. Ai mendoi: “Çfarë problemi ka nëse ikin këpucët? Sidoqoftë do të marr gjithë ato para.”

Të dy hajdutët ia morën këpucët dhe u larguan. Kur burri që po flinte u siguria se ata u larguan, menjëherë u ngrit dhe e hapi gropën që e kishin mbuluar ata. Por sado që gërmoi, nuk gjeti asnjë gjë.

Në këtë mënyrë, të dy endacakët ia morën këpucët burrit që po flinte para syve të tij. Si arritën t’ia merrnin? Me karrem... Gjuetia në shumicën e rasteve bëhet me karrem. Në majën e grepit gjithmonë vendoset një karrem. Po të mos vendosej karremi cili peshk do të shkonte dhe ta kapte grepin me gojë? Pra, karremi është kamuflazhi i kurthit.

Edhe disa prej mashtruesve janë të tillë. Ata hedhin një karrem që njeriu mund ta lakmojë shumë. Në këtë mënyrë, ndërkohë që njeriu mendon se do të vendos një dhe do të fitojë tre, humbet edhe atë që ka.

A të gjithë njerëzit janë të këqij? Le të mos biem në pesimizëm, por asnjëherë të mos e harrojmë edhe ekzistencën e të keqes dhe të keqit. Sugjerimi



ynë nuk është që të fshihemi apo ngujohemi, por të mos mburremi dhe të mos lavdërohemi, sepse shfaqjet e tilla tërheqin vëmendjen e njerëzve.

Njerëzit në përgjithësi përpiqen të matin fuqinë e njëri-tjetrit, sepse, është e lehtë që t'ia marrësh më lirë mallin dikujt që ka rënë në gjendje të vështirë. Për këtë arsye, njeriu nuk duhet ta shfaqë vështirësinë ekonomike nëse ka rënë në një gjendje të tillë. Edhe kjo histori është një shembull domethënës për këtë:

Një gjykatësi i kishin sjellë një çështje gjyqësore. Një djalë i ri kishte marrë vajzën e një burri pa dëshirën e këtij të fundit. Më së fundi e kishin kapur të riun dhe e kishin sjellë. Babai i vajzës ishte i nxehur dhe thoshte: “E akuzoj atë për grabitjen e vajzës sime. E akuzoj.”

Gjykatësi ishte kthyer nga djali i ri dhe e kishte pyetur: “Përse e more vajzën ti?” I riu ia ktheu: “Ja kërkoja dorën e vajzës, por ai nuk ma dha. Unë e desha atë vajzë, prandaj edhe e mora.” Pastaj gjykatësi ishte kthyer nga babai i vajzës dhe i kishte thënë: “Mirë, po ti përse nuk e dhe vajzën?” Babai i vajzës ishte përgjigjur: “Pa shikoje një herë gjendjen e tij! Për çfarë t'ia jap vajzën atij? Ai nuk ka as rroba për të veshur. Nuk ka as shpi e as katandë. Ai nuk mund të ngopë me bukë as veten. Atëherë si mund të përkujdeset për bashkëshorten?”

Gjykatësi në ato momente kishte bërë një manovër. Ishte kthyer nga djali, kishte bërë sikur i ishte nxehur dhe i kishte thënë: “Bir, përse nuk i ke thënë babait të vajzës se ti ke njëqind dele dhe dy lopë ndërmjet kafshëve tona?..” Babait të vajzës i ishin hapur sytë dhe kishte pyetur: “Me të vërtetë ky djalë i ri ka njëqind dele dhe dy lopë?” Gjykatësi i ishte përgjigjur: “Po, i ka...” Në ato momente,

babai i zemëruar ishte shndërruar në një engjell dhe ishte shprehur: “Përse nuk më ke thënë more bir? Meqë qenka kështu...” Gjykatësi menjëherë kishte thënë:

“Atëherë nuk ngeli më gjë për t'u sqaruar. Puthe bir dorën e babait!..” Gjykatësi e kishte rregulluar këtë çështje duke dhënë pak prej pasurisë së tij. Pasuria i pajton njerëzit. Edhe neve na ka ndodhur që të bëjmë pajtime të tilla:

Kemi pasur një të afërmin tonë. Kjo ka ndodhur para shumë vitesh. Një ditë shkova për ta vizituar. Kur e pyeta për gjendjen, ma ktheu: “Po vdesim dhe po ngjallemi përsëri.” Unë e pyeta: “Çfarë do të thotë kjo?” Ai mu përgjigj: “Bijtë e mi patën punuar si dy vëllezër ortakë. Pastaj u ndanë. Kur u ndanë, lindën kontradikta ndërmjet tyre. Njëri thotë: ‘Unë kam tetë milion për të marrë prej teje.’ Tjetri i thotë: ‘Nuk ke asgjë për të marrë prej meje!’ Vëllai i vogël i thotë se ka një dokument që e vërteton se ka për të marrë tetë milion nga vëllai më i madh. Ai tjetri i thotë se nuk ka asgjë për të marrë prej tij.

Ndërkohë që grindeshin për çështjen e parave, arritën deri në atë gjendje sa që djali i madh në praninë tonë mori hanxharin në dorë dhe deshë ta vriste vëllain e vogël. E ndoqi nga pas duke i rënë katër herë rreth e rrotull oborrit. Po ta kishte zënë, do ta kishte vlarë. Ata nuk dëgjojnë as fjalën e këshillën e nënës së tyre, as timen. Njëri prej tyre iku dhe u largua. Ata do ta gjejnë përsëri njëri-tjetrin dhe do të zihen. Nëse do të zihen përsëri, do ta vrasin njëri-tjetrin. Si mund ta durojë prindi këtë situatë! Nuk dimë çfarë të bëjmë. Bir, të lutem na ndihmo! Gjeji ata dhe këshilloji! Bëj ndonjë gjë dhe gjeje një rrugëzgjidhje!”

Pa mendoni: Edhe ai që ikte, edhe ai që e ndiqte me hanxhar ishin bijtë e tij! Pa mendoni për vuajtjen dhe dëshpërimin e atij. Njeriu tmerrohet nga kjo gjendje.

Njërin prej vëllezërve e gjeta dhe i thashë: “A nuk ju erdhi turp të ziheni para prindërve tuaj për para? A nuk e keni frikë Allahun?” Ai mu përgjigj: “Unë nuk jam zënë. Unë thjeshtë kam kërkuar të drejtën time. I thashë që kam edhe dokument që e vërteton të drejtën time. Prandaj do t’i marr ato para. Përse të mos i marr në fund të fundit? Edhe më nxjerrin jashtë, edhe nuk ma japin hakun tim.” Pasi u shpreh me këto fjalë, unë i thashë:

“Lëreni zënkën! Hiq dorë nga ato para! Të paktën hiq dorë nga gjysma e tyre! Gjeni një pikë të mesme dhe pajtohuni!” Ai ma ktheu: “Nuk bën aspak! Unë do t’i marr paratë e mia.” Pastaj shkova te vëllai i më i madh dhe i thashë: “Ju qenkeni zënë në prani të prindërve tuaj. A aspak nuk keni frikë nga Allahu? Përse i mërzisni ata? Le të gjejmë një pikë të mesme! T’i jepi gjysmat e parave, pastaj ai të heqë dorë nga gjysma tjetër e tyre! Në këtë mënyrë le të marrë fund kjo çështje. Si thua?” Ai mu përgjigj:

“Unë kam të drejtë. Madje jam viktimë e kësaj çështjeje. Edhe nëse vdes, nuk i jap gjysmat e atyre parave. Madje, as pesë qindarka nuk i jap. Ai po më bën padrejtësi. Ndërsa ju e mbron atë!”

Pra, njëri thoshte se kishte dokument që mund t’ia jepte gjykatës dhe ta merrte hakun e tij, ndërsa tjetri thoshte se nuk jap as pesë qindarka edhe nëse vdes. Që të dy ishin të vendosur në këmbënguljen dhe inatin e tyre. Këshibënte dobi asnjërit vëllezërve. Shkaku i edhe varfëria... Të ulla nuk u prej të dy kësaj ishte urtët kanë thënë: “Pasuria të pajton, varfëria të fut në grindje, ndërsa sakrifica të qetëson.”

Ata kishin edhe një vëllai tjetër në Stamboll. Ai nuk e kishte gjendjen e keqe. Vëllezërve të zemëruar u thashë: “Me sa duket ju nuk do të hiqni dorë nga inati juaj. Prandaj këto para do t’i marr nga vëllai juaj në Stamboll. Ato para do t’ia jap atij që i kërkon. Ndërsa ai që nuk i jep, nuk do të paguajë gjë prej xhepit të tij. Të paktën këtë mos e kundërshtoni, në mënyrë që të marrë fund kjo zënkë.”

Pastaj veprova ashtu siç u thashë vëllezërve të zemëruar. Shkova te vëllai i tyre në Stamboll dhe bisedova me të. Atij i thashë: “Gjendja është kështu e kështu... Që të dy i ke vëllezër. Ata i kanë hipur kalit të shejtanit. Nëse ti i jep paratë për zgjidhjen e

kësaj çështjeje, ai që i kërkon do t’i marrë paratë e tij dhe ai që nuk pranon, nuk do të paguajë gjë nga xhepi i vet. Në këtë mënyrë, do të zgjidhet çështja dhe do të marrin fund vuajtjet e prindërve tuaj.”

Ai ma ktheu: “A për ata i kam fituar paratë unë!.. Le të bëjnë çfarë të duan!..” Me sa kuptova, kjo çështje nuk do të zgjidhej. Për këtë arsye, i thashë: “Nëse ti e pranon këtë propozim, gjysmën e parave do ta jap unë. Atyre nuk do t’u tregoj se e kam dhënë unë gjysmën e parave. Nëse u tregoj, nuk do të pranojnë. Ndërsa ti je vëllai i tyre. Nëse i jep ti, ata do të pranojnë. Prandaj, paratë do t’ua japësh ti atyre. Ndërsa për mua nuk do të dinë asgjë.” Vëllai i tyre u mendua dhe mu përgjigj: “Në rregull atëherë!” Ne vepruam siç vendosëm dhe çështja u mbyll. Paraja nuk njeh as vëllai, as të afërm. Paraja është edhe mik, edhe armik.

Siç shohim
dhe zemë-
n d e r -
r a

çdo ditë, ka zënka rime të panumërta mjet vëllezërve e motive, ortakëve, të afërmeve, fqinjëve dhe së fundi ndërmjet besimtarëve... Një pjesë e tyre buron nga trashëgimia, një pjesë nga inati dhe një pjesë nga përçarja. Ndërkohë që themi: “Unë e di! Unë kam të drejtë!”, na nxisin edhe nefs i shejtani dhe dalin në pah këto grindje e zënka të padëshiruara. Të gjithë do të shpërngulemi nga kjo botë e përkohshme. Prandaj, a ia vlejnë këto grindje? Po sakrifikojmë pak, çdo gjë rregullohet. Së fundi, gjithmonë fiton ai që sakrifikon.

Sido që ta quajmë pasurinë, para, pronë, mall apo diçka tjetër, ajo është një sprovë e madhe. Nëse atë nuk e mbajmë si mjet, menjëherë fillon dhe na fut në përçarje. Si rezultat dalin zënkat “unë kam të drejtë, ti ke të drejtë”. Në këtë mënyrë, nuk na ngelet as ëmbëlsi në gojë dhe as prehje në shpirt.

Ata që e dinë se pasuria është mjet i përkohshëm për sprovën në këtë botë dhe që pranojnë të heqin dorë prej saj apo ta sakrifikojnë, do të gjejnë prehje në të dy botët. Allahu i Lartësuar na ruajt nga e keqja e shejtanit, nga e keqja e nefsit, nga e keqja e përçarjes së hipokritit, nga e keqja e armikut, nga e keqja e pasurisë dhe varfërisë dhe nga e keqja e epshit!

Amin!..



Një përrallë, pastaj shumë përralla

Edison Çeraj

Pse nuk ka autor përmbledhja me përralla *Njëmijë e një net*? Sepse disa “mesazhe” ekzistojnë para “autorit”; ato thjesht duhen kujtuar, domethënë rrëfyer. Duhet rrëfyer sepse natyra jonë është harrestare, ose e thënë më shkokuq: jemi qenie që prekemi nga “epidemia” e harresës. Çfarë harrojmë ne? Sipas të gjitha gjasave, ne harrojmë atë që na ruan si të tillë, si njerëz, njerëzoren, duke u dhënë pa e vënë re pas çështjes se si të jetojmë. Kështu, çështja se pse jetojmë, vjen një ditë jo dhe aq e bukur e zbrazet nga çdo domethënie, nga çdo shenjë, e për pasojë thjesht e shohim si të tepërt. Thellë-thellë ne e dimë që nuk është kështu, por tashmë kemi frikë, një frikë që i ka lënë vendin moskokëçarjes.

Mbase për këtë arsye të rriturit nuk i lexojnë dot përrallat, e jo se ato janë për fëmijët.

Fëmijëria është gjendja më e kulluar e njerëzores, ja pse me të drejtë na duket sikur përrallat janë vetëm për fëmijët, sepse në këtë rast kemi përputhje të plotë mes dy gjendjeve që përfaqësojnë të njëjtën gjë: tejkalimin e kohës dhe të hapësirës dhe mungesën e çdo kuptimi që kushtëzohet prej tyre. Është pikërisht ky tejkalim që na nguc, që nuk na lë të qetë, pra, që na kujton se koha dhe hapësira nuk janë realiteti i fundëm, por fundi i realitetit që ne kemi ndërtuar në një bashkëveprim të kushtëzuar me to, dhe ajo që vlen në fund nuk janë “arritjet”, por se sa e kemi ruajtur “fëmijën” brenda nesh.

Pra, të rriturit nuk i durojnë dot përrallat sepse ato u kujtojnë se kanë kryer një krim: se kanë vrarë “fëmijën” brenda tyre.

Përrallat na kujtojnë se thelbi i paraprin ekzistencës, ndaj dhe ne përfshihemi aq lehtë në botën e tyre magjike, pavarësisht botës empirike, ekzistencës, e cila vijon me ligjësitë e saj logjike teksa ne jemi arratisur prej saj. Nëse ekzistenca do t’i paraprinte thelbit, kjo arrati/shkëputje nuk do të ishte e mundur, dhe për pasojë përrallat do të ishin vetëm përrallësi. Në fakt, për disa të tilla janë, ose kohë e çuar dëm.

Përrallat na kujtojnë se njeriu është çfarë ndien, do dhe imagjionon, e jo çfarë thotë dhe vepron, pasi këto të fundit janë të kufizuara nga rrethanat, këto bija besnike të kohës dhe hapësirës.

Në njëfarë mënyre, të gjitha përrallat janë një përrallë e vetme. Kemi të bëjmë me një arketip themel, i cili shpërfaqet me një morfologji të ndryshme duke u përshtatur në kohë dhe hapësirë, në varësi të nevojës për kujtesë.

“Që kur Claude Lévi-Strauss-i tërhoqi vëmendjen mbi teorinë e paraqitur në 1918 nga folkloristi rus Vladimir Prop, sipas së cilës të gjitha përrallat e botës nuk do të ishin veçse variante të një modeli të vetëm përrallash, ideja e rikrijimit të formulës së një përralle universale ka pasur sukses midis studiuesve.

Meriton kësisoj të jetë shënjuar, së paku si kuriozitet, fakti se së njëjtës intuitë, qoftë edhe e shmangur, kish arritur, pesëdhjetë vite më parë, një folklorist mantovan, Isaia Visentini, i cili në 1899 shkruante në lidhje me gërshetimet e përrallave popullore që gjenden kudo të përsëritura dhe të lidhura në mënyrë të ndryshme sipas një numri të përmbyllur kombinimesh: «Ai që është marrë me këto përmbledhje të veçanta e di më mirë se unë se është një lëmsh i pambarimtë: njëra futet te tjera, si unazat e një zinxhiri, ku shpesh më ka lindur në kokë mendimi për të krijuar nga ajo rrëmujë novelëzash një lloj përralle të vazhdimtë, në të cilën parashikoj lidhjet sekrete, por për të cilën më mungon koha e ndoshta edhe durimi. E pastaj kush do ta merrte parasysh lodhjen time? Është edhe e tepërt nëse do të gjej ndonjë lexues të ri për këto përralla, sapo të dalin në dritë.»¹

Kështu, përrallat nuk kanë “autor”, por vetëm “vjelës” që i përcjellin herë pas here. Ato nuk mund të krijohen: thjesht mund të përkthehen, përtej kuptimit të parë të përkthimit.

1. Calvino, I. (2015) *Mbi përrallën*, f. 153, përkth.: Rigel Rizaj. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.

Katër stinët e njeriut

— Ferudun Ozdemir —

Një herë e një kohë jetonte një plak që kishte katër djem. Ai dëshironte t'i edukonte ata të mos merrnin vendime para kohe dhe të mos paragjykonin të tjerët. Kështu, kërkoi nga secili prej tyre të vrojtojnë një pemë të largët.

Djali i parë shkoi tek pema kur ishte dimër, i dyti në pranverë, i treti në verë, ndërsa i katërti në vjeshtë.

Pasi u kthyen i thirri të gjithë dhe u kërkoi të shpjegonin ç'kishin parë. Djali i parë tha se pema ishte shumë e shëmtuar, e vjetër dhe e thatë. Ndërsa djali i dytë tha se ishte plot jetë dhe gjallëri. Djali i tretë kishte tjetër mendim: "Nuk kisha parë pemë me pamje kaq madhështore, lule kaq të bukura dhe aromë kaq të këndshme."

Djali i katërt tha se të tre vëllezërit e tij e kishin gabim, ngase pema ishte plot me fruta.

Plaku i urtë u tha djemve se, të gjithë kishin të

drejtë sepse secili prej tyre e kishte parë pemën në stinë të ndryshme. U mundua t'u tregonte atyre se pema ose njerëzit nuk duhen vlerësuar vetëm në një stinë duke lënë shteg për paragjykim.

"Të vërtetën mund ta kuptoni vetëm pasi të keni parë katër stinët e njeriut. Nëse hiqni dorë menjëherë nga një njeri, nuk mund të njihni të katër stinët e tij." - tha ai.

Mos lejoni që dhimbja e një stine të shkatërrojë stinët e tjera të bukura. Mos e gjykoni jetën, miqtë dhe të dashurit tuaj për shkak të një stine apo periudhe të caktuar. Sepse ne njerëzit, ashtu sikur edhe stinët mund të kemi kohët tona të bukura apo ato të vështira. Ky krahasim, tregon se për të arritur pjekurinë si individë shpesh kemi nevojë për një proces pushimi dhe reflektimi, për të sjellë në jetën tonë një stinë pranvere.

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI





Umare ibn Hazmi

- RADIJALLAHU ANHU -

SAHABI QË PENGONTE REALIZIMIN E ÇDO PËRPJEKJEJE TË PËRÇARËSVE.

— Mustafa Erish —

Umare ibn Hazmi (r.a.), ishte një besimtar që punoi dhe u përpoq fort për përhapjen e Islamit në Medinë, gjithashtu ishte ndër iniciatorët e luftës kundër idhujve!

Ai ishte luftëtari që mbajti flamurin e Beni Malikëve, në çlirimin e Mekës dhe në luftën e Tebukut!

Umare ibn Hazmi (r.a.), ishte një sahab fatlum sepse qe pjesëmarrës në besëlidhjen e dytë të Akabesë, në të cilën një grup prej shtatëdhjetë e pesë vetash dhanë besën për ta mbrojtur, deri edhe me jetën e tyre, të Dërguarin e Allahut, (a.s.).

Umare ibn Hamzi (r.a.), lindi dhe u rrit në Medinë. Ai ishte prej Beni Nexharëve, që ishin pjesë e fisit Hazrexh, i cili në atë kohë ishte njëri prej dy fiseve më të mëdha në Medinë. Babai i tij ishte prej të parëve të fisit, njeri i nderuar dhe i respektuar. Nëna e tij ishte Halide binti Ebu Unejsi, prej Beni Saidëve.

Umare ibn Hazmi (r.a.) u nderua me hyrjen në Islam në sajë të predikimit dhe thirrjes islame, e cila filloi në Medinë pas rikthimit të myslimanëve që morën pjesë në besëlidhjen e parë të Akabesë. Ai vetë mori pjesë në besëlidhjen e dytë të Akabesë, që u zhvillua një vit më pas. Ai ishte pjesë e grupit prej shtatëdhjetë e pesë vetësh, të cilët e ftuan në Medinë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), dhe i dhanë besën për ta mbrojtur deri edhe me jetët e tyre!

Umare ibn Hamzi (r.a.), ndihmoi shumë në përhapjen e Islamit në Medinë. Ai ishte fqinj me Ebu Ejub el-Ensariun (r.a.). Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, u vendos në shtëpinë e Ebu Ejub el-Ensariut (r.a.), ai përfitoi nga kjo afërsi në formën më pozitive të mundshme.

Umare ibn Hamzi (r.a.), e vizitonte shpesh të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Në këtë mënyrë, pati fatin t'i qëndronte tepër afër dhe t'i shërbente Pejgamberit tonë të nderuar. (Ibn Sa'd, III, 486.)

Ai e ftonte shpesh Pejgamberin e Allahut, (a.s.), në shtëpinë e tij dhe hanin së bashku. Ai i bënte dhurata të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Dashurinë që ndjente në zemër për Pejgamberin (a.s.), përpiquej ta tregonte duke i shërbyer dhe duke i bërë dhurata, madje, herë pas here bënte edhe shaka me të Dërguarin e Allahut, (a.s.).

Umare ibn Hazmi (r.a.), i kishte caktuar vetes, si detyrë parësore, mbrojtjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Sa herë që dëgjonte ndonjë lajm të dyshimtë, ai rrinte roje tek dera, gati për mbrotje ndaj çdo rreziku që mund të vinte nga çifutët dhe politeistët. Pejgamberi e shpalli atë vëlla me Muhriz ibn Nadle (r.a.), i cili ishte një prej muhaxhirëve.

Umare ibn Hazmi (r.a.), mori pjesë në të gjitha luftërat, duke filluar që nga lufta e Bedrit, Uhudit dhe Hendekut. Ai ndërmoi gjeste heroike të mëdha nëpër mejdanet e luftërave.

Umare ibn Hazmi (r.a.), ishte i njohur për gazmoret e tij. Edhe vetë i Dërguari i Allahut, (a.s.), qe prezent në shakanë që Umare ibn Hazmi (r.a.), i bëri Zejd ibn Thabitit (i cili në atë kohë ishte ende një djalosh), ndërsa po gërmonin për të hapur hendekun.

Ngjarja ndodhi si më poshtë:

Të gjithë myslimanët, të mëdhenj e të vegjël, morën pjesë në aksionin e nevojshëm për të hapur hendekun. Zejd ibn Thabitin (r.a.), i cili ishte një djalosh rreth të pesëmbëdhjetave, e zuri gjumi nga-

që ishte lodhur duke gërmuar e duke ngarkuar dhe. Sahabët e nderuar u treguan të mëshirshëm kundrejt tij dhe e lanë të flinte në një cep të hendekut. Ndërkohë vetë përparuan edhe më shumë në punime. Umare ibn Hazmi (r.a.) shkoi pranë Zejdut dhe, për të bërë shaka, ia mori armët dhe ia fshehu.

Kur Zejdi (r.a.), u zgjua dhe nuk i pa armët pranë, filloi t'i kërkonte rreth e rrotull i shqetësuar. Pasi nuk i gjeti, filloi të shqetësohej edhe më tepër, si dhe të frikësohej. Kur e dëgjoi këtë ngjarje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e thirri Zejdin pranë vetes dhe iu drejtua me një fytirë të buzëqeshur:

"O gjumash! Ti u zhyte në gjumë e kështu të humbën edhe armët!"

Pastaj u kthye nga sahabët dhe i pyeti: *"A ka ndodhur një që e di se ku ndodhen armët e këtij djaloshi?"*

Umare ibn Hazmi (r.a.), menjëherë u ngrit në këmbë dhe pohoi: *"O i Dërguari i Allahut! Armët i kam unë."*

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha Umares: *"O Umare! Dorëzoja armët djalit!"*

Pastaj iu kthye sahabëve, duke i udhëzuar me një rregull që duhet ta zbatonin përgjatë gjithë jetës dhe që këshillonte se *"nuk ishte i drejtë frikësimi i myslimanit apo fshehja e sendeve të tij, qoftë edhe për shaka"*. (Vakidi, II, 448; Hakim, III, 476.)

Umare ibn Hazmi (r.a.), mbajti flamurin e Beni Malikëve në ditën e çlirimit të Mekës dhe në luftën e Tebukut. Ai nuk lejoi të krijohej asnjë mundësi që hipokritët të shkaktonin përçarje përgjatë udhëtimit. Hipokritët, që gjendeshin në njësinë e tij, i përjashtoi.

Hipokritët, që morën pjesë në luftën e Tebukut, nuk reshtnin në tentativat e tyre për të krijuar përçarje e prishje dhe shpërfaqnin hipokrizitë e tyre kurdo që u jepej mundësia. Ndër ta radhitej edhe Zejd ibn Lusajti, i cili kishte origjinë çifute. Ai e shfrytëzoi ngjarjen e humbjes së devesë së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe filloi të nxiste përçarje. Ironizonte mbi faktin se Profetit i vinin lajme nga qielli, por se nuk e gjente dot as devenë e vet. Kjo ishte strategjia, përmes së cilës u përpoq të përhapte dyshime në lidhje me profecinë e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). I gjendur përballë kësaj tradhëtie, Umare ibn Hazmi nuk arriti ta kapërcejë dot padrejtësinë dhe mori menjëherë vendimin që të përjashtojë Zejd ibn Lusajtin nga njësia e tij. Atë e njoftoi se, pas kësaj ngjarjeje, nuk mund të vazhdonte më udhëtimin së bashku me ta. (Ibn Hisham, IV, 166-167.)

Umare ibn Hazmi (r.a.), transmetoi tri hadithe nga i Dërguari i Allahut, (a.s.):

- Umare ibn Hazmi (r.a.), transmeton: I Dërguari i Allahut, (a.s.), më pa duke qëndruar mbi një varr

dhe më sqaroi: *"Largohu nga varri, sepse po e mundon të ndjerin që prehet aty!"* (Hakim, III, 682.)

- Umare ibn Hazmi (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka sqaruar: *"Ekzistojnë katër veprime të cilat duhen përmbushur, si kusht që një individ të konsiderohet prej myslimanëve. Ai që e lë pa kryer njërin prej tyre, tri të tjerët nuk i bëjnë plotësisht dobi."*

Transmetuesi sqaron më tej: *"Umares i kërkova të m'i cilësonte këto katër veprime. Ai m'u përgjigj: "Namazi, zekati, agjërimi i Ramazanit dhe haxhi."* (Usdu'l-Gabe, IV, 129.)

- Edhe hadithi i tretë transmetohet brenda një ngjarjeje të tillë:

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, vazhdimisht i ka inkurajuar shërbimet ndaj dijes dhe Kuranit Fisnik. Ai (a.s.), gjithmonë iu ka dhënë kudo vlerë dhe përparësi njohësve të mirë të Kuranit. Kur u nisën për në luftën e Tebukut, flamurin e Beni Nexharëve ia dha Umare ibn Hazmit (r.a.). Më pas, kur vuri re Zejd ibn Thabitin (r.a.), ia mori flamurin Umares (r.a.) dhe ia kaloi atij. Umare ibn Hazmi (r.a.), e pyeti: *"O i Dërguari i Allahut! A jeni zemëruar me mua?"*

Pejgamberi ynë i nderuar iu përgjigj:

"Jo! Për Zotin nuk jam zemëruar, por edhe ju duhet të zgjidhni Kuranin! Zejdi ka mësuar më shumë Kuran se ti. Ata që e kanë mësuar Kuranin më shumë, edhe në qofshin robër të zinj me hundë të prerë, zgjidhen kundrejt të tjerëve!"


Edhe fisin Evs dhe Hazrexh e urdhëroi që flamujt t'ia besonin atyre që njihnin më shumë prej Kuranit Fisnik. Nisur nga ky urdhër, flamurin e Beni Aufit e mbajti Ebu Zejdi (r.a.), ndërsa flamurin e Beni Selimesë e mbajti Muadhi (r.a.).

Umare ibn Hazmi (r.a.), u martua me nënën e Zejd ibn Thabitit (r.a.), Nevvar binti Malik ibn Sirma. Prej kësaj martese lindi një djalë, të cilin e quajtën Malik.

Umare ibn Hazmi (r.a.), ka qenë prezent edhe në haxhin e Lamtumirës. Ndërsa, pasi ndërroi jetë i Dërguari i Allahut, (a.s.), që ndërmjet atyre që i dhanë besën të parët Ebu Bekrit, (r. a.).

Umare ibn Hazmi (r.a.), që pjesmarrës në ushtrinë që komandonte Halid ibn Velidi (r.a.), së cilës iu dha si detyrë mposhtja e Musejlimetu'l-Kedhdhabit. Ky i fundit pretendonte se ishte pejgamber. Umare ibn Hazmi (r.a.), ra dëshmor në luftën e Akrabasë, në Jemame. Kjo luftë përfundoi me vrasjen e Musejlimesë në vitin 633. (Isabe, IV, 476.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Allahu Teala na e mundësoftë të gjithëve ndjesinë e dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ashtu siç e ndjente edhe Umare ibn Hazmi! Amin!



KODI I

“MBUROJËS SË SHENJTË”

KUNDËR DEVIJIMIT TË MENDËSISË DHE GRAFULLIMIT TË NDJENJAVE

— Idris Arpat —

Në suren Jusuf, të cilën Kurani na e ka paraqitur si më të bukurën e historive, na jepen urtësi, këshilla dhe detaje të panumërta. Në këtë sure jepet një sekret hyjnor që e përmirëson, e mbron dhe e forcon vullnetin përball tundimeve të jashtme dhe të brendshme të shejtanit:

Gruaja e Azizit, ministrit të Egjiptit, Zylejhaja, kishte rënë në sevda me Jusufin (a.s.), të cilin e kishte marrë në shtëpinë e saj si skllav. Ajo dëshironte të bashkohej me të dhe, për këtë arsye, e fton Jusufin (a.s.), në një dhomë të veçantë me dyer njëra pas tjetrës. Ajo i mbyll të gjitha dyert. Dhoma ishte përgatitur, fshehtësia ishte siguruar, të gjitha llojet e lajkave për të joshur një djalë të ri ishin menduar dhe ftesa e të shumëpriturit ishte bërë:

“Eja pranë meje! Ja unë po të dorëzohem me gjithë bukurinë time!”

Dhe pikërisht në atë moment, Jusufi (a.s.), nxjerr prej gjuhës një fjalë magjike e shkëputur prej zemrës së tij, të cilën mund ta quajmë “një mburojë e shenjtë”, për të gjitha kohërat dhe për të gjithë brezat njerëzor që dëshirojnë ta ruajnë veten përballë joshjes së gjynahut:

“Meadhallah!”

Pra, ai tha, “*Allahu më ruajtë apo strehohem tek Allahu!*”, duke i dorëzuar ndjenjat, mendimet dhe instinktet e veta në mbrojtjen e Pronarit të gjithçkaje. Pikërisht ky dorëzim dhe strehim, do të thotë të shtypësh “butonin e emergjencës” për ndihmën hyjnore, gjë e cila aktivizon në moment ndihmën dhe mbrojtjen e Zotit, që e shpëton shprehësin e asaj fjale. Pasi e tregon këtë ngjarje, Kurani e shpreh kështu ndikimin që ka kjo e fshehtë mbrojtëse:

“Ajo e dëshiroi atë; por edhe Jusufi do ta kishte dëshiruar atë, po të mos kishte parë provën (e qartë) e Zotit të vet!..” (Jusuf, 24)

Fjala arabe “burhan”, e cila përdoret në ajet, ka kuptimin “provë e prerë”. Megjithëse nëpër tefsirë gjenden shpjegime të ndryshme në lidhje me këtë fjalë, është e qartë se ajo që e mbrojt Jusufin (a.s.), prej gjynahut ishte një “mburojë hyjnore”. Ja pra, kodet e kësaj mburoje hyjnore, janë fjalët e shkëputura prej zemrës së tij, me anë të të cilave kërkoi strehim tek Allahu.

Fakti që kjo fjali mund të ketë një ndikim të tillë, në pamje të parë mund edhe të mos kuptohet. Mirëpo, niveli ku ka arritur sot teknologjia e sistemit të kodifikimit, mund të na ndihmojë ta kuptojmë më mirë këtë çështje. Edhe nëse sot për sot nuk

mund ta zbulojmë dot se cilat dyer të mendjes dhe të botës sonë të ndjenjave hapin “fjalët” e kërkimit të strehimit tek Zoti të dala nga zemra, apo se çfarë drynash mbyllin ato ndaj ndjenjave të helmatisura, në sajë të këtij informacioni të dhënë nga fjala hyjnore, mund të arrijmë në përfundimin se, këto fjalë janë mburojë e fortë.

Kjo fjalë, nënkupton kërkimin e ndihmës dhe mbrojtjes së Allahut të Madhëruar, i Cili ka fuqi për çdo gjë, nga ana e njeriut që gjendet gjithmonë në rrezikun e mposhtjes prej ndjenjave të veta. Ai që strehohet tek Allahu i Madhëruar, i Cili është Sunduesi i vetëm i gjithçkaje që ka krijuar, padyshim se ka hyrë dhe është strehuar në vendstrehimin më të sigurt.

Ekzistojnë shumë vese egoiste dhe djallëzore që na e turbulojnë botën e mendjes dhe zemrës sonë, na deviojnë dhe na nxisin në shumë ndjenja të ulëta. Mirëpo, Kurani Fisnik na e tregon edhe rrugën e mbrojtjes prej këtyre veseve me anë të kërkimit të strehimit tek Allahu:

“Dhe thuaj: «O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet e shejtanëve, dhe tek Ti mbështetem, o Zoti im, që të mos i kem pranë meje.»” (Mu’minun, 97-98)

“Nëse shejtani përpiket të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (A’raf, 200)

Ata që e shtynë në gjynahe botën tonë të ndjenjave dhe të mendjes me anë të vesëve, mund të jenë shejtan prej njerëzve dhe prej xhinëve. Por edhe në këtë rast, strehimi tek Allahu i Madhëruar, këshillohet si mburoja më e mirë që i eliminon dhe të ruan prej sinjaleve të rrezikshme dhe të helmatisura që mund të vijnë prej atyre të dyve:

“Thuaj: «Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, nga sherri i shejtanit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai shejtan) prej xhindeve apo njerëzve!»” (Nas, 1-6)

Për shkak se gjithmonë është e mundur që mendja të eklipsohet, të gabohet, ose që interesat e egos të dalin në plan të parë, e t’i hapen dyert botëkuptimeve djallëzore, para se të fillohet të lexohet Kuran, është urdhëruar të kërkohet strehim tek Allahu. Urdhër ky, që të bën shumë përshtypje:

“Kur dëshiron të lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar!” (Nahl, 98)

Por, a është kërkim i strehimit tek Allahu i nevojshëm vetëm për të kuptuar drejtë ajetet e Kuranit? Le t’i lexojmë këto shprehje që kanë aromë urtësie:

*“Ata që vesvesin e shejtanit dhe ftesën e tij në gjynahe e kanë pandehur frymëzim prej Zotit, kanë rënë aq poshtë, saqë po e kërkojnë me qiri edhe gjendjen e tyre para se të fillonin udhëtimin shpirtëror. Allahu i Madhëruar, në Kuranin Famëllartë ka urdhëruar: **“Kur dëshiron të lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar!”**. Tani është bërë e qartë se, edhe kur lexohen ajetet e Kuranit Fisnik, edhe kur lexohen ajetet e krijimit dhe ajeti më i madh i gjithë krijimit, që është njeriu, duhet të kërkohet strehim prej shejtanit tek Allahu i Madhëruar.”* (M. Fatih Çitlak, 40 Mektup, Sûfi Yayınları, istanbul-2010, sh. 66-67.)

Kërkimi i strehimit tek Allahu, është rezultati i natyrshëm i njohjes edhe i vetvetes, edhe i Allahut nga ana e njeriut. Pra, kërkimi i strehimit është çështje urtësie dhe njohjeje. Por kjo nuk arrihet vetëm me shqiptimin e fjalëve. Në fakt, kërkimi i strehimit tek Allahu është gjendja e derdhur në kallëpet e fjalëve të përgjërimeve dhe lutjeve që shkëputen dhe vijnë prej thellësive të botës së mendjes dhe zemrës. Ky është treguesi i qartë i ndjesisë së afërsisë hyjnore.

Kjo është edhe arsyeja që i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili i ka kuptuar në mënyrën më të përsosur mesazhet hyjnore, e kishte bërë zakon të përherëshëm strehimin tek Allahu pothuajse në çdo rast. Këto shprehje të kërkimit të strehimit, na tregojnë qartë kuadrin e gjerë që kishte kjo çështje për të Dërguarin e Allahut (a.s.):

“O Allah! Strehohem tek Ti prej përtacisë, matufosjes dhe dobësisë në pleqëri, prej qëndrimit në vendet e gjynahut, prej borxhit, prej fitnes së varrit dhe dënimit në të, prej fitnes së zjarrit dhe dënimit me të, prej fitnes së pasurisë, prej fitnes së varfërisë dhe prej fitnes së El-Mesihu’d-Dexhxhal!” (Buhari, Deauat, 39.)

Shprehjet më të njohura të kërkimit të strehimit tek Allahut janë:

“Eudhu Billah / Strehohem tek Allahu!” Kërkoj që Ai të më mbrojë.

“Meadhallah / Allahu më ruajtë!”

“Eudhu Billahi mine’sh-shejtani’r-rraxhim / Strehohem tek Allahu prej së keqes së shejtanit të dëbuar e të mallkuar!”

Çdo besimtar me horizontin e mendjes të hapur, e di se përveç ndjenjës së strehimit vazhdimisht tek Allahut deri në frymën e fundit, nuk ekziston asnjë strehim tjetër i sigurt. Kështu që, pajisja me mburojën e **“Eudhu Billah”**-it përballë çdo gjynahu, fatkeqësie dhe belaje, ende pa ndodhur, është edhe një urdhër i Kuranit Fisnik, edhe një sunnet profetik.

Ajete që thërrasin për në Xhenet

— Xhafer Durmush —

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në shumë hadithe fisnike, na fton të lexojmë Kuranin, ta mësojmë Kuranin dhe t'ua mësojmë edhe të tjerëve si dhe ta nderojmë e zbatojmë atë.

Ekziston një hadith që duhet të zërë një vend të veçantë ndërmjet të gjithë haditheve: *“Besimtari që lexon Kuran, ka aromë dhe shije të mirë...”*. (Buhari, Et'ime, 30)

Kjo frazë tregon përmes një gjuhe të mrekullueshme, burimin nga ushqehet ëmbëlsia që i ka hije myslimanit. Kjo këshillë duket sikur na kap për dore si një mësuese e mëshirshme dhe na përcjell në audiencën e Librit të Allahut. Kjo frazë duket sikur pyet secilin prej nesh: “Sa orë veçon ti ndërmjet impenjimeve ditore, për t'u gjendur në auditorin e Kuranit?”. Gjithashtu na tërheq vëmendjen: “Duhet të përpiqesh t'i përkushtosh edhe më shumë kohë fjalës së Allahut dhe duhet t'i bësh shpesh vetes një bilanc në lidhje me singjeritetin e këtij përkushtimi.”. Me të vërtetë që aftësia motivuese e këtij hadithi fisnik është krejt e veçantë. Shpresa për t'u radhitur ndërmjet “besimtarëve që kanë aromë dhe shije të mirë” ia ngroh zemrën njeriut...

Kur qëndrojmë në audiencën e Kuranit Fisnik me këto ndjenja dhe mendime, ndodh të has në ajetin që thotë: *“...Ata (politeistët) ju thërrasin në zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e Tij, ju thërret në Xhenet e falje (të gjynaheve)...”*. (Bakara, 221)

Ky ajet fisnik sikur më përfshin brenda vetes dhe më drejton në takimin me ajetet e tjera, ku gjithsecili i thërret besimtarët në Xhenet. E falë këtyre rreshtave, në botën time të brendshme, lind shpresa për të mbartur në zemër ngrohtësinë e ftesës së Zotit (xh.sh.) për në Xhenet.

Më poshtë po shënoj disa ajete e hadithe që kam mundësi të ndaj me ju.

Në një ajet fisnik përkruhen veçoritë e Xhenetit, i cili është premtim për njerëzit e devotshëm: *“Xheneti që u është premtuar besimtarëve është i tillë që, nëpër të rrjedhin lumenj; frutat dhe freskia e tij janë të përhershme...”*. (Ra'd, 35) Ndërsa në një

ajet tjetër, ai na paraqitet kështu: *“Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pa-ndotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre...”*. (Muhammed, 15)


Ndërsa në suren Vakia, kënaqësia që do marrin banorët e Xhenetit, përshkruhet me këto terma të mrekullueshëm: *“Ata ulen dhe mbështeten në frone të zbukuruara me xhevahirë dhe u thuhet vetëm ‘paqe, paqe’.”* (Shik. 56/11-34)

Ndërsa lexojmë këtë ajet dhe të tjerë të ngjashëm me të, horizontin tonë na e ndrit ky hadith fisnik që i Dërguari i Allahut, (a.s.), e transmeton nga Zoti (xh.sh.). Ebu Hurejra (r.a.), ka përcjellë se Pejgamberi (a.s.) ka sqaruar:

“Allahu Teala, i Cili është i Madhërishëm dhe i Lartësuar, ka thënë: ‘Unë si ushqim të Ahiretit, për robërit e Mi të devotshëm kam përgatitur mirësi që nuk i ka parë asnjë sy, nuk i ka dëgjuar asnjë vesh dhe nuk mund t'i vijë në mendje asnjë njeriu.’. (Atëherë) gjithcka që Allahu jua ka përshkruar me këto fjalë ruajini mënjatë. Përveç këtyre ka edhe diçka që Ai nuk jua ka treguar. Ajo është më e madhja.” (Muslim, 2824/3)

Ndërsa meditojmë mbi ajetet e cituara më sipër dhe mbi këtë hadith fisnik, kuptojmë se këto përshkrime magjepsëse janë zbritur në nivelin e perceptimit të njeriut. Prandaj ne duhet të kërkojmë “të vërtetën që nuk na e ka treguar”, siç është shprehur i Dërguari i Allahut, (a.s.), duke mos u përqendruar shumë tek këto të tjerat.

Kështu, kur bëhet fjalë për besimtarët që do të qëndrojnë vazhdimisht në Xhenetin e Adnit, thuhet: *“Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë...”*. (Bejjine, 8) Siç është shprehur Ibrahim Hakiu nga Erzurumi,



përmes këtij ajeti na tregohet se fitimi i kënaqësisë së Allahut Teala është qëllimi më sublim. (Marifetname, Botimet Erkam, vëll. 3, fq. 36 dhe në vazhdim.)

Gjithashtu kjo çështje shpjegohet me ajetin fisnik në të cilin thuhet: ***“Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia e Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore.”*** (Teube, 72)

Pasi lexojmë këto fraza, çdo gjë kuptohet më qartë. Mendja jonë ndriçohet me të vërtetën, pra me bindjen se fitorja më e madhe është arritja e kënaqësisë së Allahut Teala. Pastaj përforcohet edhe kjo bindje: “Leximin e Kuranit Fisnik çdo ditë duhet ta bëjmë me një mallëngjim të veçantë. Kur të lexojmë ajetet që flasin për ndëshkimin, duhet të marrim për shembull leximin e miqve të Allahut dhe duhet të përpiqemi të frikësohemi si ata. Ndërsa shpresën që japin ajetet e përgëzimit, duhet ta ndiejmë deri në palcë, sepse feja jonë e bukur para së gjithash na mëson të jemi optimistë. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Mëshira ime e ka kaluar ndëshkimin tim.”*** (Buhari, Tevhid, 15.), e kështu kërkon prej nesh që ta ndiejmë këtë shpresë dhe t’ia përshkruajmë edhe të tjerëve.

Ne besojmë se edhe ajetet fisnike, të cilat na paralajmërojnë me ndëshkimin hyjnor, janë një shtysë për të na përgatitur për ajetet e përgëzimit. Çdo rresht që fillon nga “El-hamduli’l-lahirabbi’l-alemin/Falënderimi i takon Zotit të botëve” e deri te “Mine’l-xhinneti ve’n-nas/Prej xhindëve dhe njerëzve”,

janë pjesët plotësuese të ajeteve që na thërrasin për në Xhenet. Për këtë arsye, kamxhiku i frikës që na paraqitet nga njëra anë, shërben për ta përforcuar dhe rinovuar injeksionin e shpresës në anën tjetër. Nisur nga gjithë sa thamë më sipër, mund të përmbledhim:

“Ne duhet t’i kushtojmë shumë kohë të ushqyerit nga ky det i mëshirës, derisa të jemi gjallë.”. Kjo sepse ndërmjetësimi i Kuranit Fisnik te Allahu Teala është i pranueshëm. (Muslim, Musafirin, 252) Në Ditën e dhënies së llogarisë, Kurani Fisnik do të na mbajë për dore, për të na siguruar prej atyre që kemi frikë dhe për të na përcjellë tek ajo që shpresojmë.

Lexo-Mendo!



A NUK KA MË SHUMË?

Në suren Mulk thuhet: ***“Qoftë i lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë! Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”*** (Mulk, 1-2)


Këto ajete të begata sigurisht që mund të komentohen në mënyra të ndryshme. Secili prej këtyre ajeteve mund të na hapë shumë horizonte. Ndërsa ne në këtë material dëshirojmë të mendojmë vetëm rreth frazës: ***“...Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë...”***

Siç dihet, me fjalën “vepër” në këtë ajet shprehet çdo gjë që rrjedh prej njeriut, domethënë shprehen veprat, fjalët dhe mendimet. Ndërsa fjala që e cilëson veprën është “ahsen”. Ahsen nuk do të thotë “mirë”, por “më mirë”. Pra, myslimani është i dashuruar pas urtësisë që gjithmonë gjurmon më të mirën, më të drejtën dhe më të bukurën. Myslmani vazhdimisht është në kërkim. Edhe nëse mënyra si vepron, si flet dhe si mendon janë më të përsosurat, ai gjithsesi nuk mjaftohet me to. Për këtë arsye, myslimani gjithmonë mendon: “Në kushtet e ditëve të sotme, këtë veprim mund ta kryej më së miri në këtë formë, por si mund ta zhvilloj dhe si mund ta përsos atë më tej në të ardhmen?”

Vërtet myslimani gjithmonë është në kërkim të më së bukurës. Ndërkohë kjo përpjekje e tij, asnjëherë nuk duhet të synojë drejt lakmisë dhe pangopshmërisë. Kjo bindje duhet të përvetësohet më së miri dhe të mbahet parasysh në çdo moment.

Pyetjet që na vendosen përpara, nga këto ajete fisnike, duhet të jenë: A janë të mira, të drejta dhe të bukura veprimet që kryejmë? Nëse kemi përgjigje pozitive për këtë pyetje, atëherë duhet të përpiqemi të arrijmë më të bukurën, më të mirën dhe më të drejtën në këtë fushë. Nëse mund t’i themi po edhe kësaj pyetjeje, atëherë tjetra në vijim do të jetë: Çfarë presim për të kërkuar edhe më të mirën?

Allahu Teala thotë se e ka krijuar vdekjen dhe jetën për të na sprovuar në një garë të tillë.



QYTETËRIMI

me bosht xhaminë

— Prof. dr. Kamil Jëllmaz —

Islami duke vendosur faltoren dhe tempullin në qendër të jetës shoqërore ndërtoi një qytetërim me qendër xhaminë. Pejgamberi (a.s.) në pamundësi për ta përdorur Qaben si faltore zgjodhi si vend mbledhje dhe adhurimi shtëpinë e Erkam ibn Ebil Erkamit. Pejgamberi (a.s.) aty takohej me myslimanët për t'i lexuar shpalljen hyjnore, për t'i udhëzuar përmes dritës hyjnore dhe për t'i pastruar zemrat nga ndotja pagane dhe politeiste.

Pejgamberi (a.s.) përmes ndërtimit të Xhamisë në Kuba dhe më pas në Medine menjëherë pas hixhretit

Ndërtimi i xhamisë në Kuba dhe Medine menjëherë pas hixhretit nga Pejgamberi (a.s.) synonte së pari ruajtjen e fesë dhe besimit dhe më pas ndërtimin dhe shndërrimin e shoqërisë në një shoqëri besimtare. Në fakt mënyrat për të mbrojtur fenë dhe besimin janë tre:

- a. Kryerja e urdhëresave dhe distancimi nga ndalesat.
- b. Ndërtimi i institucioneve si Xhamia që shërbejnë për edukimin e popullsisë.
- c. Përhapja e arsimit dhe edukimit fetar.

Shembulli më i mirë i mbrojtjes së besimit përmes institucioneve është xhamia. Ajeti Kuranor: ***“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”*** Synon inkurajimin për ndërtimin e institucioneve të tilla.

Ndërtimi i xhamive është dy llojesh, fizik dhe shpirtëror. Ndërtimi fizik konsiston në ndërtimin e godinës dhe mirëmbajtjen e saj. Pejgamberi (a.s.) përmes hadithit “Kush ndërton një xhami Allahu i ndërton një saraj në Xhenet” ka pasur për synim nxitjen e besimtarëve për ndërtimin e xhamive.

Kurse ndërtimi shpirtëror konsiston në edukimin e njerëzve dhe mbushjen e xhamisë me xhemat. Pyetja “Xhamia apo xhemati është më i rëndësishëm” është bërë objekt debati dhe diskutimi nëpër qarqet akademike por në përgjithësi ka dominuar mendimi se parësor është xhemati. Nëse ekziston xhemati ndërtimi i xhamisë është i lehtë, por një xhami pa xhemat është e destinuar të rrënohet. Prandaj është më i rëndësishëm ndërtimi i xhematit.

Xhamia është vendi ku madhërohet Allahu dhe kryhen ibadetet ndaj Tij. Prandaj Allahu thotë ***“Kush është më fajtor se ai që pengon të përmendet nëpër xhamitë e Allahut Emri i Tij dhe përpiket për shkatërrimin e tyre?”*** (Bekare,114.)

Aq sa është tirani dhe mizori rrënimi i xhamive dhe pengimi i njerëzve për kryerjen e adhurimeve në të po aq është mizori edhe mos përgatitja e kuadrove profesionistë dhe mos përpjekja për të siguruar dhe gjallëruar xhaminë me xhemat.

Rrënim i xhamisë nuk konsiderohet vetëm shembja e ndërtesës së xhamisë por edhe braktisja dhe indiferentizmi ndaj fenomenit. Xhemati është i domosdoshëm për gjallërimin dhe mirëmbajtjen e xhamisë. Siç dihet shtëpitë e braktisura dhe të pabanuara rrënohen më shpejt se shtëpitë e banuara. E njëjta gjë ndodh edhe me xhamitë, xhamia e privuar nga xhemati është e destinuar të rrënohet.

Nxitja e ajeteve dhe haditheve për ndërtimin e xhamive ka bërë që përgjatë historisë në botën islame të ndërtohen xhami që janë bërë simbole të qytetërimit Islam. Xhamitë e ndërtuara në mbarë botën janë kryevepra të arkitekturës islame.

FUNKSIONET E XHAMISË

Ndër funksionet kryesore të xhamisë në kohën e Pejgamberit (a.s.) mund të radhisim:

1- Qendër e kryerjes së ritëve fetare

Qëllimi kryesor i ndërtimit dhe funksioni i parë i xhamisë së Pejgamberit (a.s.) ka qenë kryerja e adhurimeve. Megjithëse rruzulli tokësor është i përshtatshëm për të kryer namazin feja islame për shkak të begatisë ka nxitur kryerjen e namazit në xhami. Kurani funksionin e vendadhurimit e shpreh në këtë ajet:

“Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë në mëngjes dhe mbrëmje, njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahut dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.” (Nur,36-37.)

Në Kuran është një ajet që i që e ndalon Pejgamberin (a.s.) për t’iu përgjigjur ftesës së hipokritëve për të falur namazin në xhaminë Dirar e cila ishte ndërtuar me synimin për të përhapur intriga midis myslimanëve. ***“(Hipokritë) janë edhe ata që ndërtuan një xhami për t’u shkaktuar dëm (besimtarëve), për ta forcuar mohimin dhe për të krijuar përçarje në mesin e besimtarëve, duke iu shërbyer ajo si pusi atyre që qysh më parë luftonin kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dhe, vërtet ata betohen: “Ne kishim për qëllim që të bënim vetëm një vepër të mirë”! Por Allahu dëshmon se në të vërtetë ata janë gënjeshtarë. Ti në atë xhami kurrë mos fal namaz. Ndërsa xhamia e themeluar në përkushtim (ndaj Allahut) që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. Allahu i do ata që pastrohen shpesh.”*** (Tevbe,107-8.)

Sipas Kuranit Allahu i ka siguruar vendet e

***“Faltoret e Allahut
i vizitojnë dhe i mirëmbajnë
vetëm ata që besojnë
Allahun dhe Ditën e Fundit,
që falin namazin dhe japin
zekatin e që nuk i frikësohen
askujt, përveç Allahut.
Sigurisht që këta janë në
rrugë të drejtë.”***

adhurimit përmes zmbropsjes dhe dominimit mbi njëri-tjetrin. **“Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë”** (Haxh, 40.)

2. Qendër edukimi dhe arsimit

Një tjetër funksion i rëndësishëm i xhamisë së Pejgamberit (a.s.) ishte edukimi dhe arsimimi i myslimanëve. Xhamia u shndërrua në një shkollë ku sahabët mësonin Kuranin, sunetin dhe urtësinë për të përçuar më pas tek të tjerët. ishte rëndësia e madhe që i dha Pejgamberi (a.s.) edukimit dhe arsimit të brezave që e shndërroi xhaminë në qendër të edukimit dhe arsimimit. Në një rast kur Pejgamberi (a.s.) hyri në xhami dhe pa dy grupe njerëzish, një grup duke u lutur dhe bërë dhikër dhe një grup tjetër duke mësuar dituri dhe urtësi, Ai u ul pranë sahabëve që mësonin dituri duke thënë “Unë jam dërguar si mësues” (ibn Maxhe, Mukaddime, 17.)

3. Qendër e pushtetit

Pejgamberi (a.s.) përveç se i dërguari i Allahut në tokë ishte njëkohësisht edhe kryetar i shtetit dhe të gjitha aktivitetet administrative, politike dhe diplomatike zhvilloheshin në xhami. Guvernatorët, komandantët, punonjësit shtetëror emëroheshin në xhami. Përfaqësuesit nga jashtë priteshin në xhami, të gjitha mbledhjet politike dhe qeveritare zhvillohej xhami.

4. Qendër e pushtetit gjyqësor

Të gjithë shtetasit e Medinës, myslimanë apo hebrenj të gjitha veprimet dhe problemet juridike dhe gjyqësore zhvilloheshin dhe zgjidheshin në xhami. Çdo shqetësim dhe kërkesë paraqitej në xhami.

5. Qendër konsultimi dhe këshillimi

Shokët e Pejgamberit (a.s.) të gjithë çështjet në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër i shqyrtonin, diskutonin në xhami. Problemet individuale, familjare dhe shoqërore zgjidheshin në xhami

6. Vendbanim

Xhamia e Pejgamberit (a.s.) shërbeu si vendbanim dhe vendstrehim për sahabët e varfër që nuk kishin ku të strehoheshin. Në xhami strehoheshin myslimanët e varfër dhe mysafirët që vinin nga larg.

7. Qendër sportive

Çdo lloj edukimi luftarak dhe veprimtari sportive zhvillohej në xhami. Në xhami zhvilloheshin gjithashtu lojëra sportive midis ekipeve kundërshtare.

Xhami, funksionin e qendrës së jetës shoqërore dhe individuale në epokën e lumturisë e ruajti për shekuj me radhë. Të gjitha institucionet arsimore, edukative, ushtarake, shoqërore dhe tregtare kishin në bazë xhaminë. Përreth xhamive ishin ndërtuar shkolla, spitale, biblioteka, kuzhina, jetimore etj.

Ndërtimi i xhamive me gurë estetik kurse i shtëpive me dru është një tregues shumë i rëndësishëm për të vu në dukje botëkuptimin e qytetërimit me bazë xhaminë. Sepse në qytetërimin me bazë xhaminë parësore nuk është hapësira por koha. Banorët e programonin jetën sipas ezanit të kënduar nëpër minare.

Në ditët e sotme funksionet e xhamisë janë reduktuar ndjeshëm. Mund të thuhet që xhamia nga funksionet e saj ka ruajtur vetëm funksionin ritual dhe edukimit fetar. Por xhamitë përsëri po luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e njerëzve përmes ligjëratave dhe mësimave të ndryshme që zhvillohen në xhami. Kurset e Kuranit të zhvilluara nëpër xhami po luajnë në rol shumë të rëndësishëm në mësimin e Kuranit të fëmijëve dhe të rinjve.

Xhamitë janë shndërruar në simbol të qytetërimit Islam, xhamia tregon identitetin e banorëve në të cilën ndodhet. Por mos të harrojmë që vazhdimi i këtij qytetërimi është i mundur përmes ndërtimit dhe gjallërimit shpirtëror të xhamisë. Në fakt ndërtimi fizik i xhamisë është një tregues i rëndësishëm e ndërtimit shpirtëror.

Ndërtimi estetik i xhamisë është shumë i rëndësishëm sepse ajo është simbol i qytetërimit Islam por më e rëndësishme gjallërimi dhe mbushja e xhamisë me xhemat. Në këtë mënyrë mund të jetë në gjendje xhamia të kryejë të gjitha funksionet.



A e pastrojmë shpirtin?

— Mehmet Dinç —

Të rriturit na kanë folur që nga fëmijëria për rëndësinë e larjes së dhëmbëve. Ata përpiqen t'i bindin fëmijët se patjetër duhet t'i lajnë dhëmbët, me shpjegimin se nëse nuk i lajnë kur janë të vegjël, iu prishen dhëmbët kur rriten dhe nuk u dalin të tjerë të rinj. Pastaj, çfarëdo që të vendosin në vend të tyre, asnjëherë nuk mund të jenë si dhëmbët origjinalë. Kjo çështje përbën një shqetësim të madh për ata që vuajnë nga dhimbjet e dhëmbëve. Normalisht që këto dhimbje u shkaktohen ngaqë nuk i kanë larë dhëmbët në kohën e duhur.

Krahas larjes së dhëmbëve, të rriturit u mësojnë fëmijëve që ta mbrojnë trupin edhe kundrejt sëmundjeve. Ata i pengojnë të ecin këmbëzbathur, nuk i lejojnë të pinë ujë kur janë të djersitur dhe i këshillojnë që ta mbajnë kokën të freskët dhe këmbët ngrohtë. Kjo e gjitha bëhet ngaqë shëndeti i trupit dhe mbrojtja nga sëmundjet janë shumë të rëndësishëm. Andaj duhet të mbrohemi nga sëmundjet, në mënyrë që të mos vuajmë prej dhimbjeve të ndryshme. Për sa kohë nuk mbrohet shëndeti i trupit, herët apo vonë patjetër sëmundja do të vijë.

Krahas shëndetit të trupit, edhe pastërtia është njëra prej çështjeve që na është mësuar që në fëmijëri, duke u theksuar me këmbëngulje, prejse bart një rëndësi të veçantë. Siç mund t'ju kujtohet nga vogëlia, edhe nëse ju binte pak baltë në rroba, nëna juaj shqetësohej dhe menjëherë jua ndërronte rrobat dhe ju vishte të tjera të pastra. Pastaj rëndësia e larjes me program të rregullt, prerja e thonjeve dhe ndërrimi i shpeshtë i rrobave, veçanërisht në muajt e verës, ishin prej zakoneve të rëndësishme që të rriturit donin të na i përcillnin, në shtëpi dhe në shkollë, me një këmbëngulje që theksonte nevojën për të na i gdhendur në mendje.

Nisur nga këto që thamë më sipër, askush nuk mund ta mohojë rëndësinë e larjes së dhëmbëve, kujdesit ndaj shëndetit të trupit dhe mbajtjes pastër të rrobave. Të rriturit kanë shumë të drejtë që insistojnë dhe përpiqen të na i mësojnë këto

tri çështje. Andaj lutemi për ta duke thënë: “Rrofshin e qofshin!”. Por kurdo që shoh rëndësinë dhe përpikërinë që shfaqet për t'ua mësuar fëmijëve këto tema, te unë zgjohet bindja se në këto çështje neglizhohet një pikë thelbësore. Për mendimin tim, po aq të rëndësishëm sa shëndeti fizik dhe pastërtia e trupit janë edhe shëndeti psikik dhe pastërtia shpirtërore, madje ndoshta janë edhe shumë më të rëndësishëm. Shpirti dhe trupi nuk janë të pavarur dhe të ndarë nga njëri-tjetri, prandaj nuk bën sens që interesimin të cilin e shfaqim ndaj njërit, të mos e shfaqim edhe ndaj tjetrit. Përkundrazi, ata janë të lidhur fort me njëri-tjetrin dhe janë dy pjesë të një tërësie që ndikojnë drejtpërdrejt te njëra-tjetra.

Për shembull, problemi që përjeton një njeri nga gripi është një problem fiziologjik, organik dhe biologjik, por ky njeri në të njëjtën kohë ndikohet edhe psikologjisht, sepse gjatë sëmundjes i pakësohet edhe masa e gjëzimit dhe e shijes që merr nga jeta. Anasjelltas, kur njeriu bie në depresion, sistemi i zorrëve fillon të funksionojë më ngadalë, çrregullohen rrahjet e zemrës dhe rritet rreziku për të përjetuar infarkt apo për t'u prekur nga sëmundjet në aparatit tretës. Domethënë, shpirti ndikon te trupi dhe trupi ndikon te shpirti si një tërësi. Për këtë arsye, siç i japim rëndësi shëndetit fizik dhe i edukojmë edhe fëmijët që t'i japin rëndësi të veçantë atij, të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe me shëndetin psikik. Siç bëjmë kujdes ndaj pastërtisë së trupit dhe siç nuk e durojmë qoftë edhe njollën më të vogël në rrobat apo trupat tanë, por e pastrojmë menjëherë, duhet të bëjmë kujdes edhe ndaj pastërtisë së shpirtit. Kështu, duhet të mos e durojmë qoftë edhe njollën më të vogël që mund të bjerë në shpirtin tonë dhe duhet ta pastrojmë menjëherë.

Shpirti ynë është i rëndësishëm më e pakta sa dhëmbët tanë. Përpikërinë që shfaqim për t'i mbajtur të pastër dhe të shëndetshëm dhëmbët, duhet ta shfaqim edhe për shpirtin. Edukimin që i japim fëmijëve për shëndetin e dhëmbëve, duhet t'ia japim edhe për shëndetin e shpirtit. Por së pari këtë proces duhet ta fillojmë nga vetja jonë, në mënyrë që ky edukim të jetë influencues.

Ejani t'i pastrojmë shpirtat tanë!



*"A mos vallë ti (o Muhamed) do ta shkatërrosh veten,
nga që ata (banorët e Mekës) nuk duan të besojnë?"*

(Shuara, 3)

Një Ajet

Koncepti përgjegjësisë çdo njeriu normal i sjell ndërmend thjesht një ndjenjë apo cilësi morale. Por kur bëhet fjalë për përgjegjësinë e një pejgamberi duhet të jemi të vetëdijshëm se po flasim për një koncept shumë më specifik. Sepse përgjegjësia pejgamberike është një gjendje që nuk mund ta përjetojnë të tjerët dhe për pasojë është e vështirë të perceptohet një përgjegjësi e tillë e ngarkuar nga vetë Krijuesi i gjithësisë. Pra siç është zbulesa një e fshehtë midis Allahut dhe Pejgamberëve e cila është e pamundur të kuptohet nga ne, ashtu edhe përgjegjësia profetike është enigmë për ne. Nga kjo pikëpamje mund të themi se pejgamberët janë të vetmit që e përjetojnë këtë gjendje. Njerëzit e tjerë vetëm mund t'i ndjekin ata duke u përpjekur t'u ngjasojnë pejgamberëve. Por Kurani dhe Hadithi na jep disa informacione për Pejgamberin a.s të cilat janë si një dritare për botën e brendshme të Pejgamberit që hapet për ne. Këto informacione janë shumë të rëndësishme për të kuptuar botën e brendshme të Pejgamberit. Por cili ishte burimi i përgjegjësisë Pejgamberike? Kur i hedhim një vështrim Kuranit vëmë re se Allahu e cilëson vahjin (zbulesën) si "fjalë të rëndë" së pari sepse vjen prej Krijuesit të gjithësisë dhe së dyti ishte një detyrë me përgjegjësi dhe vështirësi të mëdha. Ajete të ndryshme e dëshmojnë qartë ndjenjën e madhe të përgjegjësisë se Pejgamberit a.s, përgjegjësi kjo e shoqëruar nga këmbëngulja dhe vazhdimësia për të përmbushur detyrën.

Mbas vdekjes së Muhamedit a.s. përgjegjësinë e përcimit të mesazhit islam në katër anët e botës e morën sahabët, shokët e edukuar nën kujdesin e Tij.

Ndjenja e përgjegjësisë që përjetonte Pejgamberi a.s ishte krejt ndryshe sepse Ai shikonte atë që nuk e shikonin dot të tjerët siç e konfirmon edhe vetë në hadithin "Sikur të dinit atë që di un do qanit shumë dhe do qeshnit pak" Ai e dinte shumë mirë se çdo të thoshte të gjykohej nga Allahu. Ai ishte shumë i përgjegjshëm për misionin e vështirë të cilin nuk e mbajti dot as qielli as toka por që e pranoi njeriu. Ai ishte gjithmonë i shqetësuar për umetin e Tij sepse në ditën e gjykimit do të jetë dëshmitarë për ta. Një herë kur Abdullah ibn Mesudi po lexonte Kuran dhe arriti tek ajeti "***Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të të sjellim ty (Muhamed) dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.***" (Nahl, 89) Pejgamberi a.s filloi të qajë me dënesë.

Si rrjedhojë e kësaj përgjegjshmërie të lartë, fjalët e fundit të Pejgamberit në hutben e lamtumirës ishin " a përçova mesazhin? O zot ji dëshmitarë. Në të vërtetë Ai këtë pyetje ia bënte vazhdimisht vetes sepse e shqetësonte pa masë plotësimi siç duhet i detyrës. Sa herë që njerëzit mohonin mesazhin e Allahut, Ai bënte përgjegjës veten e tij. Dallimi ndërmjet Tij dhe ndjekësve të Tij të mëvonshëm është se Ai mbajti veten përgjegjës për çdo gjë kurse umeti mbajti përgjegjës të tjerët jo veten. Ai punoi pa pushim për ta kryer me përsosmëri detyrën e ngarkuar. Me këtë na mësoi se çfarë do të thotë të sakrifikosh veten për njerëzimin. Ne si besimtarë bashkohorë duhet të rishikojmë pozicionin tonë përballë kësaj përgjegjësie të madhe që kemi marrë për sipër.

Transmetohet nga Abdullah ibn Mesudi
se Pejgamberi (a.s.) i ka pyetur shokët:

*"Cili prej jush do më shumë pasurinë e trashëgimtarit
sesa pasurinë e vet?"*

Të gjithë me një gojë thanë:

Pasurinë tonë e duam më shumë se çdo gjë tjetër.

Atëherë Pejgamberi (a.s.) tha:

*Pasuria juaj është ajo që shpenzoni në rrugë të Allahut
kurse pasuria që mbledhni është e trashëgimtarëve."*

(Buhari)

Njerëzit shfaqin sjellje të ndryshme për sa i përket shpenzimit të pasurisë së tyre. Dikush e dhuron pasurinë për bamirësi dikush tjetër e shpenzon vetëm për familjen e tij duke treguar koprraci në shpenzimin e saj për bamirësi. Siç dëshmon edhe Kurani njeriu joshet shumë nga pasuria e kësaj botë. Për këtë arsye një njeri që nuk ka marrë edukatë hyjnore pandeh se pasuria e kësaj botë është e përjetshme dhe përdor çdo lloj mjeti për ta pasur atë. Por në fakt çdo lloj pasurie mbet në këtë botë.

Ajo që dihet në mënyrë kategorikë është se të gjithë do të vdesim dhe asnjëri prej nesh nuk do ta marrë pasurinë me vetë në botën tjetër. Gjithë pasuria që mundohemi të mbledhim në këtë botë i mbetet trashëgimtarëve. Nëse pasuria e fituar nuk shpenzohet në vendin e duhur atëherë e gjithë pasuria e mbledhur do ti mbesë trashëgimtarëve që nuk dihet si do ta shpenzojnë.

Ajo pasuri që shpërndahet për bamirësi rezervohet për në ditën e gjykimit si dëshmitare në favorin tonë. Të parët tanë duke qenë të vetëdijshëm për këtë garonin më njëri tjetrin për të bërë bamirësi dhe si pasojë e kësaj garë janë

dhuruar me mijëra vakëfe në shërbim të njerëzve.

Ai që e do pasurinë e vet e merr me vete dhe e vetmja mënyrë për ta marrë me vetë në jetën tjetër është ta japësh në rrugë të Allahut në këtë botë.

Gjithë secili prej nesh duhet të bëjë diçka për të dërguar mall në botën tjetër qoftë edhe në sasi të vogla sepse sasia e vogël por sinjeritet i pastër sjell shpërblim të madh dhe e kundra. Mirësia e njeriut kuptohet kur jep diçka nga vetja sa do e vogël qoftë.

Pengesa më e madhe që i pengon njerëzit sot për të dhuruar për bamirësi është frika e varfërisë dhe kjo vjen si pasojë e besimit të dobët.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Ai që e do pasurinë e merr me vetë në botën tjetër duke e përdorur për bamirësi në këtë botë.

2. Nuk është një sjellje e mençur të mbledhësh mall vetëm për trashëgimtarët.


3. Hadithi na nxit të përgatisim me sa të kemi mundësi diçka për botën tjetër.

Një Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A II -



BESIMI NË BOTËN TJETËR

Besimi në Ahiret është edhe një prej shtyllave të besimit Islam. Dhe për të treguar rëndësinë e kësaj shtylle në sistemin e besimit Islam, mund të cekim faktin se kjo është një prej shtyllave të besimit që në Kuran përmendet shpesh, së bashku me “besimin në Allahun”:

“...kushdo prej tyre që beson Allahun dhe jetën tjetër (sipas Kuranit), dhe bën vepra të mira (sipas Islamit), do të shpërblehen nga Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo të pikëllohen!” (Bekare, 62.)

“...Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojeni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit!...” (Nisa, 59.)

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre...”

(Muxhadile, 22.)¹

1. - Edhe largimi me zemër prej atyre që nuk i do Allahu, është një prej kushteve të saktësisë së besimit, ashtu siç është edhe dashuria ndaj atyre që do Allahu. Kjo, sepse besimi bën të domosdoshme dashurinë për atë që e meriton dhe urrejtje ndaj atij që e ka hak. Për shembull, surja el-Mesed, është një sure që na e tregon më së miri urrejtjen ndaj atyre që e kanë hak atë, sepse Ebu Lehebi, edhe pse ishte xhaxhai i Profetit tonë (a.s.), për shkak të armiqësisë së tij ndaj Islamit, ka merituar mallkimin e Zotit në këtë sure të Kuranit. Po ashtu, Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh që në çdo rekat të namazit, t'i lutemi Atij duke thënë: **“(na udhëzo) në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi”**. Ndërsa se kush janë ata, të cilëve u janë dhuruar mirësi, Allahu na e bën të ditur në një ajet tjetër: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”** (Nisa, 69.) Më pas, me lutjen: **“...jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”**, dëshiron që ne të kërkojmë të mos i ngajmë atyre që janë zhytur në batakun e mohimit e të atyre që kanë humbur në luginën e devijimit.

Nuk duhet harruar se ruajtja nga ngjasimi me jo myslimanët është një nga kushtet më të rëndësishme të ruajtjes së personalitetit dhe pjekurisë Islame. Për këtë arsye, Profeti ynë (a.s.) ka urdhëruar që agjërimi i ditës së 10 të muajit Muharrem, e cila agjërohet edhe nga hebrejtë, të bëhet duke agjëruar bashkë me të edhe një ditë para, ose një ditë pas saj, si dallim prej tyre. Pra, Profeti (a.s.) na e ka ndaluar t'u ngajmë jomyslimanëve edhe në adhurime. Po ashtu, Profeti ynë (a.s.), ka urdhëruar: **“Kush përpiqet t'i**



Gjithashtu, duke i lavdëruar besimtarët, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...ata që besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit...” (Teube, 44.)

Duke qenë një çështje që i takon të fshehtës dhe që e kapërcen mendjen njerëzore, është e pamundur që enigma e **“vdekjes dhe Ahiretit”** të zgjidhet vetëm me mendje. Në këtë pikë, njeriu ka nevojë të padiskutueshme për udhëzimin e shpalljeve hyjnore. Allahu i Madhëruar nuk i ka lënë pa ndihmë robërit e Tij në lidhje me këtë çështje. Në shumë sure të Kuranit Fisnik, ndonjëherë me argumente të qarta, ndonjëherë me shembuj e ndonjëherë edhe me përsëritje të shpeshtë të ajeteve në lidhje me Ahiretin, është synuar gdhendja dhe skalitja e besimit në botën tjetër, në zemrat e besimtarëve. Kjo është edhe arsyeja pse në vitet e para të profetësisë, Profetit tonë (a.s.) i janë zbritur më tepër ajete që forcojnë themelet e besimit sesa ajete që lidhen me adhurimet. Madje këto çështje janë trajtuar shpesh edhe midis temave të adhurimeve dhe veprave, të cilat kanë zbritur pas emigrimit të Profetit (a.s.) në Medinë, sepse një nga shkaqet më të rëndësishme të problemeve në periudhën e injorancës ishte “mohimi i Ahiretit”.

E në fakt, mohimi i ekzistencës së botës tjetër s’ka të bëjë as me mendjen e as me logjikën. Duhet menduar se:

“Për shembull: Nuk është parë asnjëherë, që një grup teatral të mbyllë perdet pas shfaqjes së skenës së parë, duke e lënë shfaqjen me ndodhi të shkëputura nga njëra-tjetra dhe në mënyrë që të kenë nevojë për shpjegim?! Nëse do të ndodhte diçka e tillë, çfarë do të mendonin shikuesit që sapo kanë filluar të futen në mendime, janë tensionuar dhe që mezi presin të mësojnë qëllimin dhe idenë kryesore të shfaqjes dhe skenaristit? Edhe një fëmijë i zgjuar, nuk e pranon që një pjesë teatrale të mbarojë në këtë mënyrë. Atëherë, si mund të mendohet që Allahu i Madhëruar, i Cili ka krijuar çdo gjë në mënyrë të përsosur dhe di gjithçka, ta mbyllë historinë e kësaj Gjithësie të stërmadhe në një mënyrë që as edhe një fëmijë nuk do ta bënte?!²

ngjajë një populli, ai është prej tyre.” (Ebu Daud, Libas, 4/4031.)

Një gjë është e sigurt se Islami, që është e vetmja fe e vërtetë tek Allahu, zotëron përsosmërinë për t’i dhënë përgjigje nevojave të të gjithë njerëzimit deri në ditën e Kiametit. Madje, ai nuk ka nevojë as për fetë e tjera të prishura, as për besimet e kota dhe as për filozofit e mangëta njerëzore.

2. -Shih. Dr. M. S. Ramadan el-Buti, *Kubra’l-Jakinijati’l-Keunijje*, fq.180.

Është një realitet i qartë fakti se të gjithë vijnë në këtë botë nga një derë, pra nga barku i nënës, e më pas të mbushur me sjellje dhe ndjenja trupore e shpirtërore, jetojnë në këtë botë të përkohshme, e cila i ngjan një piste vrapimi me pengesa. Pasi e kalojnë korridorin e shkurtër midis djepit dhe varrit, hyjnë nga dera e vdekjes dhe hedhin hapin drejt varrit, që është edhe stacioni i parë i Botës tjetër. Varri është salla e pritjes së gjykatës hyjnore, ku do të gjykohemi në ditën e Kiametit.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Jobesimtarët thonë: «Nuk do të na vijë Ora (e Kiametit)!» Thuaju: «Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t’ju vijë!» Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t’i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë.” (Sebe’, 3.)

“Allahu! Nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij. Ai do t’ju mbledhë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka dyshim aspak! E kush është në fjalë më i vërtetë se Allahu?” (Nisa, 87.)

“(Njeriu) pyet: «Kur do të jetë Dita e Kiametit?»

Por, kur t’i verbohën sytë, të zihet Hëna dhe Dielli e Hëna të bashkohen, atë ditë njeriu do të thotë: «Ku të iki?»

Askund! S’ka strehë! Atë ditë, streha është tek Zoti yt. Atë ditë, njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë.” (Kijame, 6-13.)

“Thuaju: «Allahu jua jep jetën, pastaj ju bën të vdisni e mandej do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit e për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi; por shumica e njerëzve nuk e dinë.» I Allahut është pushteti i qiejve dhe i Tokës! E kur të arrijë Ora (e Kiametit), atë ditë mohuesit do të humbasin.” (Xhathije, 26-27.)

“Thuaj: «Bëhuni gurë ose hekur, ose çfarëdo krijese tjetër që është më e madhe sipas jush!»

Ata do të thonë: «Kush do të na kthejë ne (në jetë?)»

Thuaj: «Ai që ju ka krijuar herën e parë.»

Ata do t’i tundin kokat nga ti e do të pyesin: «Kur do të bëhet ajo?»

Ti thuaju: «Mund të vijë shpejt!» (Isra, 50-51.)

Pra kjo botë, në cilën jetojmë, është mbushur e është zbrazur nga njerëzit që prej Ademit (a.s.),

e deri në ditët tona, si shembulli i një hani me dy porta. Por a ka dijeni prej njerëzve se ku janë ata tani? Ose, ku do të jemi ne pas njëfarë kohe? Mister!.. Mirëpo diçka është e sigurt, se vdekja vjen edhe për shtypësit edhe për të shtypurit, edhe për të devotshmit edhe për gjynahqarët... e të gjithë presin Kiametin, që është fillimi i Jetës së përjetshme...

Toka mbi të cilën shkelim dhe ecim është e mbushur me kufomat e miliarda njerëzve të shndërruar në dhe. Miliarda silueta të vendosura njëra mbi tjetrën... Nesër edhe ne do të varrosemi bashkë me veprat tona në gjirin e kësaj toke, duke u shkrirë brenda silueta të dendur. Më pas do të fillojë një jetë e përjetshme dhe një udhëtim i pafundëm. E meqenëse i gjithë ky rrugëtim nuk është alternativ atëherë duhet të ndalemi pak e të mendojmë:

DYNJAJA PRANË AHIRETIT...

E çfarë rëndësie ka nëse në këtë botë kalimtare kemi jetë të gjatë apo të shkurtër? Në të vërtetë, jeta e kësaj bote të përkohshme është veç një flluskë sapuni në krahasim me jetën e përjetshme të Ahiretit. Sado gjatë të jetojë biri i njeriut në këtë botë kalimtare, jeta e tij në krahasim me jetën e botës tjetër do të jetë shumë e shkurtër. Lidhur me këtë fakt Kurani Fisnik urdhëron:

“Ai do t’u thotë (jobesimtarëve):

«Sa vjet keni qëndruar në Tokë?» Ata do të përgjigjen:

«Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë dite. Pyesni ata që i kanë numëruar!» Ai do të thotë:

«Keni qëndruar shumë pak. Eh, sikur ta kishit ditur!» (Mu’minun, 112-114.)

Ndërsa në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar sqaron:

“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.” (Naziat, 46.)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut, (a.s.), për t’ia lehtësuar mendjes njerëzore kuptimin e kohës, vlerës dhe madhësisë së Ahiretit në krahasim me jetën e dynjasë, është shprehur:

“Për Allahun! Dynjaja ne krahasim me Ahiretin është si të fusësh gishtin në oqean dhe të shohësh sa ujë ke marrë. shifë pak kete version qe kam gjete. (Muslim, Xhennet, 55.)

Ndërsa poeti mistik Junus Emre e ka shprehur në mënyrë shumë të bukur faktin se ekzistenca jonë në këtë botë të përkohshme në fakt është vetëm një pushim i shkurtër në një konak:

Prej barkut të nënës erdhëm në Pazar,

Morëm një qefin, u kthjem në varr!..

Prandaj, e gjithë detyra jonë është që këtë jetë, e cila është shumë e shkurtër në krahasim me jetën e botës tjetër, ta zbukurojmë me devotshmëri, adhurime dhe bindje ndaj Allahut të Madhëruar.

Nga ana tjetër, mund të themi se ditët e shkurtra të jetës në këtë botë, janë më të vlefshme në krahasim me ato të botës tjetër, sepse ajo botë është vendi ku do të merren shpërblimet, ndërsa kjo botë është vendi ku punohet për t’i fituar ata.

Transmetohet se, kur Iljasi (a.s.) pa përballë vetes melekun e vdekjes, u dridh i tmerruar. Mirëpo, Azraili (a.s.) i çuditur nga kjo e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! A u frikësove nga vdekja?”

Iljasi (a.s.) u përgjigj:

“Jo! Unë nuk u frikësova nga vdekja, në të vërtetë më frikësoi fakti se do t’i jap lamtumirën kësaj bote...” Më pas vazhdoi duke thënë:

“Në jetën e kësaj bote përpiqesha të adhurroja Zotin tim, të nxisja veprimet e mira, e të ndaloja këdo nga vepra e keqe. Kohën e mbushja me adhurime dhe vepra të mira, duke u munduar të jetoja me moral të bukur. Dhe kjo gjendje ishte burim paqeje për mua dhe ma mbushte zemrën me lumturi dhe gëzim shpirtëror. Prandaj jam shumë i mërzitur, sepse kur të vdes, nuk do t’i përjetoj më këto kënaqësi dhe do të mbetem si peng në varr deri në ditën e Kiametit!”

Ndërsa Amir bin Abdilkajsi, prej brezit të tabiinëve, kur e ndjeu se po i afrohej vdekja, filloi të qante. Kur e pyetën:

“Pse po qan?”, ai u përgjigj:

“Nuk po qaj as nga frika e vdekjes, e as për shkak të lakmisë për këtë botë. Unë po qaj sepse do të privohem nga agjërimi në ditët e nxehta dhe ngritja në adhurimet e natës.” (Dhehebi, Sijer, IV, 19.)

Lidhur me të vërtetën se lumturia e Ahiretit fitohet në dynja, i nderuari i Xhunejd Bagdadi është shprehur:

“Një ditë e kësaj bote është më e vlefshme se njëmijë ditë të botës tjetër, sepse fitimi dhe humbja përjetohej vetëm në këtë botë. Ndërsa në botën tjetër nuk do të ketë më mundësi të bëhet diçka për arritur shpëtimin.”

Le të mendojmë pak nëse Allahu do na kishte dhënë njëmijë vite jetë, pra nëse do të lindnim në vitin 1000 e do të jetonim në luks e mirësi deri në vitin 2000... Në fund, përsëri do të vdisnim! Pra sado gjatë të jetonim, jeta e përkohshme e dynjasë do të ishte vetëm një periudhë e shkurtër në krahasim



me jetën e përjetshme të Ahiretit. Prandaj:

Cila mendje do të zgjidhte “çastin” në vend të “së pafundmes”?!?

Mendja e atyre që zgjedhin dynjanë në vend të Ahiretit, nuk ndryshon aspak nga mendja e fëmijës që kujton se qepa që ka në dorë është ushqimi më i shijshëm në botë, për shkak se nuk i njeh ushqimet e tjera të llojllojshme. Të zgjedhësh këtë botë të përkohshme në vend të botës së pafundme të Ahiretit, do të thotë të kesh të njëjtën mendje me atë të zogut të mjerë që preferon kafazin e ngushtë ndërkohë që mund t'i rrahë krahët në qiellin paanë e pafund.

I ndjeri Nexhip Fazëll, e përmbledh me dy rreshta këtë indiferencë të madhe:

Ora ime plot tridhjetë vite ka punuar, e unë paskam ndaluar,

Pa dijeninë e qiellit, balona kam fluturuar...

Ndërsa një njeri i urtë ka thënë:

“Nëse dynjaja do të ishte prej ari dhe e përkohshme, ndërsa Ahireti prej balte dhe i përjetshëm, njeriu i mençur do të zgjidhte të përjetshmen në vend të përkohshmes. Po sikur të ishte e kundërta e kësaj pra dynjaja të ishte prej balte dhe e përkohshme, ndërsa Ahireti prej ari dhe i përjetshëm, vallë çfarë duhej bërë?!³”

Padyshim se një mendje e shëndoshë nuk do t'i ndërronte fitimet me dobi të pafundme, me interesa të vogla, të thjeshta e të përkohshme. Për këtë arsye, detyra e një njeriu me mendje të mprehtë është të ruhet nga joshja e kësaj bote të përkohshme dhe të përpiqet të fitojë lumturinë e Ahiretit të përjetshëm.

Në një hadith fisnik, njerëzit me të vërtetë të mençur përkufizohen me këto fjalë:

“I mençur është ai që punon për pasvdekjes duke mbizotëruar ndaj egos dhe duke e llogaritur atë. Ndërsa budalla është ai që shpreson prej Allahut, edhe pse e ka vënë veten në ndjekje të dëshirave.” (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459.)

Nën dritën e këtyre të vërtetave duhet të peshohet gjendja reale e mendjes sonë. Domethënë, i mençur është ai që jep të përkohshme dhe fiton të përherëshmen. Ndërsa njeriu që e harron Ahiretin dhe mashtrohet nga dynjaja, është i shkujdesur dhe

indiferent. Siç shprehet edhe Omeri (r.a.), ai që shet Ahiretin e vet për hir të dynjasë së dikujt tjetër është edhe injorant, edhe i marrë!.. Sepse Allahu nuk i jep vlerë atij që e harron Ahiretin duke u zhytur në këtë botë, e cila tek Allahu nuk ka vlerë as sa krahu i një mize.

Për këtë arsye, Lukman Hakimi ka këshilluar:

“Flijoje dynjanë tënde për Ahiretin, që t'i fitosh të dyja. Por mos e flijo Ahiretin për dynjanë, sepse i humbet të dyja.”

Dynjaja është si një mirazh mashtrues që egoje të papërpunuara, që nuk e kanë arritur përsosmërinë, iu ngjan si ujë. Figurativisht mund të krahasohet me mollën e sheqerit që pëlqehet shumë nga fëmijët ngaqë nga jashtë reflekton ngjyra të ëmbla, por në fakt brendësia ka përmbajtje të thartë dhe të prishur.

Në Kuranin Fisnik sqarohet:

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbulurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhët, thahet dhe mбетet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.” (Hadid, 20.)

“Allahu ia shton furnizimin kujt të dojë dhe ia pakëson kujt të dojë. Jobesimtarët i gëzohen jetës së kësaj bote, por jeta e kësaj bote në krahasim me botën tjetër është vetëm kënaqësi kalimtare.” (Ra'd, 26.)

“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!” (Ankebut, 64.)

“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse bota tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen Allahut. Pra, a nuk po mendoni?” (En'am, 32.)

“Mjerë ata që jetën e kësaj bote e duan më shumë se atë të botës tjetër, që largojnë njerëzit nga rruga e Allahut dhe dëshirojnë ta shtrembërojnë atë! Ata janë në humbje të madhe.” (Ibrahim, 3.)

“Kjo, sepse ata e duan më shumë jetën e kësaj bote, sesa jetën e botës tjetër; Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë mohuesit.” (Nahl, 107.)

“Këta janë ata që jetën e kësaj bote e kanë blerë

**“Ti
(o Muhamed)
mos u mashtro
nga bredhja e jobesimtarëve
nëpër botë! Kjo mirëqenie
është e shkurtër; pastaj,
strehimi i tyre është
Xhehenemi. Eh, sa shtrat i
keq është ai vend!”**

(Al-i Imran, 196-197.)



3. - Ebu'l-Abbas Ahmed bin Muhammed Ibn-i Axhibe, el-Bahru'l-Medid fi Tefsiri'l-Kurani'l-Mexhid, Kajro 1419. II, 112.

me jetën e ardhshme. Atyre nuk do t'u lehtësohet dënimi dhe askush nuk do t'u vijë në ndihmë.” (Bekare, 86.)

“...Thuaju: «Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë Allahun e s'bëjnë gjynahe...”” (Nisa, 77.)

“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë që t'i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij xhehenemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar. Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiket për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet.” (Isra, 18-19.)

“Por ju doni këtë jetë (kalimtare), e për jetën tjetër nuk kujtoheni!” (Kijame, 20-21.)

“...Në të vërtetë, jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e përkohshme, ndërsa jeta tjetër është Shtëpi e përhershme.” (Gafir, 39.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), e shpreh këtë të vërtetë, me këto fjalë:

“O Allah! Jeta e vërtetë është ajo e Ahiretit! (Lumturia e vërtetë, është ajo e përjetshmja!)” (Buhari, Xhihad, 33, Salat, 48.)

Po ashtu edhe në këtë hadith të transmetuar nga Abdullah bin Mes'udi (r.a.), ka shumë këshilla për ne:

Njëherë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), kishte fjetur mbi një hasër. Kur u ngrit nga gjumi, hasra kishte lënë gjurmë në trupin e Profetit tonë (a.s.). Për këtë arsye ne i thamë:

“O i Dërguar i Allahut! A të gjejmë një dyshek për ju?!”

Por i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“E çfarë lidhje kam unë me dynjanë? Në këtë botë, unë jam si ai udhëtari që pushon nën hijen e një peme, e më pas i hipën kafshës së vet dhe largohet prej aty.” (Tirmidhi, Zuhd, 44/2377.)

Njëherë, Omeri (r.a.) shkoi tek shtëpia e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Kur hyri, hodhi sytë për-qark dhomës dhe vuri re se në dhomë nuk kishte asgjë (asnjë mobilje), përveç një hasre të thurur me gjethe hurmash, mbi të cilën ishte shtrirë i Dërguari i Allahut, (a.s.). Hasra e thatë kishte lënë gjurmë në lëkurën e bekuar të Profetit tonë (a.s.). Ndërsa në një qoshe gjendej pak miell elbi, e pranë tij një kacek i vjetër uji, i varur në mur. Kaq ishte gjithçka!.. Kjo ishte e gjithë pasuria e kësaj bote e Profetit tonë (a.s.), në kohën kur i gjithë Gadishulli Arabik i bindej atij.

Kur Omeri (r.a.) e pa këtë gjendje, mori frymë thellë dhe duke mos e mbajtur dot veten filloi të mbytej në lot. Profeti (a.s.), e pyeti:

“Pse po qan o Omer?”

“Si të mos qaj o i Dërguar i Allahut! Kajseri dhe

Kisra notojnë në mirësitë e kësaj bote, ndërkohë që i Dërguari i Allahut jeton mbi një hasër të thatë!?” – tha Omeri (r.a.).

Profeti (a.s.) e qetësoi Omerin (r.a.) kështu:

“Mos qaj o Omer! A nuk është më mirë që të gjitha mirësitë dhe kënaqësitë e dynjasë të jenë të tyret, ndërsa ato të Ahiretit të jenë tonat?!”⁴

Po ashtu, edhe Allahu i Madhëruar i paralajmëron kështu besimtarët që i kanë zili njerëzit gjynahqarë për pasuritë, rehatinë dhe luksin në të cilin ata jetojnë në këtë botë:

“Dhe, sikur (të mos kishte rrezik që) njerëzit të mos bëheshin një bashkësi mohuesish, Ne do t'i bënim prej argjendi çatitë e shtëpive të atyre që nuk besojnë në të Gjithëmëshirshmin, madje edhe shkallët nëpër të cilat ngjiten, edhe dyert e shtëpive të tyre, edhe divanet në të cilat mbështeten. Po ashtu (do t'u jepnim edhe) stoli prej ari. Por të gjitha këto janë vetëm kënaqësi të kësaj jete, kurse jeta tjetër te Zoti yt është për punëdrejtët që ruhen (nga gjynahet dhe nga dënimi i Allahut).” (Zuhruf, 33-35.)

“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!” (Al-i Imran, 196-197.)

“Në të vërtetë, atyre që nuk besojnë në jetën tjetër, Ne kemi bërë që t'u duken të bukura veprat e tyre, prandaj ata ecin verbërisht. Janë pikërisht ata që i pret dënimi i rëndë dhe, në jetën tjetër do të jenë më të humburit.” (Neml, 4-5.)

Po ashtu i nderuari Mevlana ka thënë:

“Njeriu, i cili kërkon dynjanë që është e përkohshme, ka kërkuar diçka të keqe sa s'bëhet më! Ndërsa ai që kërkon Ahiretin, ka kërkuar të mirën, të bukurën dhe të drejtën.”

Një person shkoi tek Sufjan Theuri dhe i tha:

“Më këshilloni!”

Dhe ai e këshilloi:

“Puno për dynjanë tënde aq sa do të rrish në dynja dhe puno për Ahiretin tënd aq sa do rrish atje!.. Us-salam!” (Ebu Nuajm, Hilje, VII, 56.)

Prandaj shpesh duhet të mendojmë:

Sa rëndësi i japim jetës së kësaj bote të shkurtër dhe sa rëndësi i japim jetës së përjetshme të botës tjetër?

Sot njerëzimi po bën shumë kërkime shkencore me qëllim rritjen sadopak të jetëgjatësisë në këtë botë, e madje edhe që të mund shpëtojë nga vdekja. Për këtë qëllim janë shpenzuar shumë mund

4 - Shih. Ahmed, II, 298; Taberani, el-Mu'xhemu'l-Kebir, tahk. Hamdi Abdulmexhid es-Selefi, Bejrut, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabi, X, 162.

e pasuri në prodhimin e ilaçeve dhe produkteve kozmetike. Mirëpo, në jetën e vërtetë të botës tjetër askush nuk do të shqetësohet nëse ka jetuar pak apo shumë në dynja. Atje të gjithë do të kenë hall se sa kapital për botën e përjetshme kanë fituar apo humbur në jetën e shkurtër të dynjasë, e cila krahasuar me jetën e Ahiretit ngjan vetëm me një mbrëmje, apo me një paradite...

Shumë njerëz, edhe pse i dinë këto të vërteta, bien pre e egos së tyre dhe nuk arrijnë të shpëtojnë nga indiferenca. Në Kuranin Fisnik lajmërohet:

“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.” (A’la, 16-17.)

Lidhur me këtë çështje, dëshiroj të ndaj me ju një vëzhgim personal, që ka përfshirë zemrën time në mendime të thella:

Një ditë, teksa po dilja nga shtëpia për të shkuar në namazin e Sabahut, dëgjova nga jashtë rënime macesh, që të këpusnin shpirtin. U bëra kureshtar dhe kur dola në oborr vura re dy mace që qëndronin përballë njëra-tjetrës, gati për sulm. Ato hungërinin si tigra të vegjël dhe e shikonin njëra-tjetrën pa lëvizur. Qimet u ishin ngritur përpjetë dhe ishin gati të copëtonin njëra-tjetrën në lëvizjen më të vogël.

Ndërkohë që po mendoja për shkakun e kësaj hasmërie të tepruar, vura re se midis tyre qëndronte një mi i vogël i ngordhur. Macet kishin filluar një dyluftim të tillë vetëm për atë mi të cofur. Ato dëshironin ta godisnin njëra-tjetrën vetëm për atë mi të vogël që qëndronte në mes!..

Kjo shfaqje, e cila duket si diçka krejt e zakonshme, në fakt bart një mesazh shumë mësimdhënës për ne, sepse paraqet më së miri para nesh pasojat negative që sjell rendja pas lakmive të kësaj bote. Në njëfarë kuptimi të kujton këdo që për hir të ambicieve të kësaj bote, zgjedh humbjen në botën tjetër. Kjo tregon se shumë dëshira kalimtare, pasione dhe lakmi për pozita e pushtet, të cilat ndiqen nga njerëzit indiferentë, janë thjesht cofëtina dhe se nuk ia vlenë aspak të çosh dëm mirësitë e përjetshme të Ahiretit për to.

Të mos mjaftuarit me mirësitë e lejuara, me të cilat është i kënaqur Allahu i Madhëruar, dhe mashtrimi me gjërat joshëse që dëshiron egoja, e çojnë njeriun drejt një fundi shumë të hidhur. Këtë e tregon më së miri edhe shembulli i mëposhtëm:

Gjatë Miraxhit, Xhibrili (a.s.) me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), kishin parë një grup njerëzish që po dënoheshin. Para tyre kishte ushqime të shijshme me mish të pjekur dhe cofëtina të kalbura e të papjekura. Ata i linin ushqimet e shijshme dhe hanin cofëtinat e kalbura. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), pyeti se kush ishin ata, Xhibrili (a.s.), iu përgjigj:

“Ata janë burrat e ummetit tënd që linin gruan e tyre që e kishin hallall e shkonin me gratë e tjera që

i kishin haram dhe gratë që i linin burrat e tyre dhe shkonin me burrat që i kishin haram.” (Hejthemi, I, 67, 68.)

Kapja me pasion pas kënaqësive të kësaj bote pa bërë kujdes nëse janë hallall apo haram, duke neglizhuar botën tjetër, llogarinë dhe ndëshkimin, është një mashtrim i hidhur që e dënon njeriun me privime, turpërim dhe torturë të tmerrshme.

Prandaj është shumë për t’u habitur me atë person që punon vetëm për këtë botë, edhe pse beson se Ahireti është vendi i përjetësisë! Nuk ka marrëzi më të madhe se sa të konsumosh pa asnjë kriter jetën e kësaj bote, sikur nuk do të përfundojë kurrë dhe të mos e kthesh atë në një kapital për botën tjetër. Kjo botë nuk është fushë loje dhe argëtimi, por është i vetmi vend ku mund të sigurohet kapitali për botën tjetër. Lidhur me këtë në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Përpiqu të fitosh jetën e botës së ardhshme me atë që të ka dhënë Allahu, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty!..” (Kasas, 77.)

Në këtë porosi hyjnore theksi qëndron në të kuptuarit që për të arritur lumturinë e botës tjetër, njeriu nuk duhet të heqë dorë nga kjo botë, por duhet të japë prej mirësive që i ka dhuruar Allahu në këtë botë, në mënyrë që Ai të jetë i kënaqur dhe me qëllim që të na i kthejë ato në kapital për botën tjetër.

Një ditë një prej të dashurve të Allahut, i nderuari Xhunejd Bagdadi, rastisi pranë një personi që shiste akull. Kur dëgjoi shitësin të thërriste: “Ndihmoni atë që po i tretet kapitali!” (duke aluduar për veten), u trondit jashtë mase dhe ra pa ndjenja.

Siç theksohet edhe në suren Asr, njeriu është një udhëtar përjetësie, të cilit i konsumohet kapitali ditë pas dite e çast pas çasti. Nëse ai nuk arrin ta kthejë kapitalin e dynjasë në kapitalin e Ahiretit, me anë të horizontit të besimit, përpjekjet e tij në këtë botë janë vetëm mirësi që shejtanët do t’i ndajnë me njëri-tjetrin. Ndërsa përfundimi i tij, do të jetë humbje e madhe dhe dënim i dhembshëm.

Osmani (r.a.), shprehet:

***“Padyshim se dynjaja është e përkohshme, ndër-
sa Ahireti i përjetshëm. Mos t’ju përkëdhelë e mos
t’ju harbojë e përkohshmja... mos t’ju pengojë nga
e përhershmja! Zgjidhni të përhershmen në vend të
së përkohshmes, sepse dynjaja ka fund dhe kthimi
është tek Allahu. Kini frikë Allahun!”*** (Ibni Ebi’d-
Dunja, Meusu’a, I, 77.)



EL-ADL

ZOTËRUESI I DREJTËSISË ABSOLUTE

— Ilir Hoxha —

Drejtësi, do të thotë të bësh gjithçka me ekuilibrin e duhur, duke vendosur çdo gjë në vendin që i takon... Do të thotë, t'i japësh gjithkujt të drejtën e tij dhe të bësh çdo gjë sipas urtësisë, dobisë dhe logjikës përkatëse...

Fjala “el-Adl”, si një prej emrave të bukur të Zotit tonë, do të thotë se Ai është *“shumë i drejtë, nuk bën kurrë padrejtësi, gjykon me drejtësi absolute dhe nuk flet e bën përveçse të drejtën”*. “el-Adl”, është vetë drejtësia... nëse dëshiron të përshkruash drejtësinë, vetëm ky emër të vjen në mendje.

Allahu është “el-Adl” dhe, ashtu siç e bën çdo gjë me drejtësi, edhe fjalët e Tij janë vetë drejtësia. **“Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi; fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë. Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë.”** (En’am, 115.)

Asnjë gjykatës nuk është më i drejtë se Ai, sepse vetëm Ai sheh dhe dëgjon çdo gjë, njeh të brendshmen dhe të jashtmen, fillimin dhe fundin dhe ka fuqi për çdo gjë. Ndonjëherë, duke parë ato që ndodhin në këtë botë, njeriu pandeh se në drejtësinë e Allahut ka mangësi. Por kjo është vetëm si rezultat i përpjekjes për ta kuptuar gjithësinë me mendje të kufizuar, duke mos e marrë parasysh jetën e vërtetë kur do të zgjidhen të gjitha çështjet e kësaj bote.

Ata që pandehin se ajo që kërkojnë prej Allahut është në dobi të tyre dhe, kur nuk u plotësohen dëshirat, mendojnë se për ta nuk ka drejtësi, nuk e pyesin kurrë veten e tyre se, çfarë kanë bërë për të merituar mirësitë e panumërta, që janë vepër e mëshirës hyjnore. Kurse ata që i besojnë plotësisht Allahut dhe janë të kënaqur me çdo gjë që vjen prej Tij, në vend që t'i zemërohen fatit, bëjnë paqe me të dhe arrijnë qetësinë shpirtërore.

Ne nuk dyshojmë aspak në drejtësinë e Zotit tonë. Megjithatë, prej Tij nuk presim drejtësinë, por faljen dhe mëshirën, sepse e dimë shumë mirë se, nëse nuk do të ishte mëshira dhe bujaria e Allahut të Madhëruar, nëse Ai do të na trajtonte me drejtësinë e Tij absolute, askush nuk do t'i shpëtonte dënimit.

Koncepti i drejtësisë, në Kur'an përdoret edhe në kuptimin e rregullit, ekuilibrit dhe harmonisë. Fakti që Zoti ynë i Madhëruar ka krijuar një rregull që bazohet në plotësimin e të gjitha nevojave të krijesave që në krijim dhe në marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën, tregon qartë se përveç cilësive të tjera të Zotit tonë, luan rol të rëndësishëm edhe cilësia e drejtësisë, “el-Adl”.

Allahu i Madhëruar e ka krijuar gjithësinë në një balancë të caktuar dhe ka kërkuar prej nesh që të mos e prishim atë. (shih. Rrahman, 5-9.) Këtë ka dashur të shprehë edhe Imam Gazaliu kur ka thënë se, për të kuptuar domethënien e drejtësisë së Allahut, duhet të kuptojmë rregullin në gjithësi.

Robërit e drejtë të Allahut, i Cili është “el-Adl”.

Të jesh njeri, do të thotë të jesh i kufizuar. Ashtu si për çdo cilësi tjetër, edhe në drejtësi përsosmëria absolute i takon vetëm Allahut të Madhëruar. Njerëzit mund të harrojnë, të pasojnë ndjenjat dhe dobësitë... Por, pavarësisht të gjitha mangësive që kemi, kur emri hyjnor “el-Adl” manifestohet tek ne, ndryshon edhe i gjithë botëkuptimi ynë. Tashmë, botën nuk e shohim prej dritares së ndjenjave dhe interesave personale, por prej dritares së të drejtës dhe të vërtetës. Dhe, kushti i kësaj, është të mos presësh asgjë prej njerëzve dhe të mos kesh nevojë për asgjë që zotërojnë ata. Ky botëkuptim na përsos në aspektin moral dhe na forcon ekuilibrin shpirtërore.



ëror. Kjo është edhe gjendja për të cilën aludon ajeti 143 i sures Bekare me shprehjen **“popull i mesëm”**. Njeriu që jeton në bazë të këtyre parimeve, ruhet prej ekstremeve dhe teprimeve, që prej ushqimit dhe pijes, e deri tek besimi dhe adhurimet, duke vendosur ekuilibër dhe harmoni në familjen e tij, punën, jetën sociale dhe atë fetare. Po ashtu, ai nuk lejon që puna, pushimi, argëtimi, shëtitja dhe përgjegjësitë që ka, të pushtojnë vendin e njëra-tjetrës, e t’ia kthejnë jetën përmbys. Kjo, sepse drejtësia është një nevojë themelore e njeriut, të cilën nuk duhet ta tregojmë vetëm ndaj të tjerëve, por edhe ndaj vetes. Nuk duhet harruar se kush nuk ka dobi për veten, nuk ka as për të tjerët.

Dobësia dhe fuqia e cilësisë së drejtësisë, varet nga dobësia dhe fuqia e cilësive njerëzore që zotëron çdo person. Vetëm njerëzit me karakter të fortë mund të vënë në funksion drejtësinë. Ata që nuk zotërojnë cilësitë, si frikën prej Allahut, pastërtinë e zemrës, mprehtësinë e zgjuarsisë, intuitën dhe urtësinë, durimin në rast vështirësish, forcën dhe guximin, dhembshurinë, mëshirën dhe dashurinë për njerëzimin, nuk mund ta vendosin dot drejtësinë. Kjo, sepse ndjenjat negative si frika, dëshpërimi, paniku, krenaria dhe paragjykimi, e dëmtojnë ndjenjën e tyre të drejtësisë.

Drejtësia është një ndjenjë e fituar dhe, si fillim ajo fitohet brenda familjes. Çdo person në familje ka nevojat dhe të drejtat e veta në varësi të moshës dhe gjinisë. Për rrjedhojë, kujdesi që tregohet në drejtësinë ndaj këtyre, bëhet shkas që edhe personat të cilët edukohen në atë familje, të tregojnë ndjeshmëri dhe kujdes ndaj të drejtave dhe nevojave të të tjerëve. Një nga temat mbi të cilat është fokusuar psikologjia e sotme, është edhe shndërrimi në persona të dhunshëm të atyre njerëzve që kanë përjetuar padrejtësi dhe dhunë në rrethin të afërt familjar gjatë

fëmijërisë së tyre. Ky është edhe shkakua dhe urtësia e porosisë profetike në lidhje me drejtësinë ndaj fëmijëve, duke filluar që prej dashurisë, kujdesit, e deri tek çështjet financiare.

Mbrotjtësit e drejtësisë: Gjykatësit dhe Drejtuesit.

Toka dhe qiejt qëndrojnë në këmbë në sajë të drejtësisë. Ashtu siç ka nevojë për këtë ekuilibër ekzistenca fizike, ashtu edhe ekzistenca e shoqërive varet nga ruajtja e drejtësisë ndërmjet elementeve që formojnë shoqërinë. (shih. Nisa, 58.)

Megjithëse drejtësia është një cilësi që kërkohet për çdo individ të shoqërisë, ajo është e detyrueshme për gjykatësit dhe drejtuesit e saj. Allahu i Madhëruar nuk dëshiron që të ndikohemi nga ndjenjat ndërkohë që gjykojmë ndër njerëz. Ai nuk e lejon kurrë që afërsia dhe mëshira, urrejtja dhe inati të dalin para ndjenjës së drejtësisë. (shih. Nisa, 135; Maide, 8.)

Ky përgëzim profetik, është për ata që e pranojnë drejtësinë si vlerën më të lartë: *“Ata që veprojnë me drejtësi ndaj njerëzve që udhëheqin, familjeve të tyre dhe njerëzit që kanë nën përgjegjësi, do të vendosen mbi shtroje prej drite pranë Rrahmanit.”* (Muslim, Imare, 18.)

Kur në shoqëri punët ecin me drejtësi, njerëzit punojnë me dëshirë, askush nuk ndjen nevojën për tu favorizuar para të tjerëve dhe nuk detyrohet të përdorë mënyra të pahijshme për nderin njerëzor. Po ashtu, edhe ata që në kushte të tjera do t’i bënin bisht punës së tyre, do ta kuptonin se favorizimi nuk është rrugëzgjidhje për ta. Në një shoqëri të tillë, të gjithë jetojnë në paqe, i besojnë drejtësisë dhe nuk rendin pas hakmarrjeve personale. Kjo e pengon shfaqjen e armiqësive në shoqëri, duke siguruar edhe ruajtjen e jetës dhe të pronës.

Fragmente nga jeta e miqve të Allahut

— Alixhan Tatllë —

QË TË MOS THONI SE NUK KA NGELË NJERI I MËSHIRSHËM

Ndërsa Umeri (r.a.), po bisedonte me shokët e tij, aty erdhën tre të rinj. Ata i thanë:

-O kalif! Ky zotëria ndërmjet nesh ka vrarë babanë tonë. Ju lutemi, bëni çfarëdo që të jetë e nevojshme!

Nisur nga këto fjalë, Umeri (r.a.), u kthye nga i riu që po paditej dhe e pyeti:

-A janë të vërteta ato që po thonë?

I riu që fajësohej tha:

-Po, janë të vërteta.

Nisur nga kjo përgjigje, Umeri (r.a.), i tha:

-Na trego se si ndodhi kjo!

I riu filloi të tregonte:

-Unë jam një njeri që shoh punët e mia në qytetin ku banoj. Pata dalë për të shëtitur bashkë me familjen. Kaderi na çoi te vendi i këtyre zotërinjve. Ju kërkoj ndjesë, por ndërmjet kafshëve pata një kalë shumë të bukur. Kur kaloja me të, të gjithë ktheheshin dhe e shikonin për së dyti. Sado që u mundova, nuk e ndalova dot kafshën që të mos këpuste fruta prej bahçes së këtyre zotërinjve. Babai i këtyre zotërinjve doli nga shtëpia me zemërim dhe e gjuajti kalin me gurë. Kali ngordhi menjëherë. Mua më erdhi shumë rëndë kjo që bëri. Edhe unë e gjuajta me gurë dhe babai i këtyre vdiq. Desha të arratisesha, por këta zotërinjtë më kapën. Kjo është e gjithë ngjarja.

Nisur nga këto fjalë, Umeri (r.a.), tha:

-Nuk ka mbetur gjë për t'u thënë. Ndëshkimi për këtë krim është dënimi me vdekje, meqë e pranove edhe fajin.

Menjëherë pas kalifit fjalën e mori i riu dhe tha:

-I nderuar! Kam edhe diçka tjetër për të thënë. Unë jam një njeri i pasur në vendin tim. Para se babai të ndërronte jetë, më la shumë florinj. Kur erdhëm këtu, u detyrova t'i fshihja ato ngaqë vëllai im është i vogël. Nëse ju tani do ta ekzekutoni këtë vendim, te Allahu (xh.xh.), do të jeni përgjegjës ngaqë keni për t'u bërë shkak për humbjen e të drejtës së jetimit. Nëse më jepni leje tri ditë, unë do t'ia dorëzoj amanetin vëllait tim dhe do të kthehem. Unë mund ta gjej dikë për ta lënë në vendin tim përgjatë këtyre tri ditëve.

Umeri (r.a.), nuk duroi dot dhe i tha:

-Ti je i huaj te këta njerëz. Kush mund të qëndrojë në vendin tënd?

Pas kësaj pyetjeje, djali i ri hodhi një sy përreth dhe tha:

-Ky person mund të qëndrojë në vendin tim.

Ky person nuk ishte dikush tjetër përveç Amr ibn Asit (r.a.), i cili ishte prej sahabëve që i Dërguari i Allahut (a.s.), e donte më së shumti dhe i cili ishte i përgëzuar me Xhenet që në jetën e kësaj bote.

Umeri (r.a.), u kthye nga Amri dhe i tha:

-O Amr! Ti e dëgjove të riun.

Sahabi fisnik iu përgjigj:

-Po, unë jam qefil për të.

Në këtë mënyrë, djali i ri që do të ekzekutohej, u la i lirë. Në fund të ditës së tretë, koha po mbaronte, por nga djali i ri nuk kishte asnjë lajm. Për këtë arsye, burrat që përbënin parinë e Medines i thanë Hz. Umerit se i riu nuk do të vinte. Andaj i



propozuan që, në vend të dënimit që do t'i jepej Amr ibn Asit (r.a.), të jepej shpagimi për të vrarin. Por të rinjtë nuk e pranuan këtë dhe u shprehën se nuk dëshironin që gjaku i babait të tyre të ngelte pa u marrë. Umeri (r.a.), dha përgjigjen që pritej prej tij duke thënë:

“Dënimin do ta ekzekutoj edhe sikur ky qefil të ishte babai im.”

Ndërsa Amr ibn Asi (r.a.), me një nënshtrim të plotë tha: “Edhe ne e mbajmë fjalën që kemi dhënë.”

Në ato momente, kallaballëku filloi të hapej. Ndërmjet njerëzve u duk ai djali i ri. Umeri u kthye nga djali i ri dhe e pyeti: “Bir! Ti kishe një shkak të rëndësishëm për të mos ardhur. Përse erdhe?” I riu e ngriti kokën me dinjitet dhe tha:

“Erdha që të mos thoni se nuk e mbajta premtimin.” (Kjo vepër nuk është edhe aq e rëndësishme për njeriun e sotshëm.)

Umeri (r.a.), këtë herë e ktheu kokën nga Amr ibn Asi dhe i tha: “O Amr! Ti nuk e njeh këtë djalosh. Si ka mundësi që u bëre qefil për të?” Amr ibn Asi (r.a.), dha një përgjigje me një dinjitet që mund të na e ngrijë gjakun: “Ky djalë i ri më zgjodhi mua ndërmjet të gjithë këtyre njerëzve. Pranova që njerëzit të mos thonë se humanizmi ka vdekur.”

Radha u erdhi të rinjve që u kishte vdekur i ati. Edhe ata thanë: “Ne po heqim dorë nga kërkesa jonë.” Umeri (r.a.), u tha: “Çfarë ndodhi? Pak më parë thatë se nuk donit që gjaku i babait tuaj të ngelet pa u marrë. Çfarë ndodhi që po hiqni dorë?” Edhe përgjigja e të rinjve ishte i jashtëzakonshme: “Në mënyrë që të mos thoni se nuk ka ngelur njeri i mëshirshëm...”

NJERI I VËRTETË ËSHTË AI QË KA MORAL TË LARTË!

Kur shohim ndonjë në rrugë që gjendet para policëve me duar të prangosura, ndiejmë keqardhje për të dhe mendojmë duke u trishtuar: “Kush e di se ku do ta çojnë, se çfarë do t'i bëjnë, se në cilin burg do ta fusin dhe në cilën dhomë izolimi do ta hedhin këtë të shkretë që e ka humbur mirësinë e lirisë?!”

Pikërisht si kjo situatë, rastisim nganjëherë nëpër rrugë dhe nganjëherë tjetër nëpër xhamia njerëz të gjymtuar, sakatë, të verbër apo që e kanë fytyrën e duart të mbushura plot me çibanë. Ne si njerëz ndiejmë keqardhje për ta. Ndërkohë të gjithë ne kemi cilësi të këqija, ambicie të pakufizuara, pranga të padukshme me të cilat i kemi lidhur duart dhe zinxhirë të rëndë me të cilët i kemi lidhur këmbët. Ne po dërgohemi diku me duar të prangosura nga policët e fatit. Ne pandehim se jemi të lirë, por ja që jemi robër të ndjenjave, zemërimeve dhe epsheve tona. Ama këtë nuk e vëmë re!

Mangësitë e gjymtyrëve, sakatllëku, sëmundjet fizike, gjërat e shëmtuara që duken në trupin tonë, menjëherë na bien në sy, ndërkohë që ne kemi shumë sëmundje dhe sakatllëqe morale e shpirtërore që nuk duken. Gjithashtu kemi edhe papastërti shpirtërore. Nisur nga ky aspekt, rrugët janë të mbushura me të sëmurë dhe sakatë të këtij lloji. Ndërsa ne pandehim se ata janë të shëndetshëm dhe të lumtur.

Sheh Sadi thotë në një poezi të tij:

“Jo çdokush që ka sy, veshë dhe gojë është si Ademi. Ka shumë shejtanë që shfaqen duke marrë formën e njeriut. Ademi i vërtetë është ai që ka moralin e lartë. Bukuria e fytyrës dhe shumë bukuri të tjera u përngajnë gdhendjeve të përkohshme në këtë botë.”

KURANI FISNIK E PËRSHËNDET ÇDO SHEKULL ME NJË MREKULLI!

Ndihmësi i Faraonit, Hamani u bë mrekulli e Kuranit Fisnik. Të vërtetat që dolën në pah me kalimin e kohës, na tregojnë se çdo fjalë në Kuran është përdorur sipas një urtësie të caktuar.

Kurani Fisnik i drejtohet çdo shekulli me mrekulli të ndryshme. Për shembull, dalja në pah një nga një e të dhënave që i përmend Kurani në lidhje me kohën e Faraonit me anë të punimeve arkeologjike, vërteton se Kurani është një libër mbinjerëzor dhe hyjnor që e vërteton veten vazhdimisht me mrekulli të reja. Edhe “Hamani” është njëri prej këtyre mrekullive.

Njëri prej personave që i përmendet emri bashkë me Faraonin në Kurantin Fisnik është “Hamani”.

Hamani në gjashtë ajete të ndryshme të Kuranit përmendet si njëri prej burrave më të afërt të Faraonit. Sikundër kësaj, në Teurat përmendet si ndihmës i një mbreti të Babilonisë që ka jetuar afërsisht 1100 vite pas Faraonit dhe që u ka bërë padrejtësi çifutëve. Nisur nga kjo, orientalistët u gëzuan dhe thanë: “Ja, gjetëm një gabim në Kuran!” Por ky gëzim i tyre u shua kur u lexua shkrimi i hieroglifëve të Egjiptit dhe u gjend emri “Haman” në shkrimet e lashta të Egjiptit. Epigrafet e hieroglifëve të shkruara në gjuhën e lashtë të Egjiptit, nuk lexoheshin dot deri në shekullin e 18-të, sepse besimi dhe gjuha e lashtë e Egjiptit ishin harruar pasi në vend u përhap krishterimi. Viti që njihet si koha kur është përdorur për herë të fundit shkrimi i hieroglifëve, i përket vitit 394 pas erës sonë. Pas këtij viti, kjo gjuhë u harrua deri në vitin 1799. E fshehta e kësaj teme u zgjidh me gjetjen e një shkrimi të lashtë që i përkiste vitit 196 para erës sonë. Veçoria e kësaj tabloje ishte kjo: Ajo ishte e shkruar me tri lloje shkrimesh, pra, me hieroglifë, me shkrim demotik (forma e shkrimit të dorës e hieroglifëve) dhe greqisht. Me ndihmën e tekstit greqisht, shkrimi i lashtë egjiptian në tablo u zgjidh plotësisht nga francezi i quajtur Jean Francoise Champollion.

Pasi u zgjidhën hieroglifët, u zbulua një informacion shumë i rëndësishëm: Emri “Haman” me të vërtetë përmendej në shkrimet e lashta të Egjiptit dhe në periudhën e Hz. Musait (a.s.). Për këtë emër flitet edhe në një monument që gjendet në Muzeun “Hof” të Vjenës. Në të njëjtin shkrim të lashtë theksohet edhe afërsia që Hamani ka pasur me Faraonin. (Walter Wreszinski, Aegyptische Inschriften aus dem K.K. Hof Museum in Wien, 1906, J. C. Hinrichs’ she Buchhandlung.) Ndërsa në fjalorin “Personat në Mbretërinë e Re” që u përgatit duke u mbështetur në të gjitha shkrimet e lashta, për Hamanin thuhet se ka qenë “kryetari i punonjësve në oxhaqet e gurit”. (Hermann Ranke, Die Agyptischen Personennamen, Verzeichnis der Namen, Verlag Von J. J. Augustin in Glückstadt, Band I, 1935, Band II, 1952.)

KURANI FISNIK E PËRSHËNDET ÇDO SHEKULL ME NJË MREKULLI!

Shkencëtari francez, Prof. Dr. Maurice Bucaille ia dha emrin “Haman” një shkencëtari francez që ishte i specializuar për Egjiptin dhe i tha se ishte “një pjesë e marrë nga një shkrim dore arab i shekullit të 7-të” pa i treguar se kalonte në Kuran. Specialisti i kishte thënë se ishte e pamundur që ndonjë e dhënë e hieroglifëve të jetë shkruar me shkrim dore arabisht në shekullin e 7-të, por se do t’u hidhte një sy listave të emrave të sarajit të

Faraonit. Pasi u shikuan listat, e vërteta doli edhe një herë në pah. Rezultati që arritën nxori në pah një të vërtetë të rëndësishme. Hamani, sikundër atyre që e kundërshtonin Kuranin, kishte jetuar në Egjipt në kohën e Hz. Musait (a.s.), pikërisht siç përmendej në Kuranin Fisnik. Gjithashtu, doli në pah se ai kishte qenë një njeri i afërt me Faraonin dhe që merrej me punët e ndërtimit tekstualisht siç flitet në Kuran. Ndër të tjera, ajeti që flet në lidhje me Hamanin në Kuranin Fisnik është në një përputhshmëri të plotë me gjetjet arkeologjike: **“Faraoni tha: ‘O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot përveç meje! O Haman, më ndez një zjarr për të pjekur qerpiçë dhe më ndërto një kullë të lartë që të ngjitem te Zoti i Musait. Jam i bindur se ai (Musai) gënjen!’”** (Kasas, 38)

Gjetja e emrit të Hamanit në shkrimet e lashta të Egjiptit, jo vetëm që i nxori të pabaza shpifjet kundrejt Kuranit Fisnik, por e vërtetoi edhe një herë se ai është një libër i shpallur nga Allahu i madhëruar, sepse, në periudhën kur ka zbritur Kurani Fisnik neve na u dha në formë mrekullie një informacion historik që ishte i pamundur të dihej dhe të zgjidhej.

PERLA

- Sado që errësira të jetë e zezë dhe e fortë, dija për të ndezur një shkrepëse e ndriçon atë errësirë. (Mevlana)
- Ata që e njohin veten e tyre ndërmjet njerëzve janë tre syresh: “Ata që nuk preken qoftë edhe nga era, ata që turpërohen për të thënë edhe emrin e tyre dhe ata që nuk i shohin me shikim të vrazhdë krijesat të cilat janë amaneti i Allahut.
- Tre lloj njerëzish mëshirojini: “Atë që bie në varfëri pas pasurisë, atë që poshtërohet pasi ishte i ndershëm dhe dijetarin që ka mbetur në mes të injorantëve.”
- Njeriut i duhen dy vjet për të mësuar që të flasë. Ndërsa për ta mbajtur gjuhën i duhen gjashtëdhjetë vjet. (Resul Hamzatov)
- Një dijetar që nuk ruhet prej mëkatit është si një i verbër që mban pishtarin. Ai tregon rrugën e drejtë, por vetë nuk shikon. (Shejh Sadi)
- Ose duhet të qëndrosh larg trëndafilut të kuq, ose duhet t’i durosh dhimbjet që t’i shkaktojnë gjembat e tij. (Shejh Sadi)

Jini pak më shumë *emocionues!*

— Ajshe Kurudere —

Ka disa njerëz që nganjëherë bëjnë ndonjë shaka apo japin përgjigje të rrufeshme. Në këtë mënyrë ata e shtyjnë bashkëbiseduesin në situata që kërkojnë zgjuarsiri të mprehtë dhe praktike për t'i kuptuar qartë. Këta janë njerëz që nuk zihen, që gjithmonë kanë përputhshmëri me logjikën, të heshtur, të qetë, gjakftohtë dhe në paqe me veten. Këta janë njerëz që i pajtojnë të tjerët në mënyrë të natyrshme në vendet ku gjenden... Këta janë heronjtë e kohës që e bëjnë njeriun t'u thotë: "Mos vallë jeni gur durimi, more të bekuar?!" Nëse keni rastisur me njerëz të tillë, nëse keni një buzëqeshje të lehtë në anën e djathtë të buzës suaj ndërkohë që po i lexoni këto rreshta, edhe ju jeni një gjakftohtë dhe i paqshëm. Pra, një personalitet që meriton çmimin oskar në fushën e mbrojtjes së paqes dhe qetësisë... Dëshira për të ikur nga vendet ku lakmia sundon shumë, ambientimi me të gjithë, paqja, përshtatshmëria, mirësjellja, të qenët i padëmshëm, të dëgjuarit e mirë, të mjaftuarit me atë që posedon, ëmbëlsia, etj... Këto janë disa prej cilësive që i mbartin njerëzit të cilët duhen shumë në mjedisin që i rrethon... Por siç dihet, çdo gjë e bukur e ka edhe anën e keqe të saj. Ja aspektet problematike të këtyre njerëzve:

Këta njerëz që mbartin këtë karakter janë jo emocionues, të ngrirë, nuk shprehen, janë të heshtur, nganjëherë janë edhe frikacakë, qëndrojnë larg, hezitojnë, nuk mbajnë anë, shqetësohen, dyshojnë, janë të ngadaltë, etj. Këta njerëz mund të shfaqin situata kur nuk reagojnë deri aty saqë mund t'i çmendin ata që u gjenden pranë. Këshilla më e dobishme që mund t'u jepet njerëzve që mbartin këtë lloj karakteri është:

"Të paktën zhvillojeni vetëdijen për të marrë përsipër përgjegjësinë në çështjet që ju interesojnë dhe jini më energjikë! Të paktën jini më shumë emocionues në pikat më të rëndësishme të jetës suaj edhe nëse nuk jeni të tillë në jetën rutinë dhe bëjini të tjerët që ta ndjejnë se jeni emocionues. Tashmë hiqni dorë nga pritja e atyre

njerëzve që ju motivojnë, sepse ju mund ta motivoni vetveten. Nëse akoma hapni velat dhe prisni që të fryjë erë, në mënyrë që varka juaj të notojë përpara, atëherë nuk do të kapni dot peshkë për gjatë ditëve kur nuk fryn erë. Nëse vazhdoni t'i thoni "po" çdo gjëje, një ditë do të vini re se thesari juaj i "po"-ve do të shterojë. Prandaj, ju duhet të përvetësoni aftësinë për të thënë "jo" në vendin e duhur. Përveç të tjerash, këtë gjendjen tuaj të tillë mund të ketë edhe ndonjë "burrë/grua" që përpigjet ta shfrytëzojë. Andaj, asnjëherë mos e lejonit këtë! Mund të bisedoni me të tjerët për ndjenjat tuaja dhe mund t'i shprehni ato. Tashmë merrni vendimin për t'u thënë "stop" atyre që përpigjen të përfitojnë nga heshtja juaj! Dilni nga gjendja e të qenët një njeri që gjithmonë duhet të keni dikë mbi kokë që t'ju inkurajojë për të përparuar! Nëse bëheni më produktivë, do t'i përgjigjeni nevojës që shoqëria ka për ju."

Shkrimi tonë po i japim fund me karakteret dhe monumentet e paqes që janë kaq të dashur.

Përfundimisht, çdo karakter krahas aspekteve të fuqishme të tij ka edhe aspektet e dobëta për të cilat duhet ta mbledhë veten. Njeriu duhet të japë përpjekje serioze për ta zhvilluar veten sa më shumë të jetë e mundur. Shpresojmë t'ju kemi bërë ta ndjeni sado pak faktin se duhet të përpigjeni jashtëzakonisht për t'u bërë njerëz të kompletuar duke u mbështetur te e vërteta e besimit i cili kërkon një besimtar të plotë dhe te nevoja e shoqërisë e cila kërkon një njeri po të tillë. Uroj që temën e karaktereve të cilat na japin mundësinë për ta njohur bashkëbiseduesin dhe për ta trajtuar sipas karakterit të tij të mos e konsiderojmë vetëm si një material për t'u lexuar, por për ta zbatuar në jetë dhe për ta shndërruar në një faktor prej të cilit mund të përfitojmë...

Kalofshi ditë sa më të bukura në të cilat t'i jepni vlerë njeriut ngaqë është njeri!.. Kalofshi ditë në të cilat do të përjetoni shumë zhvillime dhe ndryshime!..





Detyrimet ndaj prindërve

— Ferit Piku —

Zoti ynë thotë në Kuranin fisnik: “**dhe Zoti ka vendosur që të mos adhuronit askënd tjetër veç Tij dhe të silleni mirë me prindërit tuaj. Në qoftë se njërin prej tyre apo që të dy i zë pleqëria, mos u thuaj atyre as Of. Ule krahun tënd ndaj tyre me mirësi dhe mëshirë dhe thuaj: “O Zot mëshiroji ata ashtu siç më mëshiruan mua kur isha i vogël”.** (Isra: 23).

Secili prej nesh rri para pasqyrës dhe i pëlqen vetja e tij, por të paktë janë ata që falenderojnë Zotin, i Cili krijoi njeriun në formën më të bukur. Pak janë ata që kujtojnë dy krijesa të tjera, që u bënë shkak që ai të vijë në këtë botë me këtë pamje kaq të bukur. Ato krijesa janë nëna dhe babai yt. Askush tjetër përveç tyre nuk do ta meritojë këtë emër. Ata janë njerëzit, që kanë sakrifikuar për ty më shumë se kushdo tjetër.

Njëri prej tyre është **nëna** jote. Ajo vuajti kur të nxori në dritë. A mos vallë mbaruan vuajtjet e saj me lindje tënde?! JO vallahi. Kur fëmija qan, qan edhe nëna bashkë me të e kur fëmija gëzohet edhe nëna gëzohet bashkë me të. Sa e sa net kanë kaluar e ajo nuk ka vënë gjumë në sy, vetëm e vetëm që fëmija i saj të flejë i qetë. Kjo është nëna. Kjo është krijesa për të cilën profeti (a.s) tha: “**Shërbeji nënës, sepse xheneti është nën këmbët e saj**”.¹ Xheneti në tokë është nën këmbët e kësaj krije-

se kaq të mrekullueshme, të cilën e respektoi Zoti dhe profeti i Tij, por fatkeqësisht nuk e respektojnë shumë njerëz.

Prindi tjetër është ai ushtari i panjohur, është **babai** yt. Del në mëngjes dhe kthehet në mbrëmje. Për hatër të fëmijës së tij ai bëhet koprac e frikacak dhe mundohet të kursejë diçka nga xhepi i tij, sepse tashmë ai ka një emër tjetër, tashmë ka emrin “baba”. Ai pakëson diçka nga qejfet dhe shoqëria e tij, bën çdo lloj pune vetëm për fëmijën e tij. Pak njerëz e dinë se ç’vuan babai.

Këta janë ata dy krijesa, për të cilët kemi përgjegjësi para Allahut (xh.sh) në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Është folur aq shumë për respektin ndaj prindërve, sa që na është bërë diçka normale të dëgjojmë sesi duhet t’i respektojmë prindërit tanë. Por këtu dua të flas për gjëra të thjeshta, për shansin që kemi për ta fituar xhenetin që këtu në tokë, por vetëm pak prej nesh i shfrytëzojnë këto raste. Kjo është një mirësi që ne të gjithë e kemi në shtëpitë tona, por që nuk ia dimë vlerën e vërtetë të saj. Ajo mirësi është **RESPEKTI NDAJ PRINDËRVE**. Secili e njeh veten e tij dhe kur mendojmë për këtë gjë, dalim në përfundim se jemi neglizhentë ndaj këtyre krijesave.

Sa e sa herë e themi një fjalë, pa pasur aspak kujdes se si e themi e kujt ia themi e nuk e dimë se ajo fjalë është si gur, është si hekur në zemrën e prindit dhe vetëm ata e dinë se sa e rëndë ishte

1. **Hadith i pranuar.** Nesaiu (2/54). Shejh Albani e vlerëson hadithin të pranuar.

ajo që fjalë që themi.

Sa e sa herë nuk e kontrollojmë shikimin tonë. I shikojmë prindërit tanë ashpër, vëngër, sikur ata të kishin ndonjë borxh ndaj nesh dhe jo ne ndaj tyre. Sa e sa herë biem në grackën e mosinteresimit ndaj tyre. Dikush mund jetë pasanik, me pushtet e me makinë, ndërsa prindërit e tij janë pa shkollë, prandaj nuk u jep as muhabet atyre.

Sa e sa herë e prishim me sjelljen tonë ndaj tyre, ua thyejmë zemrën këtyre njerëzve, duke harruar se aty ku thyhet zemra e tyre, aty vjen zemërimi i Allahut (xh,sh), ndërsa aty ku mbushet me gëzim zemra e prindit, aty vjen begatia e Allahut (xh.xh).

Për fat të keq prindërit sot kanë dalë jashtë liste. Në listën tonë kemi fëmijët tanë, shoqërinë tonë, problemet tona, por vetëm pak kujdesemi për prindërit tanë. Është pikërisht ky shkaku që nuk ka bereqet në shtëpitë tona, në tregtinë tonë, në pasurinë tonë, nuk ka harmoni në familjet tona. Vallahi respekti ndaj prindërve ndikon edhe tek puna jonë, kur i ftojmë të tjerët tek Zoti.

Nuk është gjë e vogël t'i prishësh zemrën prindit. Shikoni dy prindër të rinj, që kanë një fëmijë. Para një viti kishin halle të tjera, ndërsa tani kanë shqetësime të tjera. Në qendër të vëmendjes së tyre është pikërisht fëmija i tyre, arsimit i tij, rrobat e tij, shëndeti i tij. A mendojnë këta prindër se një ditë prej ditësh ky fëmijë, për të cilin po sakrifikojnë gjithë jetën e tyre, mund të bëhet torturë e jetës së tyre, se lotët e gëzimit do të kthehen në lot hidhërimi. A mund të ndodhë që këta prindër, të cilët iu lutën Zotit natë e ditë që t'u japë një fëmijë, do të thonë një ditë: "O Zot më mirë të mos ma kishe dhënë këtë fëmijë". Njeriu nuk e mendon diçka të tillë, por ja që arrin puna deri në këtë pikë. Shumë muslimanë sot janë prindër, por dijeni se të gjithë jemi fëmijët e dikujt, prandaj le të kemi kujdes me prindërit tanë e të mos sillemi me ta ashtu siç nuk duam që fëmijët tanë të sillen me ne.

Përditë shohim e dëgjojmë raste të frikshme, por na është bërë zemra gur, na janë bllokuar veshët, na janë zënë sytë dhe asgjë nuk na bën përshtypje. Raste të tilla ndodhin përreth nesh, por mund të ndodhin edhe brenda shtëpive të atyre që besojnë në Allahun (xh.sh).

Tregohet për një çift të ri, i cili kishte një fëmijë. Fëmijën e mbante nëna e burrit. Njëherë burri deshi t'i bënte një dhuratë gruas së tij, prandaj bashkë me famijnë etij shkon në një dyqan dhe i blen një unazë shumë të shtrenjtë. Nëna ishte në krahun tjetër me fëmijën e tyre. Nënës i pëlqeu një unazë e thjeshtë. Kishte kohë që nuk kishte vënë unazë në gishtin e saj, prandaj e mori atë unazë dhe e vuri në gisht. Kur burri nxjerr paratë për të paguar, shitësi

Sa e sa herë e prishim me sjelljen tonë ndaj tyre, ua thyejmë zemrën këtyre njerëzve, duke harruar se aty ku thyhet zemra e tyre, aty vjen zemërimi i Allahut (xh,sh), ndërsa aty ku mbushet me gëzim zemra e prindit, aty vjen begatia e Allahut (xh.xh).



i thotë që duhet të paguajë edhe një shumë tjetër për unazën që kishte marrë nëna e burrit. Atëherë ky burrë kthehet dhe i thotë nënës, se plakati nuk mbajnë flori. Nëna hidhërohet, e heq unazën dhe del nga dyqani duke qarë, por gruaja i tha burrit të saj: “Nuk bërë mirë që i fole kështu. Kush do e mbajë fëmijën tonë tani e mbrapa”? Katastrofë si burri, si gruaja. Kur ky njeri shkon t’i kërkojë falje nënës së tij, ajo i thotë vetëm një fjalë: “Nuk dua asgjë prej teje. Ta bëftë fëmija, ta bëftë fëmija”. Kjo ishte dua (lutja) e kësaj nëne dhe nuk e nxori për kollaj, por e tha atë fjalë momentin kur iu thye zemra. Vallahi kjo është lutje e rëndë dhe mjerë për ata njerëz, mbi kokat e të cilëve bie kjo lloj duaje. E lusim Zotin të na mëshirojë e të na falë.

Ka histori edhe më të habitshme se kaq. Ka nga ata fëmijë që kanë pasuri e shtëpi të madhe, por ama prindin e tij kërkon ta çojë në azil, pasi në vilën e tij të madhe nuk paska një vend për prindin e tij. Këta prindër përfundojnë nëpër azile, duke qarë hallet e njëri – tjetrit. Kalojnë netët me histori njëra më e dhimbshme se tjetra. Vallë a mendonin këta prindër, se do përfundonin në këtë vend, larg fëmijëve të tyre e të vdesin pa e marrë vesh kush?!

Tregohet për një prind të tillë, i cili gjithë jetën e dha për fëmijën e tij, por përfundoi në azilin e pleqve. I lutej Zotit natë e ditë që të takonte fëmijën e tij. Një ditë tha: “O Zot ma merr jetën pasi të takohem me fëmijën tim, pasi ta puth edhe një herë”. Por ai nuk arriti ta takonte fëmijën e tij dhe vdiq i vetmuar. Habia më e madhe ishte, se kur drejtori i azilit merr në telefon këtë fëmijë, që të vinte të varroste prindin e tij, ai pati guximin t’i thotë: “A akoma paska qenë gjallë babai im?! Ju të azilit i dini ku janë varrezat, prandaj bëni procedurat dhe vazhdoni vetë deri në fund”.

Lusim Allahun (xh.sh) që të mos bëhen shkak këta njerëz zemërgur, që Zoti t’i shkatërrojë të gjithë njerëzit. Dënimi më i vogël që të jep Zoti, është që fëmija yt sillet me ty, ashtu siç sillesh ti me prindin tënd. Profeti (a.s) thotë: **“Në këtë dynja Allahu dënon dy mëkate: keqtrajtimin e prindit Zoti dhe shthurjen morale”**.²

T’i bësh qejfin prindit nuk është pak, se i kë bërë qejfin atij që ka bërë gjithçka për ty. Mbushja zemrën me gëzim dhe dije, se në atë moment i ke hapur dyert e qiellit. Profeti (a.s) tregon për një njeri, i cili kishte jetuar në kohën e profetit (a.s), por nuk arriti ta shikonte atë (a.s), pasi nuk mund ta linte vetëm nënën e tij. Ai quhet Uejs el Karni. Profeti (a.s) i tha Omerit (r.a): **“Do të vijë një njeri nga Jemeni. Quhet Uejs el Karni (ia tregoi edhe trupin sesi e kishte). Nëse ai njeri lutet për ty, Zoti ia pranon duanë. Prandaj po e gjete atë njeri, thuajti të bëjë dua (lutje) për ty”**.³ Ueysi e donte shumë nënën e tij dhe për cilindo që të lutej, Zoti ia hapte derën e qiellit, sepse ai kishte hapur derën e gëzimit të nënës së tij.

Musai (a.s) e pyeti njëherë Zotin: “Kush është njeriu më i mirë o Zot”? Zoti i tregoi një njeri, të cilin unë dhe ti nuk e imagjinojmë dot. I tregoi për një kasap, në një zonë të humbur. Musai (a.s) u habit shumë, kur e dëgjoi këtë gjë. Duke e parë me kujdes, Musai (a.s) konstatoi, se kasapi herë pas herë merrte pak mish dhe shkonte dhe ushqente nënën e tij që nuk lëvizte dot, ashtu siç ushqen zogu të voglin e tij. Kishte mëse 20 vjet që ai e bënte këtë punë dhe kishte merituar duanë e kësaj nëne. Kjo nënë nuk peshonte më shumë se 40 kg, por dua e saj kishte shumë peshë tek Allahu (xh.sh).

Zoti i faltë gabimet tona, mangësitë tona, neglizhencën tonë. Zoti i faltë të gjitha ato fjalë të ashpra, ato vështirime të vëngërta, apo keqtrajtimet që mund tu kemi bërë prindërve tanë. Zoti mos na bëftë nga ata njerëz, kundër të cilëve luten prindërit.

Zoti i bëftë bashkëshortet tona, që t’i respektojnë prindërit e burrit, të mos bëhen shkak që të ndahet fëmija nga prindi, por le të bëhen shkak që të afrohen edhe më shumë prindërit me fëmijën e tyre. Kështu ato do të fitojnë respektin e Allahut, respektin e profetit (a.s) dhe respektin e burrave të tyre.

Zoti mos na bëftë nga ata njerëz, që sillen me prindërit e tyre ashtu siç bëjnë me bananën, e hanë e pastaj e hedhin lëkurën, se Allahu mund të bëjë që një ditë të shkelësh mbi atë lëkurë bananeje, që ti vetë e hodhe dhe mund të thyesh kokën tënde.



**KA SHUMË PRINDËR,
POR KA PAK EDUKATORË.
PRINDËRIT PLOTËSOJNË QEJFET
ME FËMIJËT E TYRE. I PUTHIN,
I PËRKËDHELIN, POR PAK PREJ
TYRE MENDOJNË T’I EDUKOJNË.
PASTAJ KUR PRINDI MENDON SE
FËMIJA PËRVEÇ TË TJERASH KA
NEVOJË EDHE PËR EDUKIM, SHIKON
SE ËSHTË SHUMË VONË, SEPSE
HEKURI RRIHET SA ËSHTË I NXEHTË.
PRANDAJ LE TË KEMI PARASYSH
PËRGJEGJËSINË QË KEMI TEK
ZOTI PËR FËMIJËT TANË.**



2. **Hadith i vërtetë.** Hakimi (4/177). Hakimi e vlerëson hadithin të vërtetë dhe me të pajtohet edhe Dhehebiu.

3. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (2542).

Zoti na bëftë fëmijë të mirë që i respektojnë prindërit e tyre.

Çdo prind dëshiron të respektohet nga fëmija i tij. Asnjë prind në botë nuk dëshiron, që fëmija i tij të sillet keq me të. Por përveç atyre njerëzve që kanë qenë njerëz të ligj, që nuk dinë ta respektojnë prindin e tyre, ka disa shkaqe që i ka vetë prindi. Prandaj sa je në këtë jetë, mundohu të mos bëhesh shkak, që fëmija yt të të keqtrajtojë para se të vdesësh.

Një prej këtyre shkaqeve është, se ky prind ka qenë fëmijë i lig për vete. Ky prind ka qenë fëmijë i tillë, i mbrapshtë ndaj prindërve të tij dhe Allahu (xh.xh) të jep të njëjtin shpërblim. E ka treguar jeta, e tregojnë edhe historitë, se Zoti e dënon fëmijën e lig, duke i dhënë atij njeriu një fëmijë të lig. Historitë nuk kanë fund, prandaj të mundohemi që të mos jemi fëmijë të ligj e fëmijët tanë të mos bëjnë me ne, ashtu siç bëjmë ne me prindërit tanë. Ky është shkak i parë.

Shkak i dytë është se ka shumë prindër, por ka pak edukatorë. Prindërit plotësojnë qejfet me fëmijët e tyre. I puthin, i përkëdhelin, por pak prej tyre mendojnë t'i edukojnë. Pastaj kur prindi mendon se fëmija përveç të tjerash ka nevojë edhe për edukim, shikon se është shumë vonë, sepse hekuri rrihet sa është i nxehtë. Prandaj le të kemi parasysh përgjegjësinë që kemi tek Zoti për fëmijët tanë.

Lidhi këta njerëz me Zotin, lidhi fëmijët me xhaminë, lidhi me shoqëri të mirë se ke për t'ia parë mirësinë si në këtë jetë ashtu edhe në jetën tjetër. Mos e lër fëmijën tënd pas dore! Mos e lër larg Zotit, mos e lër larg xhamive. Afroje fëmijën me Kuranin, se përndryshe do përgjigjesh përpara Allahut për mangësitë e tua kundrejt këtij fëmije dhe do vuash pasojat e saj në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Mësoja fëmijës Islamit, se kështu i ke bërë nderin më të madh atij dhe ke fituar edhe vetë prej kësaj. Kjo është nga mëshira dhe mirësia e Allahut (xh,sh) mbi ty. Fëmija i mbarë bën dua (lutje) për prindin e tij të vdekur. Prindi thotë: “O Zot, ç'bëhet me mua? Pse po më ngrihen gradat në xhenet?” Allahu (xh,sh) ia kthen: “Është fëmija yt, që po lutet për ty”.

E lusim Allahun (xh.xh) të dimë të jemi fëmijë të mirë dhe prindër të mirë! E lusim Allahun (xh.xh) të na dhurojë fëmijë të mirë e të na bëjë fëmijë të mirë ndaj prindërve tanë! E lusim Allahun (xh.xh) t'i falë prindërit tanë, të gjallë apo të vdekur qofshin! E lusim Allahun (xh.xh) që secili prej nesh që e ka prindin e tij të gjallë, ta dijë se ka akoma të hapur një derë për në xhenet dhe e lusim Allahun (xh.xh) që të gjithë ata që nuk i kanë të gjallë prindërit e tyre, ta dinë se ka vend për duanë e tyre tek Allahu (xh.xh).

Amin!..



Stacioni i qetësisë

— Halime Demireshik —

Vetëm të sëmuret dhe njerëzit me probleme e dinë se sa e gjatë është nata. Një njeri që fle nuk e kupton aspak sesi kalon koha!.. Gjumi është ilaç për shumë shqetësime dhe është perde për shumë sekrete.

Amina e kishte lënë veten në duart e gjumit të rehatshëm që po e çlodhte nga të gjitha shqetësimet e ditës. Papritur u gjend në vendin e ëndrrave. Shikoi disa ëndrra të shkurtra dhe pastaj filloi të shikonte një ëndërr që iu duk sikur zgjati sa gjithë nata.

“Kishte ardhur fundi i botës. Të gjithë njerëzit ishin mbledhur për të pritur në një shesh të madh. Çdo qoshe ishte e mbushur me njerëz. Të gjithë ishin të shqetësuar. Filluan që të hapeshin librat e veprave. Amina shikonte shumë të njohur rreth vetes. Dëgjonte zërat e familjes dhe të miqve të vet. Të gjithë ishin duke u marrë me problemet e veta; askush nuk kishte kohë që të merrej me të tjerët.

Engjëjt iu afruan çdo njeriu dhe filluan ta merrnin në pyetje. I pyesnin për gjërat që kishin ngrënë e pirë, për gjërat që kishin veshur e që kishin bërë. A e ke ngrënë këtë ushqim, a nuk je ngopur? Pse ke ngrënë edhe këtë ushqimin tjetër pas atij? Si i ke fituar paratë e gjithë këtyre gjërave që ke ngrënë?

A ishin hallall apo haram? Njerëzit tmerroheshin nga këto pyetje.

Më vonë, filluan të hapeshin raftet dhe të dilnin rrobat një nga një. Kur e ke marrë këtë veshje, pse e ke marrë? A nuk e dije që do të jepje llogari për të gjitha këto? Me cilat para i ke marrë këto? A nuk e dije që do të jepje llogari për të gjitha këto? A i ke blerë me para hallalli apo harami? A nuk e dije që blerja pa pasur nevojë quhet shpërdorim? Fqinja jote ishte duke vdekur nga uria. A ke trokitur ndonjëherë në derën e saj? Sa dyqane ke shëtitur për të gjetur këtë veshje!.. A ke bërë përpjekje për të ndihmuar fqinjën tënde ndonjëherë?”

I erdhi radha Aminës. Sa shumë pyetje që bëjnë. Ajo është duke djersitur nga halli... Sa i jep përgjigje një pyetjeje, ja kur vjen pyetja tjetër... I jep përgjigje dhe asaj dhe menjëherë vjen një pyetje tjetër... Një moment Amina pyeti: “Ky libër i punëve sikur është i mbushur me gjëra të këqija, ku janë sevapet e mia? Unë kam marrë abdest, kam falur namaz, kam lexuar Kuran; ku janë të gjitha ato?”

“Sikur të gjitha ato adhurime t’i kishe bërë me seriozitet, do të ishin pranuar!.. Allahu nuk ka nevojë për adhurimet që bëhen pa dëshirë!..” - iu përgjigjen engjëjt.



Amina nuk e mban dot vetën dhe fillon të qajë me ngashërim.

Veprat e njerëzve që kishin mbaruar me dhënien e llogarisë fillojnë të vihen në peshore. Njerëzit, peshorja e të cilëve rëndon nga mëkatet fillojnë të dridhen. Kërkojnë të gjejnë dikë që mund t'i shpëtojë nga Xhehenemi, por çdokush ka hallin e vet. Në atë moment një grup njerëzish thotë:

“Ne mund të na shpëtojë vetëm Pejgamberi ynë i nderuar!”

“O Resulullah, na ndihmo; na shpëto!...”

Dëgjohet një zë:

“Sa e keni ndjekur Sunetin tim kur keni qenë në botën tjetër? A më keni dërguar salavat?”

Pas këtyre fjalëve, të gjithë njerëzit fillojnë të dërgojnë salavat dhe të qajnë me zë të lartë. Dëgjohet një zë tjetër:

“Tashmë është shumë vonë!.. Duhet të vepronit që në botën tjetër!..”

Amina fillon të thotë suren Fatiha.”

Në momentin që hapi sytë, Amina shikoi se ishte mbuluar nga djersët. U qetësua kur kuptoi se e gjitha ishte vetëm një ëndërr. Vazhdonte të thoshte suren Fatiha... I dukej sikur ishte e ngulur në shtrat. Nuk mund të lëvizte. Çfarë ëndërr ishte kjo? E kishte ndërë aq shumë, sa çdo gjë i ishte dukur si realitet. Më në fund arriti të ngrihej. Shkoi në banjë. Mori abdest dhe filloi të falej. Namazi sikur po e qetësonte. Ngriti duart dhe filloi të bënte dua:

“Zoti im është i drejtë. Ai do të na kërkojë llogari për të gjitha gjërat që kemi bërë në këtë botë... Zoti im është edhe shumë i mëshirshëm!.. O Zot, të lutem më fal mua... Më fal për jetën time të mbushur me gabime e mëkate. Më fal për pjesën time të jetës që ka kaluar larg rrugës tënde... Më fal për gabimet që i kam bërë pa dashje... Më dhuro mua një jetë në rrugën e drejtë, një punë të hallallit dhe një burrë të drejtë dhe besimtar!.. Bëj që nesër e në vazhdim, ditët e jetës sime të jenë të mbushura me vepra të mira. Vdekja ime le të jetë më e bukur se jeta ime dhe jeta e ahiretit më e mirë se jeta e kësaj bote. Më fal mua, duke qenë se më pranove pranë Teje dhe bërë që unë t'i them këto fjalë. Më prano pranë njerëzve të Tu të dashur. Shtoi sevapet e mia dhe mbuloji mëkatet e mia. Lehtësoji rrugët që më çojnë tek Ti. Bëj që të jetoj sipas rregullave të fesë sonë. Ji i kënaqur nga unë, o Zoti im!.. Ji i kënaqur nga unë, o Zoti im!..”

U zgjua dhe u bë gati për të shkuar në punë. Zemra po i rrihte fort. Nuk kishte shpëtuar akoma nga ndikimi i ëndrrës që kishte shikuar atë natë. Tashmë mbi jetën e saj kishte rënë hija e Kiametit. Hëngri mëngjesin dhe u nis për rrugë.

Kur mbërriti në punë disa nga shoqet filluan që t'i hidhnin fjalë:

“Sa mirë ia kaluam mbrëmë... Kishin marrë DJ, kishte edhe muzikë live. Pije falas, dëfrim pa fund... Ah sikur të kishe ardhur edhe ti. Ke humbur shumë!..”

Amina nuk iu përgjigj, por kuptoi se ajo nuk po e ndante dot mendjen. Jeta e saj kalonte mes Xhe-netit dhe Xhehenemit. Në mbrëmje kishte jetuar në një botë krejt ndryshe kurse tani ishte në një botë tjetër... Kur ishte me mësuese Saxhiden zhytej në një gjendje shpirtërore të veçantë; kur ishte me shoqet ndodhej në një ambient krejt tjetër... I dukej sikur brenda saj ekzistonin dy persona. Një pjesë e saj donte të kujdesej vetëm për anën shpirtërore kurse pjesa tjetër nuk donte asgjë veç se të dëfrehej... Brenda shpirtit të saj kishte një luftë të vërtetë dhe ajo po lodhej çdo ditë e më shumë. Kishte ardhur koha për të zgjedhur se cilën anë do të mbante. Nuk mund të qëndronte më në mes të këtyre dy rrugëve.

Filloi orari i punës. Pothuajse të gjitha shoqet e saj kishin ardhur përveç Tunës dhe Rejhanës. Amina u gëzua nga mungesa e Rejhanës, sepse do t'ia niste me ankesat e saj: “Pse nuk erdhe, ne të pritëm, sa nazet i ke...” Nuk ia kishte terezinë këtë mëngjes.

Kaluan disa orë dhe Amina nuk duroi më dhe shkoi që të pyeste një nga shoqet për Tunën dhe Rejhanën. Ajo i tha:

“Uff... Ne qëndruam deri në dy aty, pastaj morëm leje dhe u larguam. Ato ishin duke dëfryer akoma dhe si duket kanë qëndruar deri në mëngjes, prandaj nuk janë zgjuar dot sot.”

Amina mori frymë e lehtësuar. Shkoi tek tavolina e vet dhe vazhdoi të punonte. Ora ishte njëmbëdhjetë dhe shefi i personelit erdhi për të pyetur për mungesën e Tunës dhe Rejhanës. Shoqet ia shpjeguan çështjen dhe i kërkuan ndjesë në emër të dy shoqeve duke shtuar:

“Punët e tyre mund t'i rregullojmë ne, mos u shqetësoni.”

Shefi, zotëri Ademi i qortoi pak dhe nuk harroi t'i kujtonte:

“Nëse nuk vijnë këtu deri në kohën e drekës nuk do të jetë mirë!.. Sapo të vijnë le të kalojnë nga zyra ime.”

Vajzat iu sulën telefonave, por as Tuna dhe as Rejhana nuk u jepnin përgjigje; as Ozgyri nuk e dëgjonte telefonin. Amina ishte çuditur pak nga mirëkuptimi i shoqeve të saj dhe të shefit. Njeriu që nuk pranonte t'i jepte as një pushim dhjetë minutash për faljen e namazit tani po shfaqte mirëkuptim ndaj një vonese kaq të gjatë.

Kishte ardhur orari i drekës, por nuk kishin asnjë lajm nga Tuna dhe Rejhana. Amina mori sexhaden dhe u ul në katin përdhes për të falur namazin,

pastaj doli jashtë dhe shkoi pranë shoqeve. Filluan që të hanin drekën kur ra telefoni i Jetës. Po telefonin nga një numër fiks. Jeta e hapi telefonin e merakosur:

“Qenke ti Rejhana, vdiqëm nga meraku!.. Ku je?”

Për një moment të gjithë po dëgjonin me vëmendje. Fytyra e Jetës filloi të ngurtësohej. Me zërin që i dridhej tha:

“Me të vërtetë? Ozgyri? A ishte edhe Tuna me ju? Çfarë mund të bëjmë për ju? A i ke telefonuar familjes? Mirë, mos u merakos për bankën... Sa të përfundojë orari zyrtar dhe do të vijmë për t’ju takuar...”

Jetës i kishte ikur ngjyra e fytyrës. Të gjithë e kishin kuptuar që diçka e keqe kishte ndodhur dhe po shikonin Jetën, e cila filloi të fliste duke u munduar që ta ruante qetësinë.

“Pasi kemi ikur ne paska filluar dëfrimi i vërtetë. Ozgyri paska sjellë kokainë me vete... Ato paskan përgatitur një tavolinë lart dhe paskan filluar ta merrnin drogën me radhë. Në atë moment në shtëpi paska hyrë policia dhe e ka gjetur drogën. Që prej atij momenti të gjithë qenkan nën mbikëqyrje. Në fakt paska kohë që policia e mbikëqyr Ozgyrin.”

“Kë ka marrë policia?”

“I kanë marrë të gjithë njerëzit që kanë qenë në atë shtëpi, por Ozgyri dhe Bora janë të dyshuarit kryesorë...”

“Ozgyrin e kuptuam, po Bora çfarë lidhjeje ka?”

“A është shtëpia e tyre... Ky do të jetë shkak...”

“Edhe Tuna me Rejhanën kishin qenë aty?”

“Po, në kohën kur ka hyrë policia, ato kanë qenë në katin e parë, por policia nuk ka lejuar askënd të shkojë pa i marrë në pyetje të gjithë. Më tha se mbase do të lirohej nga mbrëmja.”

Në tryezë ra qetësia. Secila nga vajzat ra në mendime të thella. Amina nuk dinte nëse duhej të gëzohej apo të mërzohej. Sikur në mbrëmjen e kaluar ajo të mos kishte shkuar tek mësuese Saxhidja, por të kishte shkuar me shoqet e veta edhe ajo do të ishte kapur nga policia. Allahu e kishte ruajtur.

Tashmë të gjithëve u kishte ikur oreksi. Pagan llogarinë dhe u drejtuan për tek banka.

“Unë po takohem me zotëri Ademin dhe po e informoj për ngjarjen.”- tha Jeta.

Të gjithë ishin kthyer në tavolinat e tyre dhe kishin filluar punën. Në këtë mënyrë kaluan dy ose tri orë. Shoqet i bënë shenja me sy njëra-tjetrës. Papritur shikuan një valixhe të lënë aty edhe roja tek dera kishte marrë një telefonatë. Ai erdhi me vrap dhe u kërkoi të gjithë punonjësve që të brak-

tisnin godinën. Kishte ardhur edhe policia, e cila e kishte rrethuar zonën në pritje të ekspertëve të bombave. Të gjithë i kishte zënë paniku dhe nuk dinin se çfarë të bënin, kur u afrua zotëri Ademi dhe u tha se personeli do të ishte pushim dhe se mund të largohej.

Amina ishte në një udhëkryq të madh. Në bankë mbase kishte bombë ose mbase nuk kishte, por në jetën e Aminës bombat po shpërthenin njëra pas tjetrës. Në fillim vdekja e papritur e Fusunit pastaj të gjitha trazirat e botës së saj të brendshme... Njohja me mësuese Saxhiden dhe fillimi i një jete të re...

“Për ku jam nisur unë?”- mendoi dhe njëherë.

Koka e saj ishte e mbushur plot. Një ditë më përpara ishte ulur në një kafe duke biseduar me Ozgyrin, kishte bërë një provë të së ardhmes me të. Ai ishte Ozgyri që ishte i dashuruar me të? Ky ishte Ozgyri që i dërgonte dhurata dhe i fliste bukur? Sa gjatë mund të shkonte lidhja e tyre? Një djalë i pasur, që merrej me drogë... Ai që sot pretendonte se e dashuronte kushedi kë do të dashuronte nesër?

Po vendi i saj i punës? Cilat ishin përparësitë e kolegeve të saja? Kur vinte fjala për adhurimet dhe detyrat fetare, askush nuk donte t’ia dinte, ato mendonin vetëm për dëfrimin!..

Iu duk sikur do t’i pëlçiste koka. Në atë moment dëgjoi zërin e ezanit dhe vrapoi për tek xhamia më e afërt për t’iu përgjigjur thirrjes së Allahut.

Fali namazin. Kishte dëshirë që të takohej me mësuese Saxhiden. Dëshironte t’i fliste për gjërat që kishin ndodhur dhe e dinte që kjo do ta qetësonte furtunën brenda shpirtit. Mori telefonin nga çanta dhe i ra numrit të mësuese Saxhides. Ajo si gjithmonë iu përgjigj me dashuri:

“Urdhëro, e dashur Amina.”

“Kam shumë nevojë të takohem me ju.”

Mësuesja Saxhide u habit pak:

“Ka ndodhur ndonjë gjë?”

“Jo, s’ka ndodhur gjë, por kisha dëshirë të takoheshim.”

“Unë po shkoj të bëj një vizitë, në qoftë se ke dëshirë mund të vish edhe ti. A ke kohë?”

“Në fakt unë kisha dëshirë që të flisja vetëm për vetëm me ju... Kam kohë sa të duash.”

“Hajde se nuk do të pendohesh. Unë po vij tek ti dhe e bëjmë rrugën bashkë.”

“Dakord, po ju pres.”

Nuk kaloi shumë kohë dhe ra telefoni. Ishte Jeta:

“Urdhëro? Çfarë ka ndodhur?”

“Mos u shqetëso, valixhja në bankë paska qenë bosh. Ne po shkojmë në polici. A ke dëshirë të vish?”

“Më vjen keq, por jam shumë e lodhur dhe kam një takim. Kur të mbërrini atje, më dërgo një zile që t’i flas në telefon. Përhëndeteni nga ana ime Tunën dhe Rejhanën”

“Po Ozgyrin?”

“Mos i thoni gjë atij, do të flas ballë për ballë me të.”

“Dakord, shihemi.”

“Mirupafshim...”

Në momentin që e mbylli telefonin, shikoi zilen e mësuese Saxhides dhe foli me të. Pasi i tregoi vendin ku ndodhej, ato u takuan.

“Ka shumë kohë që dua të të njoh me dikë.” - i tha mësuesja Saxhide.

Këtë radhë ishte Amina ajo që u habit.

“Me kë?”

“Kur të takohesh me të do të shtangesh. Kur ta njohësh më mirë do ta duash atë dhe do të fillosh që ta shikosh jetën me një sy tjetër.”

“- U bëra shumë kureshtare. A nuk do më tregosh pak më shumë?”

“Nuk është një person i famshëm, nuk del asnjëherë nga shtëpia e vet... Në fakt është një person që nuk ngrihet dot nga shtrati, por Allahu i ka dhënë disa të mira që nuk ia ka dhënë askujt tjetër... Ajo është një person që i vlerëson shumë këto të mira...”

“Fjalët e tua po më duken si një gjëegjëzë. A mund të ma shpjegosh pak këtë çështje?”

“Hajde hipin në autobus dhe do të flas më gjere.”

Hipën në autobusin që kishte shumë pak njerëz dhe u ulën në fund. Motra Saxhide filloi të tregonte:

“Ajo quhet Zylejha... Në rini ka qenë si çdo vajzë tjetër; ka luajtur dhe ka vrapuar. Kur u fejua i ndodhi një aksident që e la të gjymtuar. Ajo e shikoi këtë si një sprovë të Zotit. E falënderonte Zotin që i kishte dhënë mundësinë për të fituar sevape. Duke qenë se ajo e falënderonte Allahun pafund, Ai i hapi shumë perde. Tashmë ajo e falënderon Allahun më shumë dhe ka mësuar të ketë durim. Kur ta njohësh nuk do të dish të dallosh nëse është ajo e lumtur apo jemi ne të lumtur?... Tani për tani vetëm kaq të mjafton...”

“Si je njohur me të?”

“Në fakt ka qenë krejt një rastësi, që m’u dhurua nga Allahu... Një shoqe më mori dhe më dërgoi pranë saj. Që nga ajo ditë unë shkoj shumë shpesh që ta vizitoj. Sot qenka fati yt. Në telefon më the se doja të më takoje sa më shpejt, mos ka ndodhur ndonjë gjë?”

“Lëre mos e pyet... Kam kaluar një ditë shumë të çuditshme. A e kujton djalin për të cilin të fola mbrëmë, ai me të cilin mendoja që kisha rënë në dashuri... Ai ndodhet në polici në këto çaste... E

kanë zënë teksa po pinte kokainë me shokët. Në mëngjes e mësova këtë lajm dhe u shokova, pastaj patëm një problem në bankë. Kishte dyshime për një bombë dhe na dhanë pushim të gjithëve.”

“Pse nuk thua që në jetën tënde paskan shpërthyer disa bomba njëra pas tjetrës.”

“Me të vërtetë ashtu ndodhi.”

“Allahu të paska shpëtuar dhe të paska ruajtur nga këto probleme, do të thotë që Ai të do ty. Në fakt Allahu e do secilin nga njerëzit në mënyrë të veçantë. Ai dëshiron që të gjithë të kthehen në rrugën e drejtë dhe ta kujtojnë Zotin. Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë: *‘Kënaqësia që ndjen Allahu kur një njeri pendohet dhe kthehet në rrugë të drejtë është shumë më e madhe se kënaqësia që ndjen njeri nga ju kur gjen devenë e vet në shkretëtirë.’* Mendo një njeri që e humb devenë në shkretëtirë, një deve mbi të cilën ka ngarkuar të gjitha ushqimet dhe ujin e vet; pastaj imagjino gëzimin e tij kur e gjen devenë e vet... Nga kjo kuptojmë që Allahu nuk ia kthen shpinën plotësisht asnjë njeriu dhe pret që një ditë secili prej tyre të kthehet në rrugën e drejtë. Nuk duhet të harrojmë se i takon njeriut që të hedh hapin e parë në rrugën drejt dashurisë së Krijuesit...”

“Pse i takon njeriut që të hedh hapin e parë?”

“Allahu i ka dhënë njeriut një shans të pastër... Ashtu, siç busulla tregon gjithmonë verin, ashtu edhe njeriu ka prirje që të shkojë drejt gjërave të mira, përveç kësaj njeriu është i pajisur me arsye dhe logjikë. Ai duhet t’i përdorë të gjitha këto armë të forta dhe të kthehet në rrugë të drejtë... Sikur Allahu t’i bënte njerëzit me zor që t’i besonin Atij dhe të ndiqnin rregullat e fesë, arsyeja dhe logjika e njeriut nuk do të kishin më asnjë kuptim. Në një hadith kudsî thuhet: *‘Në qoftë se rob i afrohet Allahut një karësh (largësia mes gishtit të vogël dhe të madh) Allahu i afrohet atij një hap. Kur njeriu i afrohet Allahut një hap Allahu i afrohet atij një kulaç (hapësira mes gishtave të duarve kur i hapin krahët krejtësisht). Kur rob i afrohet Allahut duke ecur Ai shkon drejt tij duke vrapuar.’* Ti i ke vendosur vetes qëllimin për ta ndryshuar jetën tënde. Ke hedhur hapat e parë dhe tashmë Allahu të mbron nga problemet e jetës, edhe pse ti nganjëherë nuk e kupton. Ti duhet të mundohesh me të gjitha forcat e tua për t’iu afruar Allahut dhe të jesh e sigurt që do të hapen të gjitha dyert për të cilat ke nevojë...”

“Motër Saxhide... Nuk e di si mund t’ju falënderoj...”

“Çfarë është ajo fjalë, e dashur Amina... Unë nuk e di si do ta laj fajin që nuk të kam takuar më përpara; nuk e di si do ta rregulloj këtë gabim. Ja, këtu duhet të zbresim. Hajde, inshalla bëhet ajo që është më e hajrit... le të shohim se çfarë dyersh do të na hapen këtu... Bismillah...”



Virtyte që e lartësojnë njeriun

— Dr. Betyl Nefise Inal —

Allahu i Lartë e ka krijuar njeriun si krijesën më të përsosur dhe e ka vendosur si kalif në tokë. Në këtë botë të mbushur me sfida nga më të ndryshmet njeriu endet mes horizonteve të veprave të mira dhe humbjeve në rrugë të gabuar. Disa nga virtytet mund ta çojnë njeriun deri në gradën e engjëjve, dy nga këto virtyte janë nderi dhe turpi.

“Nderi është kontrollimi i dëshirës për të ngrënë dhe pirë dhe atyre epshore, si dhe shtypja e dëshirave të gabuara për të jetuar një jetë sipas rregullave të fesë sonë. Ruajtja e nderit më shumë bëhet e mundur nga ndjenja e turpit.”

Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë:

“Turpi vjen nga besimi dhe ai që ka turp do të jetë në Xhenet. Mospasja e turpër vjen nga ngurtësia e zemrës; njeriu me zemër të ngurtë e ka vendin në Xhehenem.”
(Buhari, Iman, 16.)

“Turpi dhe besimi janë bashkë, kur ikën njëri ikën dhe tjetri.” (Shuab, VI, 140.)

Në Kuran flitet për shembullin e turpër të Jusufit alejhi selam dhe të nënës sonë Merjem.

Sikur të bëhet pyetja se cila është ajo veçori që e dallon njeriun nga gjallesat e tjera; sigurisht që përgjigja do të ishte: turpi dhe nderi. Mes të gjitha gjallesave vetëm njeriu i gëzon këto virtyte. E kemi dëgjuar shpesh në jetën e përditshme sesi njerëzit që nuk kanë turp apo nder krahasohen me kafshët...

Në kohën kur Ademi alejhi selam dhe nëna jonë Hava jetonin në Xhenet, Shejtani iu afrua dhe përdori dëshirat e tyre për përjetësinë, duke i mashtruar dhe i bëri të hanin mollën e ndaluar. Nga ky gabim i bërë atyre u dolën në dukje vendet e turpshme dhe nga turpi ndaj njëri-tjetrit dhe Allahut (xh.sh.), u munduan të mbuloheshin me gjethe. (Shiko: El- Araf- 20-22.) Allahu (xh.sh.), i tha Ademit (a.s.):

“Pse nuk e pranove ti fatin tënd të cilin e kam caktuar Unë? ”

Ademi iu përgjigj:

“O Zoti im, si mund të vija tek Ti duke qenë se unë jam fajtor.”

Pas këtyre fjalëve Allahu (xh.sh.), i tha: “Pikërisht për shkak të këtij turpi që ke Unë ta fal gabimin.” Pas kësaj, Ademi i kërkoi falje me përgjërëm. (shiko: El- Araf, 23.)

Iblisi u tregua i paedukatë kur nuk zbatoi urdhrin e Allahut për t'i bërë sexhde Ademit dhe u mallkua për të gjithë jetën. (Shiko: El-Araf, 16-17; El- Hixhr 34, 35, 39.)

Edukata e lartëson njeriun, kurse arroganca dhe krenaria e zbret atë në nivelin më të ulët.

I Dërguari i Allahut ka thënë: “*Kur nuk ke turp bën çdo gjë.*” (Buhari, Enbija, 54.)

Resulullahu ishte më i turpshëm se një vajzë e re e mbuluar e gjitha me shami dhe ai arriti që të edukonte më së miri sahabët, në një kohë kur injoranca e njerëzve ishte shumë e madhe. Ata njerëz të mëdhenj kishin turp edhe të ngrinin kokën për ta shikuar në fytyrë të Dërguarin e Allahut.

KOHA JONË

Sigurisht që ne jetojmë në kohën e teknologjisë... Falë teknologjisë njerëzit janë afruar shumë me njëri-tjetrin. Të rinjtë tashmë harxhojnë orë të tëra në rrjetet sociale, flasin në kamera me njëri-tjetrin, vendosin në internet fotografite të tyre pa u merakosur se kush i shikon. Edhe fëmijët e familjeve të kujdesshme mund të futen në faqe të ndryshme dhe të shikojnë filma të papërshtatshëm.

Vajzat gjimnaziste të ditëve të sotme ecin si djemtë, pinë duhan dhe flasin fjalë të papërshtat-

shme pa u skuqur aspak. Flirtet mes vajzave dhe djemve rriten gjithmonë e më shumë. Kufijtë mes burrave dhe grave shkelen plotësisht. Edhe fëmijët që shkojnë në fillore flasin shumë kollaj për tema të rriturish. Propaganda me përmbajtje të papërshtatshme dhe hormonet që merren me anë të produkteve që konsumojmë e ka ulur shumë moshën e pubertetit dhe numri i fëmijëve që shkojnë në klinika për t'u konsultuar për këto probleme është duke u rritur.

ÇFARË U NDODHI TË RINJVE TANË?

Gjyshe të cilat kishin turp të dëgjonin zërin e një djali pas dere dhe tani mbesa që nuk e kanë problem të nxjerrin në internet video nga më të ndryshmet; gjysa që ecnin me kokë ulur në rrugë dhe nipa që i hedhin shikime agresive dhe provokuese çdo vajze që kalon në rrugë. Profesori amerikan Rowland Miller, i cili po bën studime që prej 30 vitesh në lidhje me ndjenjën e turpit, ka arritur në konkluzionin që shkak që i çon të rinjtë të humbasin ndjenjën e turpit është teknologjia.

Të rinjtë, të cilët në rrjetet sociale mund të shprehin të gjitha mendimet e tyre krejt lehtësisht me kalimin e kohëve po bëhen gjithmonë e më shumë të pandjeshëm. Ata veprojnë me mendimin që askush nuk i shikon dhe nuk i dëgjon; duke harruar engjëjt që ndodhen në dy supet tona. Në këtë mënyrë, morali dhe edukata po humbasin dalëngadalë.

Për fat të keq, në ditët e sotme nuk ka këshilla nga njerëzit e tjerë... Më përpara ne kishim fqinjë që na paralajmëronin kur shikonin fëmijët tanë duke bërë një veprim të gabuar. Tashmë fqinjëve nuk u bie në mend për paralajmërime dhe as fëmijët nuk shqetësohen nga këshillat e askujt... Në ditët e sotme, prindërit modernë kanë nxjerrë një moto të re: “Zgjidhjen e vet le ta bëjë vetë ai.”

Të rinjtë, që janë e ardhmja jonë, kanë ardhur në një gjendje që mund ta përngjasojmë me bomba të rrezikshme. Ata janë në kërkim të gjetjes së mënyrave për t'u dukur sa më shumë... Edukata është bërë diçka për të cilën njerëzit kanë turp. Me logjikën që gjarpri që nuk më prek mua le të rrojë një mijë vjet, njerëzit nuk i thonë askujt asgjë. Në fakt, zemra do që t'u thotë diçka këtyre të rinjve që ecin me mendimin se në botë nuk ekziston askush tjetër përveç tyre, por ata tashmë dinë çdo gjë (!)... Kemi harruar se ndërgjegjja e myslimanit kërkon që ne të jemi sa më modestë. Ne kemi për detyrë të paralajmërojmë dhe të këshillojmë njerëzit që na rrethojnë. Ne duhet të jemi një bashkësi që i ngjan dy duarve që lajnë njëra-tjetrën.



TRURI I NJERIUT

Të vjetrit tanë ka thënë: “Kur të plas damari i turpiti, humbet çdo gjë.” Çfarë po i ndodh trurit të njeriut në këtë kohë moderne? Në vitet e fundit janë bërë shumë studime në lidhje me trurin e njeriut dhe me ndjenjat njerëzore. Një nga këto studime është bërë në lidhje me ndikimin e televizionit tek ndjenjat e fëmijëve dhe veprimet e tyre. Fëmija i regjistron në tru të gjitha gjërat që shikon në televizion deri në detajet më të vogla dhe i bën edhe vetë. Kur e di që ka rrezik ndëshkimi ai nuk vepron haptazi, por duket që po e shikon programin në mënyrë shumë të kujdesshme. Zakonisht nënat të cilat kanë punë më të rëndësishme (!) si pirja e kafes dhe bërja e muhabetit me komshinjtë e lagjes i harrojnë fëmijët e tyre para televizionit. Nënata nuk mendojnë fare për helmet që rrjedhin nga ekrani për tek ato zemra të pastra. Ato nuk e dinë që truri i njeriut e regjistron çdo gjë që shikon, pa kaluar asnjë nga ato. Njeriu ndoshta për disa momente e harron këtë gjë, por vjen dita kur ai veprim del në dritë të diellit. Mund të themi që çdo sinjal ose krijon diçka në tru, ose shkatërron diçka.

Në një studim të bërë në Japoni: në një pjesë të një filmi vizatimor u vendos një tufë rrezesh e veçantë që ndikonte në tru dhe u shikua në qoftë se do të kishte shfaqje epilepsie apo jo. 700 fëmijët që e shikuan këtë film vizatimor shkuan në spital për shkak të goditjeve epileptike.

LOBI FRONTAL DHE NAMAZI

Në trurin tonë ndodhet një pjesë e cila është përgjegjëse për ndjenjat tona (zemërimin, urrejtjen, dashurinë, mëshirën, turpin...). Kjo pjesë quhet lobi frontal dhe përkon me ballin e njeriut. Në një studim të bërë tek njerëzit që falin namaz rregullisht është vërejtur se sexhdja i bën një banjë gjaku lobit frontal, duke i dërguar më shumë gjak

vihet re se njerëzit që falin namaz kanë më shumë mëshirë, dashuri dhe turp. Tek njerëzit agresivë dhe depresivë shikohet një ulje e aktivitetit të kësaj zone të trurit. Allahu ka thënë: **“Bëj sexhde dhe afrohu.”** (Ahlak, 19)... Sexhdja është miraxhi (ngritja) i besimtarit, është vendi në të cilin jemi më afër Allahut; është vendi më i lartësuar!

Pamjet që shfaqen rëndom në ekranet e televizioneve tona i largojnë të rinjtë nga ndjenja e turpiti. Flirti mes njerëzve me gjini të ndryshme tashmë është bërë diçka më se normale. Veshjet moderne quhen si shfaqje e një intelektit të lartë. Vajzat tona gjimnaziste me veshjet e tyre të kujtojnë modelet dhe aktoret e telenovelave të cilave kërkojnë t’u ngajjnë...

TË JESH BASHKË ME BESNIKËT

Në trurin tonë ndodhet një neuron i quajtur: neuroni i pasqyrës, i cili bën që njeriu t’u ngjasojë njerëzve me të cilët shoqërohet, prandaj Allahu na ka porositur: **“qëndroni me besnikët.”** (Teube, 119)

Një mënyrë e mirë për të qëndruar me besnikët është që të ndjekim shembullin e njeriut më të përsosur... Më i miri i të mirëve ka thënë:

“Nuk ka asnjë dyshim se kur Allahu dëshiron që ta çojë drejt humbjes një njeri i merr atij turpin. Në momentin kur i merr turpin, ai njeri shkatërrohet. Atij nuk i beson më askush dhe ai nuk mbetet asgjë veçse një hajdut. Duke qenë hajdut atij i zhduket mëshira. Kur i largohet mëshira, ai mallkohet. Kur mallkohet, ai largohet nga feja islame.” (Ibn Maxe, Fiten, 26.)

Turpi dhe modestia janë nga virtytet më të larta të njeriut. Tek gratë ato marrin vlerë edhe më të lartë, bëhen si një kurorë që i zbukuron. Një shoqëri e zbukuruar nga këto cilësi të bukura lartësohet drejt qiejve dhe bëhet një shoqëri mëshire.



JETA E LIDHUR ME FUÇINË E VAJIT TË ULLIRIT

Një burrë që shëtiste pa asnjë qëllim dhe që nuk bënte asnjë punë, një ditë prej ditësh u mërzi nga kjo gjendje. Për këtë arsye, vendosi që ta vazhdonte pjesën tjetër të jetës në rrugën e drejtë. Nisur nga ky vendim, shkoi te mbreti i vendit. Ai i kërkoi mbretit ndihmë, në mënyrë që të bënte një jetë të ndershme dhe të drejtë. Mbreti urdhëroi që burrit t'i jepej një fuçi me vaj ulliri e mbushur deri në pikën e fundit. Mbreti i tha burrit që fuçinë ta çonte nga njëri skaj në skajin tjetër të qytetit, përndryshe u shpreh se menjëherë do t'ia këpuste kokën. Pranë tij dërgoi edhe dy ushtarë që ta kontrollonin. Burri e mori fuçinë sipas urdhrat të mbretit dhe e çoi nga njëri skaj në tjetrin pa derdhur qoftë edhe një pikë vaj. Pastaj përsëri doli përpara mbretit. Mbreti e pyeti:

“Çfarë pe në qytet ndërsa po mbartje vajin e ullirit?”

Edhe pse atë ditë kishte pazar në qytet dhe gjendej një kallaballëk i madh, burri iu përgjigj në këtë mënyrë:

“I nderuar! Unë u frikësova se do më ikte koka nëse do ta derdhja vajin e ullirit. Për këtë arsye, nuk pashë rreth e rrotull qoftë edhe për një çast.” Mbreti pas këtij mesimi që i kishte dhënë, i dha edhe këshillën krejt lehtë:

“Nëse bëhesh kështu i kujdesshëm në çdo punë që kryen, i përkushtohesh punës dhe nëse nuk e nxjerr nga mendja asnjëherë se Allahu të kontrollon në çdo moment, kurrë nuk do të ndahesh nga rruga e drejtë...”

NJË THËNIE

*“A të kujtohet? Kur linde, ti qave.
Ndërsa bota qeshi. Andaj bëj një jetë të
atillë që vdekja të jetë gëzim për ty dhe
zi për të tjerët...”*

(Mehmet Akif Ersoj)

NJË LUTJE

*“...O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit
tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe
mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë
të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti
je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”*

(Hashr, 10)

FAKTE INTERESANTE

- Spreji për largimin e mushkonjave, nuk i largon mushkonjat, por na fsheh ne. Spreji i bllokton sinjalet e mushkonjës dhe e pengon atë që ta kuptojë se ne gjendemi aty.
- Njeriu mund të jetojë për një kohë të gjatë pa një veshkë, pa një mushkëri të bardhë, pa stomak dhe pa shpretkë, por pa mëlçinë nuk mund të jetojë qoftë edhe një minutë.
- Veza më e madhe është veza e strucit. Ajo është 15-20 cm e gjatë dhe mesatarisht 1.7 kg e rëndë. Zierja e saj në ujë të valuar zgjat 40 minuta.

Gjymnastika për përmirësimin E MEMORIES

Mjaftojnë vetëm dhjetë minuta aktivitet fizik në ditë për të përmirësuar kujtesën dhe për të stimuluar trurin, pavarësisht nga aktiviteti që zgjidhni të kryeni. Këtë e ka treguar një studim i realizuar nga Universiteti i Kalifornisë në Irvine dhe Universitetin japonez të Tsukuba.

Studiuesit analizuan 20 të rinj, të cilëve iu kërkua të praktikojnë dhjetë minuta stërvitje të moderuar. Pas kryerjes së sportit, vullnetarët iu nënshtruan një prove për të matur kapacitetin e tyre të kujtesës, që tregoi një përmirësim të dukshëm.

Më pas, studiuesit i kërkuan një grupi tjetër prej 16 personash për të praktikuar dhjetë minutat e aktivitetit fizik të kryer nga grupi i parë. Me anë të një pajisjeje ata vëzhguan trurin para dhe pas ushtrimit dhe gjetën përmirësim të "cortecia", e cila është përgjegjëse për rikthimin dhe dallimin e kujtimet, të rëndësishme për formimin e kujtesës.

Ushtrimi i aktivitetit fizik çdo ditë ul stresin, zvogëlon ankthin, lufton humorin e keq dhe depresionin.

Perimet e gjelbra DHE KANCERI



Nuk diskutohet që perimet e gjelbra, ku bëjnë pjesë brokoli, kale, lakra, janë të mira për shëndetin. Ato janë të pasura me fibra, vitamina C, E, dhe minerale dhe ushqyesve, dhe kanë pak kalori. Por nëse konsumi i tyre mund të parandalojë apo jo zhvillimin e kancerit, kjo është lëndë e shumë studimeve.

"Ndërsa studimet e kafshëve laboratorike kanë treguar përfitime të rëndësishme në mbrojtjen e ADN-së dhe një sërë përfitimesh antiinflatore, rezultatet e hulumtimit mbi njerëzit janë të ndryshme," tha Vandana R. Sheth, një zëdhënëse për akademinë e të ushqyerit.

Në eksperimentet e kafshëve, këto komponime janë gjetur të pengojnë kancerin e fshikëzës, gjirit, zorrës së trashë, mëlçisë, mushkërive dhe stomakut, shkruan New York Times.

Mbrojtja e qelizave nga dëmtimi mund të ndihmo-

jë gjithashtu në parandalimin e mpiksjes së gjakut dhe migracionit të tumoreve, proceset që ndihmojnë përhapjen e kancerit. Por studimet mbi njerëzit ishin të paqëndrueshme. Shumë prej tyre nuk gjetën asnjë lidhje midis karcinomave dhe marrjes së kë-saj perime. Të tjerë kanë gjetur se njerëzit që hanë këto perime kanë një rrezik më të ulët të kancerit të prostatës dhe gratë do të kenë një rrezik më të ulët të kancerit të gjirit.

Një studim holandez tregon se gratë që konsumojnë shumë perime të tilla kanë një rrezik më të ulët të kancerit të zorrës së trashë, por jo edhe ndaj kancerit rektal. Analiza gjithashtu tregoi se gratë që hanë më shumë se pesë vakte këtë ushqim në javë do të kenë më pak shanse për të zhvilluar kancerin e mushkërive. Kjo mospërputhje mund të shpjegojë

kodin gjenetik të një individi. Shkencëtarët kanë zbuluar kohët e fundit se gjysma e popullsisë nuk është bartës i një gjeni që përcakton sa kohë trupi mban dhe përdor ato substanca që gjenden në perime.

Lakrat përmbajnë substanca të tjera mbrojtëse, duke përfshirë karotenoide, pigmente bimore që mund të kontrollojnë rritjen qelizore jonormale, vitamina C, e cila vepron si antioksidues, mbron qelizat dhe mbështet punën e sistemit imunitar dhe acidin folik që mund të ndihmojë në mbajtjen e ADN-së së shëndetshme dhe 'përrjashtimit' gjen për përhapjen e kancerit.

Qendra botërore për kërkimet e kancerit thotë se



ka prova të kufizuara për të treguar se perimet e tilla ulin rrezikun e kancereve, si dhe prova të forta se fibra redukton rrezikun e zhvillimit të kancerit të zorrës së trashë.

Sheth paralajmëroi se kërkimi për ushqyesit më të mirë duhet nisur nëpërmes dietës dhe jo shtojcave, pasi konsumi i tepërt i disa vitaminave dhe karotenoideve mund të jenë të dëmshëm.

Ndërsa mungesa e acidit folik lidhet me rritjen e rrezikut të kancerit të zorrës së trashë, studimet e fundit kanë treguar se zhvillimi i kancerit mund të rezultojë në acid të tepërt folik, i cili gjendet në disa shtesa dhe ushqime.

JA PËRSE DUHET TË KONSUMONI *limon* ÇDO DITË

"Po jetojmë në një botë ku limonada përbëhet prej shijeve artificiale që derivojnë nga limonët natyral", pati pohuar me të drejtë Alfred E. Newman.

Përveç sasive të mëdha të vitaminës C, limonët përmbajnë riboflavin, tiaminë, hekurin, magnezin, acid pantotenik, fibër, vitaminë B6, kalium, bakër, kalcium dhe folatë.

Limonët madje mbronin minatorët kundër skorbutit gjatë kohërave të vështira në Kaliforni përgjatë 1849.

Sidoqoftë, ditëve të sotme limoni duhet të jetë patjetër pjesë e dietës tuaj, duke ditur vetitë e tij shëruese dhe parandaluese ndaj sëmundjeve të zakonshme, siç janë ato të zemrës, zorrës së trashë apo edhe gjendjes shëndetësore më të aktualizuara në botë – obezitetin.



Para së gjithash, është e rëndësishme t'i kuptojmë vetitë e limonit dhe të mirat që sjellë ai në organizmin tonë. T'i ndjekim ato më poshtë.

- Limonët përmirësojnë sistemin e tretjes
- Ndihmojnë për një lëkurë të shëndetshme
- Ndihmojnë në humbjen e peshës
- Mund të zvogëlojnë sulmet
- Parandalojnë krijimin e gurëve në veshka
- Mbron zemrën nga sëmundjet
- Ndihmon të rritet imuniteti në organizëm.





SATURNI PO HUMB TË GJITHA UNAZAT E TIJ

Sipas hulumtimeve të fundit, planeti i Saturnit po humbet unazat e tij me shpejtësi të lartë, njoftoi NASA.

Rezultatet e hulumtimit bazohen në vëzhgimet e fundit, por edhe në vëzhgimet e anijeve Voyager 1 dhe 2, me ndihmën e të cilave shkencëtarët vlerësuan disa vjet më parë se unazat po zhduken me shpejtësi mesatare.

Unazat e Saturnit përbëhen kryesisht nga pjesë akulli me madhësi të ndryshme - disa janë mikroskopike si grimcat e pluhurit dhe disa janë në madhësi të disa metrave dhe ato po zhduken pasi Saturni po i tërheq përmes gravitetit dhe zbresin në planetin në formën e një shiu të grimcave të akullit. Astrofizikani i NASA-s, James O'Donoghya tha se unazat do të zhduken plotësisht për 300 milionë vjet.

Shkencëtarët nuk janë ende të sigurt nëse Saturni

që nga fillimi kishte unaza ose u formuan në një fazë të mëvonshme, dhe kërkimet e fundit konfirmojnë teorinë, kështu që është e mundur që unazat të mos jenë më të vjetër se 100 milionë vjet.

Thuhet se në qoftë se unazat janë formuar në një fazë të mëvonshme të formimit të planetit, ishte e mundur që ato të formoheshin gjatë përplasjes së ajsbergut të vogël në orbitën e Jupiterit - ndoshta për shkak se orbitat e tyre ishin çrregulluar nga kalimi i objekteve të hapësirës, si asteroidi ose kometa.

Ekspertët e NASA-s synojnë të monitorojnë shkallën e zvogëlimit të unazave për disa kohë dhe të shohin nëse po kalojnë nëpër ndryshime sezonale.

Ndryshe, Saturni i nevojitet 29,4 vjet për të bërë një rrotullim rreth Diellit, dhe gjatë atij udhëtimi, grimcat e unazave në nivele të ndryshëm janë të ekspozuara ndaj Diellit.

EKUIPAZHI I STACIONIT NDËRKOMBËTAR TË HAPËSIRËS KTHEHET NË TOKË

Tre anëtarë të ekuipazhit të Stacionit Ndërkombëtar të Hapësirës u kthyen në Tokë pasi përfunduan misionin e tyre prej 197 ditësh.

Komandanti gjerman, Alexander Gerst, astronautia amerikane, Serena Aunon-Chancellor, dhe kozmonauti rus, Sergei Prokopyev, ateruan të enjten me anijen e tyre kozmike Soyuz në një bazë në rajonin Zhezqazghan të Kazakistanit.

Ata qëndruan në bordin e Stacionit Ndërkombëtar të Hapësirës për të kryer disa eksperimente.

Më 11 dhjetor, Kononenko dhe Prokopyev ecën nëpër hapësirë dhe morën mostra jashtë Stacionit. Gerst e dorëzoi komandën e Stacionit te rusi Oleg Kononenko.

Kononenko, Anne McClain nga Shtetet e Bashkuara dhe David Saint-Jacques nga Kanada arritën

në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës në fillim të dhjetorit dhe do të qëndrojnë atje për gjashtë muaj.





LG DO TË NXJERRË NË TREG LAPTOPIN MË TË HOLLË NË BOTË

LG Consumer Electronics Show (CES) që mbahet çdo vit në Las Vegas është vetëm disa javë larg dhe njoftimet kanë filluar tashmë. LG njoftoi sot se do të lansoj laptopin më të lehtë në botë – Gram 17 – në CES.

Laptopi peshon vetëm 1,340 gram krahasuar me laptopë të tjerë të së njëjtës klasë që peshojnë 2.000 gram ose më shumë.

Kompania pretendon se arriti të grumbulloj në një ekran 17 inç, një trup 15.6-inç të laptopit. Laptopi do të shfaqë ekranin premium Wide Quad Extended Graphics Array (WQXGA) me rezolucion

2560 x 1600 dhe një raport më të gjerë, 16:10.

Specifikat tregojnë se ekranin do të jetë i madh, për transmetimin e videove, lojërave dhe redaktimin e dokumenteve.

Ndër specifikat kryesore që sjell laptopin, janë:

- Ekranin: 17 inç WQXGA me rezolucion 2560 x 1600

- Procesori: Intel Core 8th Gen Intel Core

- Grafika: Intel UHD Graphics

- Memoria: 8 / 16GB RAM

- Magazinim i brendshëm: 256 / 512GB

- Bateria: 72Wh (rreth 19.5 orë, sipas kompanisë)

LG thotë se laptopin është projektuar me standardin e qëndrueshmërisë MIL-STD-810G, duke e bërë atë rezistent ndaj shokimeve, temperaturës dhe ndaj pluhurit. Kompania ka përfshirë një sensor të gjurmëve të gishtit. Përveç kësaj, pajisja ka teknologjinë DTS Headphone X për të përmirësuar eksperiencën tuaj të audios.

SA NJERËZ PËRDORIN INTERNET?

3.9 miliard njerëz përdorin internetin, pra pak më shumë se gjysma e popullsisë globale. Sipas të dhënave zyrtare të OKB, rezulton se kjo është hera e parë që arrijmë në këtë rezultat dhe konsiderohet si një hap i rëndësishëm drejt një shoqërie botërore më të përfshirë në informacion.

Sipas Agjencisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kombeve të Bashkuara, vendet e pasura kanë një rritje konstante dhe të ngadaltë në përdorimin e internetit, duke kaluar

nga 51.3% përdorues në vitin 2005 në 80.9% në 2018.

Ndërsa vendet në zhvillim kanë treguar një rritje më domethënëse të numrit të përdoruesve, duke kaluar nga 7.7% në vitin 2005 në 45.3% sot.

Sipas raportit gjithashtu rezulton se në nivel global numri i abonentëve të telefonisë fikse janë ulur në mënyrë drastike duke arritur në vetëm 12.4%, ndërsa numri i abonimeve për celular sot ka tejkaluar edhe numrin e popullsisë botërore.



Souvenir Albania

*tregton me shumicë dhe pakicë
punime artizanale të cilësisë së lartë.*



Emel 7303

Wooden frame & fabric set



Armchair	H: 102 cm	D: 90 cm	W: 102 cm
Three Seater	H: 230 cm	D: 90 cm	W: 130 cm
Coffee Table	H: 100 cm	D: 100 cm	W: 130 cm



Mobileria
Elif 19

Ruglan

EXCELLENT

7327



Ruglan 7327

Wooden frame & fabric set



Armchair	H: 102 cm	D: 90 cm	W: 102 cm
Three Seater	H: 230 cm	D: 90 cm	W: 130 cm
Coffee Table	H: 100 cm	D: 100 cm	W: 130 cm



Emel

Wooden frame & fabric set

EXCELLENT

7303





"LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëpllaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mvëshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress të balloreve me folje të pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina të persosur kualitet dhe cilësi të lart.



Gravirimin e fronteve
me makinë CNC
Aksesora për mobiljeri
Folje për vakumpress
Shirit PVC
Shirit ABS
Iverëpllaka
MDF



Kuzhina



Paradhoma



Komoda



Tavolina




Dhoma e thjetjes




MDF panelet dekoruese

*Blerësi / kënaqur
ne edhe më të kënaqur!*



ÇAPA[®] musluk



REYHAN

Kosovë për herë të parë
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera
në KOSOVË

**ELEGANCË, BUKURI, CILËSI
DHE 5 VJET GARANCI
ME ÇMIME TË VOLITSHME**



ISO 9001



5 ★★★★★
Yıl Garanti

www.capamusluk.com.tr

www.reyhan-ran.com

Armatürde Dünyaya Vurulan Marka

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni
përmes telefonave dhe web faqes.



Aromë Trëndafili



KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!



**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Ju mirëpresim!



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“Ta dini, se jeta
në këtë botë,
nuk është tjetër
veçse lojë, dëfrim
e zbukurim, si dhe
mburrje ndërmjet jush
e rivalitet për më
shumë pasuri dhe fëmijë!
Ajo i shëmbëllen bimës,
e cila pas shiut rritet
dhe i gëzon bujqit,
por më vonë zverdhet,
thahet dhe mbetet
pa vlerë.
Në botën tjetër ju
presin vuajtje të mëdha
ose falja e Allahut
dhe kënaqësia e Tij;
jeta në këtë botë është
vetëm kënaqësi
e rreme..”

(Hadid, 20)